

Të dhënat kryesore financiare

Banka Raiffeisen në Kosovë sh.a.			
Vlerat monetare janë në milionë euro	2020	2019	Ndryshimi
Pasqyra e të ardhurave	1/1-31/12	1/1-31/12	
Të ardhurat neto pas provizioneve	38.1	37.3	2.2%
Të ardhurat neto nga tarifat bankare	9.4	10.3	-8.5%
Të ardhurat neto nga vlerësimi i instrumenteve financiare në vlerë të drejtë	0.1	0.1	-13.9%
Të ardhurat / shpenzimet nga tregtimi	(0.0)	0.1	-113.2%
Të ardhurat tjera operative	1.7	2.2	-21.0%
Shpenzimet e përgjithshme administrative	(30.8)	(29.4)	4.7%
Fitimi para tatimit	18.5	20.5	-9.9%
Fitimi pas tatimit	16.7	18.3	-8.9%
Fitimet për aksion	N/A	N/A	N/A
Bilanci i gjendjes			
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	28.6	35.5	-19.5%
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	709.5	669.5	6.0%
Depozitat dhe huamarrjet nga bankat	26.9	7.6	253.6%
Depozitat nga klientët	915.6	858.7	6.6%
Ekuiteti (përfshi interesat jo-kontrolluse)	144.1	127.4	13.1%
Gjithsej bilanci i gjendjes	1,116.0	1,021.9	9.2%
Informatat vendore rregullative			
Pasuritë e ponderuara sipas riskut B1	835.1	791.6	5.5%
Gjithsej fondet vetanake	145.9	128.0	14.0%
Gjithsej kërkesa për fonde vetanake	100.2	95.0	5.5%
Raporti i mbulimit tepriçë	45.6%	34.7%	-5.8 PP
Raporti i kapitalit kryesor (klasi i parë)	15.7%	14.3%	-0.6 PP
Gjithsej raporti i fondeve vetanake	17.5%	16.2%	-0.7 PP
Performanca			
Kthimi në ekuitet (KE) para tatimit	14.5%	17.7%	-3.3 PP
Kthimi në ekuitet (KE) pas tatimit	13.1%	18.4%	-5.3 PP
Koeficienti kosto/të ardhura	54.1%	53.7%	0.4 PP
Kthimi në pasuri (KP) para tatimit	1.8%	2.2%	-0.4 PP
Raporti neto i provizionimit (Pasuritë mesatare të ponderuara sipas riskut B1 në librin e bankës)	1.4%	0.9%	0.5 PP
Koeficienti rrezik / fitime	21.0%	11.2%	9.8 PP
Burimet			
Numri i punëtorëve	802	870	-7.8%
Zyrat e biznesit	41	45	-8.9%

Përmbajtja

Raporti i Bordit Mbikëqyrës	4
Raporti i Bordit Menaxhues	5
Bordi Menaxhues i Kosovës	6
Struktura organizative e Bankës Raiffeisen në Kosovë	7
Vizioni dhe misioni	8
Vështrim i shkurtër mbi Raiffeisen Bank International	9
<hr/>	
Zhvillimet në ekonominë e Kosovës	10
Sektori bankar në Kosovë	12
<hr/>	
Performanca dhe financat e Bankës Raiffeisen në Kosovë	14
Menaxhimi i thesarit, asetëve dhe detyrimeve	18
Segmentet e biznesit	22
Produktet dhe shërbimet bankare	24
Kanalet e shpërndarjes	26
Menaxhimi i rrezikut	28
Burimet njerëzore dhe trajnimet	32
Qëndrueshmëria dhe përgjegjësia korporative	34
<hr/>	
Pasqyrat financiare	38
Adresat dhe kontaktet	112

Raporti i Bordit Mbikëqyrës

Zonja dhe zotërinj,

Duke pasur parasysh pasojat e paprecedenta dhe të paparashikueshme të pandemisë COVID-19, performanca financiare e Bankës Raiffeisen në Kosovë, në vitin 2020, tejkaloi pritshmëritë. Banka mbajti pozitën e saj numër një në treg për të gjithë treguesit kyç të performancës, siç janë pjesëmarrja në treg për kredi dhe depozita, fitimi neto, rrjeti i degëve dhe numri i klientëve.

Gjatë vitit financiar 2020, anëtarët e Bordit Mbikëqyrës mbajtën katër mbledhje të zakonshme dhe asnjë të jashtëzakonshme. Shkalla e përgjithshme e pjesëmarrjes në mbledhjet e Bordit Mbikëqyrës ishte rreth 88 për qind.

Bordi Mbikëqyrës monitoroi në mënyrë të rregullt dhe gjithëpërfshirëse performancën e biznesit dhe zhvillimet e rrezikut në Bankën Raiffeisen në Kosovë. U zhvilluan diskutime të rregullta me Bordin Menaxhues mbi mjaftueshmërinë e kapitalit dhe likuiditetin, si dhe mbi drejtimin e strategjive të bankës për biznesin dhe rrezikun. Bordi Mbikëqyrës gjithashtu trajtoi gjerësisht zhvillimet e mëtejshme në fushën e qeverisjes korporative dhe monitoroi zbatimin e politikave përkatëse. Gjatë aktiviteteve të tij monitoruese dhe këshilluese, Bordi Mbikëqyrës mbajti kontakte të drejtpërdrejta me anëtarët përgjegjës të Bordit Menaxhues, auditorin dhe udhëheqësit e funksioneve të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, ai vazhdimisht shkëmbeu informata dhe pikëpamje me përfaqësues nga autoritetet mbikëqyrëse për çështje aktuale.



Për më tepër, Bordi Menaxhues i siguroi Bordit Mbikëqyrës raporte të rregullta dhe të hollësishme për çështje përkatëse në lidhje me performancën në fushat përkatëse të biznesit. Midis takimeve, Bordi Mbikëqyrës mbajti kontakte të ngushta me Kryesuesin dhe anëtarët e Bordit Menaxhues. Bordi Menaxhues ishte në dispozicion kur kërkohet për diskutime dypalëshe ose shumëpalëshe me anëtarët e Bordit Mbikëqyrës, kur ishte e zbatueshme, me përfshirjen e ekspertëve për çështjet që adresoheshin.

Puna e ndërmarrë së bashku me Bordin Menaxhues u bazua në një marrëdhënie besimi të ndërsjellë dhe u zhvillua në një frymë të bashkëpunimit efikas dhe konstruktiv. Diskutimet ishin të hapura dhe të rëndësishme, dhe Bordi Mbikëqyrës miratoi vendime pasi shqyrtimit të plotë të të gjitha aspekteve. Në rast se kërkoheshin informata shtesë për t'i shqyrtuar më thellë çështjet individuale, ato informata u siguroheshin anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës pa vonesë dhe sipas kërkesës së tyre.

Çështjet më të rëndësishme të diskutuara vazhdimisht në çdo takim të Bordit Mbikëqyrës, gjatë vitit 2020, ishin pasojat dhe menaxhimi i pandemisë COVID-19. Këto diskutime përfshinë mirëqenien dhe sigurinë e stafit, mjedisin e ri të punës, zhvillimin e përshpejtuar të shërbimeve bankare digjitale, çështjet e menaxhimit të rreziqeve të krijuara nga pandemia, mjedisin makroekonomik dhe situatën politike.

Duke marrë parasysh atë që haptas mund të përshkruhet si një vit i paprecedent për shkak të sfidave që rezultuan nga pandemia COVID-19, do të doja të përfitoj nga ky rast dhe ta falënderoj sinqerisht Bordin Menaxhues dhe të gjithë punonjësit e Bankës Raiffeisen në Kosovë për përpjekjet e tyre të palëkundura, dhe gjithashtu klientët për besimin e tyre të vazhdueshëm gjatë këtyre kohërave të jashtëzakonshme.

Në emër të Bordit Mbikëqyrës,

Peter Lennkh,
Kryesues i Bordit Mbikëqyrës

Raporti i Bordit Menaxhues

Viti 2020 ishte një vit i paprecedent ku prioritetet kryesore ishin shëndeti i stafit tonë dhe ofrimi i pandërprerë i shërbimeve bankare për të gjithë klientët tanë, në një mjedis sfidues të krijuar nga pandemia e COVID-19. Duke pasur parasysh këtë sfond, performanca e Bankës Raiffeisen në Kosovë tejkaloi pritshmëritë dhe kjo u reflektua jo vetëm në performancën tonë financiare, por edhe në masat tona për kënaqshmërinë e klientit, ku arritëm Rezultatit më të lartë neto të promovuesit (ang. Net Promoter Score) nga të gjitha bankat në Kosovë në 3 nga 4 segmentet tona të klientëve dhe ishim të dytët më të mirët në segmentin e mbetur.

Bruto Produkti Vendor i Kosovës në vitin 2020 shënoi rënie prej 5.1 për qind në fund të tremujorit të tretë dhe ky ishte një faktor kryesor në uljen e fitimit neto të bankës, krahasuar me vitin 2019. Fitimi neto i vitit 2020 pas tatimit ishte 16.4 milionë €, krahasuar me 18.3 € milionë sa ishte në vitin 2019.

Pavarësisht mbylljes totale të vendit për disa muaj gjatë vitit 2020, portofoli ynë i kredive u rrit me 6.7 për qind nga viti në vit dhe depozitat u rritën me 8.1 për qind, në 983 milionë €, duke krijuar një raport shumë të pavarueshëm të depozitave ndaj kredive prej 78.2 për qind.

Vëmendje të veçantë në vitin 2020 mori programi ynë proaktiv dhe me përgjegjësi shoqërore i moratoriumit të kredive, i cili u mundësoi të gjithë kredimarrësve tanë që t'i shtynjë përkohësisht pagesat e kredive për deri në 15 muaj. Në një pikë gjatë vitit, më shumë se 60 për qind e portofolit tonë të kredive ishte në moratorium dhe ky ishte një faktor kryesor në përfundimin e vitit me një Raport të ulët të Kredive Joperformuese prej 3.27 për qind.


Mjedi operues në vitin 2020 gjithashtu krijoi një rritje të konsiderueshme në aktivitetet jashtë degës, ku 21 për qind të klientëve privatë individualë përdorin platformën tonë të re për shërbime bankare në internet dhe telefon, Raiffeisen Plus. Ne gjithashtu lansuam një platformë bankare online 24/7 në kohë reale për klientët tanë korporata dhe ndërmarrje të vogla dhe 394 mijë transaksione të e-banking u përpunuan gjatë vitit, të cilat përfaqësojnë 90 për qind të të gjitha pagesave. Këto praktika të reja do të vazhdojnë edhe në vitin 2021 dhe ato i mundësojnë stafit tonë të degës që të kalojnë më shumë kohë duke u angazhuar me klientët dhe duke u marrë me aktivitete më komplekse dhe që krijojnë vlerë.

Shërbimi për klientët vazhdoi të ishte një përparësi shumë e rëndësishme konkurruese në vitin 2020 dhe luajti një rol kryesor, duke na ndihmuar që ta realizojmë vizionin tonë për të qenë institucioni financiar më i rekomanduar në Kosovë. Ne vazhduam të investojmë në zhvillime teknologjike dhe trajnim të stafit në mënyrë që të ofrojmë një përvojë të paharrueshme në çdo transaksion. Ne gjithashtu vazhduam të jemi shumë aktivë në një gamë të gjerë të mediave sociale të cilat, duke pasur parasysh situatën pandemike, u bënë kanal komunikimi shumë i vlefshëm dhe i përshtatshëm në të gjitha segmentet e klientëve.

Menaxhimi i qëndrueshmërisë dhe përgjegjësia korporative kanë qenë gjithashtu prioritetet e bankës sonë. Raiffeisen Bank International (RBI) është banka e parë austriake që u bë Nënshkruese zyrtare e *Parimeve të OKB-së për Shërbime të Përgjegjshme Bankare* - një kornizë e vetme për një industri të qëndrueshme bankare e zhvilluar përmes një partneriteti novator midis bankave në të gjithë botën dhe Iniciativës së Financimit të Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin. Në mënyrë që t'i ndjekim përgjegjësitë që burojnë nga këto parime, ne zhvilluam strategjinë tonë të qëndrueshmërisë e cila përbëhet nga tri fusha brenda të cilave ne e fokusojmë menaxhimin tonë të qëndrueshmërisë: shërbimet e përgjegjshme bankare, partner i drejtë dhe qytetar i angazhuar.

Në fund, në emër të Bordit Menaxhues, do të doja ta falënderoja të gjithë stafin tonë për angazhimin dhe përkushtimin e tyre gjatë këtij viti të jashtëzakonshëm, ku vlerat tona të bashkëpunimit, proaktivitetit, të të mësuarit dhe përgjegjësisë, u demonstruan dhe zbatuan në shumë raste në të gjithë bankën.

Në emër të Bordit Menaxhues,



Robert Wright
Kryesues i Bordit Menaxhues



Banka Raiffeisen në Kosovë Bordi Menaxhues



Robert Wright

Kryesues i Bordit
Menaxhues
Drejtor ekzekutiv



Iliriana Toçi

Anëtare e Bordit
Menaxhues
Shërbimet bankare retail



Johannes Riepl

Anëtar i Bordit
Menaxhues
Shërbimet bankare
për korporata



Anita Kovacic

Anëtare e Bordit
Menaxhues
Menaxhimi i riskut




Shukri Mustafa

Anëtar i Bordit
Menaxhues
Operacionet dhe TI

Banka Raiffeisen në Kosovë

Struktura organizative

Më 31 dhjetor 2020



* Auditori i brendshëm i raporton drejtëpërdrejt Komitetit të auditimit dhe Bordit Mbikqyrës

Banka Raiffeisen në Kosovë

Vizioni dhe Misioni

Vizioni

Ne jemi grupi më i rekomanduar për shërbime financiare në 2025.

Misioni

Ne e transformojmë inovacionin e vazhdueshëm në përvojë të shkëlqyer për klientin.

Vështrim i shkurtër mbi Raiffeisen Bank International

RBI e konsideron Austrinë, ku edhe është korporatë dhe bankë investuese lidere, si dhe Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL), si tregun e saj amë. 13 tregje në këtë rajon mbuloohen nga bankat filiale. Për më tepër, Grupi përfshin edhe ofrues të tjerë të shumtë të shërbimeve financiare të cilët janë aktivë në fusha, si për shembull, lizingu, menaxhimi i asetëve ose bashkimet & blerjet (M&A).

Në total, rreth 45,000 punonjës të RBI-së u shërbejnë 172 milionë klientëve në më shumë se 1,800 njësi të biznesit, shumica dërmuese e të cilave janë në EQL. Aksionet e RBI AG janë listuar në Bursën e Vjenës që nga viti 2005.

Në fund të vitit 2020, asetet totale të RBI-së ishin rreth 166 miliardë €. Bankat rajonale të Raiffeisen mbajnë rreth 58.8 për qind të aksioneve të RBI-së, ku pjesa e mbetur prej rreth 41.2 për qind është në shitje të lirë (ang. free float).

Zhvillimet në ekonominë e Kosovës

Ekonomia e Kosovës u ndikua negativisht nga pandemia COVID-19 dhe nga masat për parandalimin e saj. Rënia ekonomike në tre tremujorët e parë të vitit 2020 ishte mesatarisht 5.1 për qind, duke reflektuar një rënie të ndjeshme në ndërtim, "tregti, transport, akomodim dhe shërbime ushqimore" dhe aktivitete argëtuese. Formimi i bruto kapitalit dhe shërbimet e eksportit patën ndikimin më të madh në rënie ekonomike, ndërsa kërkesa e brendshme e kufizuar çoi në rënie të importeve. Lehtësimi i masave kufizuese në tremujorin e katërt dhe të dhënat paraprake për eksportin e shërbimeve, shpenzimet kapitale, kërkesën e brendshme, tregojnë se rënia ekonomike ishte rreth 5.1 për qind në vitin 2020. Përkundër gjithë pasigurisë që ekziston në lidhje me evoluimin e pandemisë dhe zhvillimet në lidhje me vaksinën kundër SARS-Cov-2, 2021 pritet të jetë një vit më i mirë, i nxitur nga rritja në tremujorin e tretë dhe atë të katërt.

Për shkak të kësaj performace të ulët ekonomike, inflacioni u ngadalësua sidomos për shkak të kërkesës së ulët të pritshme në tregun e brendshëm dhe rënies së çmimeve të naftës në tregun ndërkombëtar. Inflacioni mesatar në vitin 2020 ra në 0.2 për qind, nga 2.7 për qind sa ishte në vitin 2019, me kontributin më të madh negativ të çmimeve të transportit (-0.9 pp) dhe perimeve (-0.2 pp). Kur hiqen kategoritë me lëkundje të larta, siç janë ushqimi dhe karburantet, inflacioni bazë rezultoi rreth 0.5 për qind mesatarisht në vitin 2020, duke mbetur në nivele të ulëta, por në pozitë më të mirë sesa inflacioni i përgjithshëm.

Tremujori i dytë pasqyroi qartë ndikimin e pandemisë në tregun e punës ku shkalla e papunësisë arriti kulmin në 27 për qind, nga 25 për qind sa ishte në tremujorin e parë, kur ekonomia u mbyll në fillim të marsit të vitit 2020. Pjesëmarrja në tregun e punës arriti një minimum prej 33.2 për qind në fund të tremujorit të dytë të vitit 2020, ndërsa punëkërkuarit arritën kulmin me rreth 185,371 në qershor, duke shfaqur zgjerim vjetor prej 82.2 për qind. Sidoqoftë, me lehtësimin e masave kufizuese, tremujori i tretë u përmirësua, pjesëmarrja në tregun e punës u rrit në 40 për qind dhe shkalla e punësimit u rrit në 30.1 për qind, nga 24.1 për qind sa ishte në tremujorin e dytë të vitit 2020. Shkalla e papunësisë gjithashtu ndoqi shembullin e njëjtë duke u përmirësuar në 24.6 për qind në tremujorin e tretë të vitit 2020. Sidoqoftë, tregu i punës mbetet dobësi strukturore e ekonomisë.

Sektori publik ndërhyri shumë për ta bartur barrën e pandemisë në ekonomi. Si rezultat, të ardhurat buxhetore arritën në 1.7 miliardë € në fund të vitit 2020, duke shënuar një rënie vjetore prej 8.8 për qind, për shkak të aktivitetit të ngecur ekonomik që reflekton masat e ashpra kufizuese, ndërsa shpenzimet buxhetore arritën në 2.2 miliardë € që përfaqësojnë një rritje vjetore prej 6.5 për qind. Si rezultat, buxheti i Kosovës regjistroi deficit buxhetor primar prej 484 milionë € ose 2.7 herë më i lartë se në vitin e kaluar.

Programi i rimëkëmbjes do të vazhdojë në vitin 2021 me një injeksion prej 224 milionë € fonde në ekonomi, rreth 44.5 milionë € prej të cilave do t'i dedikohen Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK), me qëllim të rritjes së kredive të reja dhe lehtësimit të procesit të financimit. Për më tepër, Kosova bashkëpunoi ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare për t'u përballur menjëherë me pasojat financiare të pandemisë. FMN-ja mbështeti Kosovën me rreth 51 milionë € financim (rreth 0.7 për qind të BPV-së) në kuadër të Instrumentit për Financim të Shpejtë. BE-ja ofroi 5 milionë € për sektorin shëndetësor dhe 63 milionë € për rimëkëmbje sociale dhe ekonomike. Për më tepër, 100 milionë € (1.4 për qind e BPV-së) u siguruan nga pakoja e miratuar e ndihmës makro-financiare (NMF) të Komisionit Evropian dhe huadhënia emergjente nga Banka Botërore e cila tenderoi rreth 180 milionë € (2.5 për qind e BPV).

Situata e pandemisë rriti borxhin publik nga 17.5 për qind të BPV-së në vitin 2019, në 21.8 për qind në vitin 2020, ose 23.4 për qind nga viti në vit, e cila pritet si reagim ndaj pasojave të pandemisë.

Situata e jashtme e Kosovës u përkeqësua në vitin 2020, pasi deficitit i llogarisë rrjedhëse, i cili arriti në 429.4 milionë € në fund të vitit, u zgjerua me 7.5 për qind krahasuar me vitin 2019. Zgjerimi i deficitit të llogarive rrjedhëse më së shumti i atribuohet llogarisë së shërbimeve që u tkurr me 53.5 për qind nga viti në vit, për shkak të masave kufizuese pandemike dhe atyre të udhëimit, ndërsa rritja e të ardhurave dytësore me 13.5 për qind nga viti në vit dhe përmirësimi me 9.4 për qind i deficitit tregtar kompensoi rënie në shërbimeve deri në njëfarë niveli.

Përkundër pritshmërive për një ulje drastike të remitancave për shkak të pandemisë, ndikimi negativ zgjati vetëm në mars dhe prill, ndërsa trendi rifilloi trajektoren e tij rritëse në muajt në vijim. Remitancat arritën kulmin në 997.3 milionë € në fund të vitit 2020, duke shënuar një rritje prej 17.1 për qind nga viti në vit, e që është viti më i mirë ndonjëherë. Edhe IHD-të u rritën në rreth 322 milionë € në fund të vitit 2020, që i bie 26.4 për qind më të larta se një vit më parë, por ato ende janë larg potencialit të tyre.

Në përgjithësi, viti 2020 ishte një vit i vështirë për ekonominë e Kosovës me masa të rrepta kufizuese që dëmtuan kërkesën private. Procesi i vaksinimit i cili është në zhvillim e sipër në Evropë dhe ai në Kosovë i cili pritet të fillojë në vitin 2021 mund ta mbështesin rimëkëmbjen e vendit. Diaspora, e cila vazhdon të luajë një rol shumë të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës, si dhe heqja e masave kufizuese para verës, do të jenë kontribuuesit më të mëdhenj në shërimin e plagëve që pandemia la në vitin 2020.



Sektori bankar në Kosovë

Shënim: Të dhënat janë të bazuara në publikimet zyrtare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës


Viti 2020 është karakterizuar nga kriza e pandemisë COVID 19 e cila filloi me një viktimitë në fillim të janarit e duke vazhduar me mbi një milionë viktima në fund të dhjetorit. Edhe Kosova u ndikua nga kjo pandemi globale, duke pasur kështu ndikim të madh në jetën e përditshme të të gjithë njerëzve dhe bizneseve.

Sektori bankar i Kosovës gjithashtu u prek nga kjo situatë në shumë mënyra. Përveç ndërmarjes së masave për t'i mbrojtur punonjësit e saj nga infektimi me virus, bankat duhej të mermin disa masa për ta menaxhuar situatën e re në të cilën ato gjendeshin. Kjo do të thotë vazhdimi i ofrimit të shërbimeve bankare të pandërprera për bazën e saj të klientëve, menaxhimi i likuiditetit, i rrezikut kreditor dhe marrja e një roli proaktiv me Bankën Qendrore të Kosovës dhe Shoqatën e Bankave të Kosovës për t'i mbështetur bizneset lokale të cilat po përballeshin me vështirësi ose u detyruan të mbylleshin për kohësisht gjatë mbylljes totale. Disa masa u prezantuan nga Banka Qendrore e Kosovës dhe të gjitha ato u mbështetën gjithashtu nga sektori bankar. Masa kryesore ishte futja e një moratoriumi për pagesë për të gjitha kreditë për ata klientë bankarë të cilët janë goditur më së shumti nga pandemia.

Numri i bankave që operonin në tregun e Kosovës deri më 31 dhjetor të vitit 2020 ishte njëmbëdhjetë. Nga ky numër, nëntë prej tyre janë me kapital të huaj. Numri i degëve të bankave ishte 211, ndërsa numri i përgjithshëm i punonjësve të sektorit ishte 3,391.

Totali i aseteve të sektorit bankar arriti në 5.4 miliardë euro më 31 dhjetor të vitit 2020 (2019: 4.8 miliardë euro). Rritja e totalit të aseteve në vitin 2020 ishte 12.6 për qind dhe ishte pak më e ulët krahasuar me rritjen nga viti i kaluar, që ishte 13.9 për qind. Rritja e totalit të aseteve të bankave u nxit kryesisht nga një rritje e kredive dhe paradhëniesve për klientët, të cilat vazhduan të ishin kategoria kryesore e aseteve.

Kreditë totale të sektorit bankar vazhduan të rriteshin gjatë vitit 2020, megjithëse rritja ishte pak më e ulët se norma e rritjes në vitin e kaluar. Pandemia COVID-19 pati ndikim në këtë ngadalësim, sidomos gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020, kur e gjithë ekonomia e Kosovës ishte mbyllur. Gjatë kësaj periudhe, vëllimi i kredive të reja u zvogëlua. Bilancet e përgjithshme të kredive nuk u ulën si rezultat i ristrukturimit të kredive, si rezultat i moratoriumit të pagimit të kredisë. Kreditë dhe paradhëniet totale arritën një vlerë prej 3.2 miliardë € (2019: 3.0 miliardë €), e cila është një rritje vjetore prej 7 për qind krahasuar me rritjen e vitit 2019, e cila ishte 10 për qind. Kjo rritje u bë e mundur kryesisht si rezultat i rritjes së kërkesave për kredi të reja dhe kushteve të përgjithshme të favorshme të kredihënies, të ofruara nga bankat.



Kontributi në rritjen e kredive ishte nga kreditë dhe paradhëniet për korporatat jofinanciare me 7 për qind dhe individët me një përqindje të ngjashme prej 7 për qind. Kreditë dhe paradhëniet për korporatat e tjera financiare u rritën me 10 për qind nga viti në vit, megjithatë, pjesa aktive e atyre kredive është relativisht e ulët në 7.7 milionë €. Përbërja e përqindjes së portofolit të kredive dhe paradhëniesve të sektorit bankar më 31 dhjetor të vitit 2020 ishte 64 për qind për korporatat jofinanciare dhe 36 për qind për individët. Përbërja e përqindjes së kredive për korporatat e tjera financiare është ende nën 1 për qind. Kjo shpërndarje e përqindjes midis korporatave jofinanciare dhe individëve ka mbetur e qëndrueshme për pesë vitet e fundit.

Përqendrimi i sektorit ekonomik i kredive dhe paradhëniesve për bizneset vazhdoi të mbizotërohej nga sektori i tregtisë me një pjesëmarrje të përgjithshme prej 48 për qind, përcjellë nga sektori i shërbimeve me 18 për qind dhe industria me 16 për qind. (Burimi: BQK, Buletini Mujor Statistikor, dhjetor 2020, nr. 232).

Investimet e sektorit bankar në letra me vlerë, duke përfshirë obligacionet dhe bonot e thesarit, ishin 584.4 milionë € më 31 dhjetor të vitit 2020 (2019: 526.5 milionë €), një rritje prej 11 për qind. Kjo pasqyroi pozitën e përgjithshme të likuiditetit të rritur të bankave të Kosovës që u ndikua nga një rritje e depozitave të klientëve gjatë vitit.


Depozitat e klientëve vazhduan të jenë kontribuuesi kryesor në financimin e aktiviteteve bankare. Deri më 31 dhjetor 2020, depozitat e klientëve përbënin mbi 80 për qind të detyrimeve totale të sektorit bankar. Një mbështetje e lartë në financimin nga depozitat lokale, veçanërisht nga individët privatë, e bën atë mënyrën më të besueshme për financim, krahasuar me opsionet e tjera, dhe është gjithashtu shumë immune nga lëkundjet ndërkombëtare në tregjet financiare.

Depozitat totale në sektorin bankar arritën në 4.4 miliardë €, me rritje vjetore prej 450 milionë € ose 11.5 për qind (2019: 16.2 për qind). Struktura e depozitave në banka gjithashtu ka ndryshuar gjatë viteve të fundit dhe ka pasur më shumë depozita në llogaritë rrjedhëse dhe më pak në plasmanet e afatizuara dhe llogaritë e kursimeve, si pasojë e ambientit me norma të ulëta.

Më 31 dhjetor 2020, depozitat e paafatizuara përbënin 64 për qind të totalit të depozitave, ndërsa pjesa tjetër ishin depozita të afatizuara dhe depozita kursimesh. Shumica e depozitave të klientëve janë depozita në Euro ku mbi 95 për qind të depozitave të sektorit bankar janë në Euro, monedha zyrtare e Kosovës.

Norma mesatare e depozitave të afatizuara u ul me 0.1 pikë përqindjeje në vitin 2020 në 1.5 për qind krahasuar me 1.6 për qind në dhjetor 2019. Norma e interesit për llogaritë e kursimeve mbeti në 0.4 për qind, një normë e ngjashme me atë që ishte deri më 31 dhjetor 2019. Norma mesatare e depozitave të individëve dhe bizneseve ishte 1.5 për qind. Llogaritë rrjedhëse vazhduan të paguajnë interes zero.

Trendi i uljes së normave të interesit për kreditë ka vazhduar gjithashtu në vitin 2020 dhe kjo është e rëndësishme duke pasur parasysh faktin se, në periudhën e pas luftës, normat e interesit ishin më të larta se ato në rajon. Norma mesatare efektive e interesit për kreditë u ul në 6 për qind, nga 6.4 për qind sa ishte më 31 dhjetor 2019. Kjo normë është e ngjashme me mesataren e tregut në vitin 2018. Normat e interesit për kreditë u ulën gjatë vitit 2020 për bizneset si dhe për individët. Norma mesatare e interesit për bizneset më 31 dhjetor 2020 ishte 5.9 për qind e cila ra nga 6.2 për qind sa ishte më 31 dhjetor 2019. Norma mesatare e interesit për ekonomitë familjare gjithashtu u ul gjatë vitit 2020. Norma mesatare e interesit më 31 dhjetor 2020 ishte 6.2 për qind, krahasuar me 6.8 për qind sa ishte më 31 dhjetor 2019. (Burimi: BQK, Buletini Mujor Statistikor, dhjetor 2020, nr. 220).



Në vitin 2020, sektori bankar në Kosovë arriti një performancë të mirë të përgjithshme në treguesit kyçë financiarë edhe pse kushtet e përgjithshme të pandemisë nuk ishin të favorshme për sektorin dhe tregojnë disa shenja ngadalësimi. Të ardhurat e sektorit bankar u rritën në vitin 2020 në € 279 milionë, nga € 263 milionë sa ishin në vitin 2019. Pjesa më e madhe e të ardhurave gjenerohet nga të ardhurat nga interesi të cilat u rritën nga € 201 milionë në € 212 milionë në vitin 2020. Profitabiliteti i përgjithshëm i sektorit ishte më i ulët për shkak të kostove më të larta të përgjithshme dhe administrative dhe provizionimit të kredive. Shpenzimet totale u rritën në vitin 2020 në € 199 milionë, nga € 177 milionë sa ishin në vitin 2019.

Shpenzimet e interesit u rritën lehtë në vitin 2020 në € 20.9 milionë, nga € 21.5 milionë sa ishin në vitin 2019. Fitimi neto i sektorit ishte € 79.9 milionë i cili ra nga € 86.2 milionë sa ishte një vit më parë.

Kthimi në asete mesatare i sektorit bankar u ul në vitin 2020 me 0.6 pikë përqindjeje në 1.6 për qind (2019: 2.2 për qind) dhe kthimi në kapital mesatar gjithashtu u ul në 14 për qind, nga 18.9 për qind sa ishte në vitin 2019.




Raporti i kredive ndaj depozitave i bankave ishte 74.5 për qind më 31 dhjetor 2020, i cili ra nga 77.6 për qind sa ishte më 31 dhjetor 2019. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (kapitali rregullator/asetet me rrezik të ponderuar) ishte 16.5 për qind, i cili u rrit nga 15.9 për qind sa ishte më 31 dhjetor 2019.

Në vitin 2020, raporti i kredive joperformuese u rrit me 0.7 pikë përqindjeje nga 2 për qind sa ishte në vitin 2019 në 2.7 për qind në fund të vitit 2020. Raporti i mbulueshmërisë së kredive NLP gjithashtu u ul në 141 për qind nga 163.5 për qind sa ishte në vitin 2019.

Performanca dhe financat e Bankës Raiffeisen në Kosovë



Shënim: Analizat e tregut janë bazuar në rezultatet preliminare të botuara nga bankat komerciale, të përgatitura sipas rregullave të Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës.

Totali i asetëve të Bankës Raiffeisen në Kosovë më 31 dhjetor 2020 ishte 1,116 milionë €. Kjo paraqet një rritje prej 9 për qind kur krahasohet me vitin e kaluar (2019: 1,022 milionë €). Përqindja e pjesëmarrjes në treg të totalit të asetëve të Bankës Raiffeisen në Kosovë ishte 21 për qind (2019: 21.5 për qind).



Struktura e asetëve të Bankës Raiffeisen në Kosovë vazhdoi të dominohej nga kreditë dhe paradhëniet për klientët. Deri më 31 dhjetor 2020, 64 për qind e totalit të asetëve ishin të përqendruara në kredi dhe paradhënie për klientët pas provizionimit për humbjet nga kreditë. Kjo u pasua nga 16 për qind në investimet në letra me vlerë. Investimet në letra me vlerë përfshijnë investime në bonot qeveritare dhe të korporatave të vendeve të BE-së dhe SHBA-ve, si dhe bono thesari të lëshuara nga Qeveria e Kosovës.



Investimet në letra me vlerë u rritën në vitin 2020 me 18 për qind. Kjo rritje pasqyron pozicionin e përgjithshëm të likuiditetit të bankës të ndikuar nga një rritje e depozitave të klientëve. Investimet totale në letra me vlerë më 31 dhjetor 2020 ishin 177 milionë €. Investimet në bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës ishin 25 milionë € (2019: 37.1 milionë €) dhe investimet në obligacione të tjera qeveritare dhe të korporatave të vendeve të OECD-së ishin 152 milionë € (2019: 113 milionë €).





Kreditë dhe paradhëniet totale të Bankës Raiffeisen në Kosovë më 31 dhjetor 2020 ishin 709.5 milionë € (2019: 669.5 milionë €). Pjesëmarrja në treg për kredi dhe paradhënie më 31 dhjetor 2020 ishte 22 për qind (2019: 22.7 për qind). Banka ndërmoi një numër masash për t'i adresuar sfidat për shkak të COVID-19, duke u ofruar kështu klientëve mundësinë për të përfituar nga moratoriumi për shlyerje të kredive. Gjatë gjysmës së parë të vitit, banka modifikoi deri në 60 për qind të portofolit të saj të kredive të papaguara (aktive). Fillimisht, pagesat u shtynë për një periudhë prej tre muajsh, por teksa kriza vazhdonte, moratoriumi u zgjat deri në një total prej nëntë muajsh.

Banka Raiffeisen në Kosovë gjithashtu ka ndarë edhe rezerva për humbjet nga kreditë bazuar në politikat e rrezikut kreditor. Këto rezerva për humbjet nga kreditë arrijnë në 24 milionë € (2019: 17.9 milionë €). Këto rezerva llogariten bazuar në modelin e SNRF 9 për humbjet e pritshme nga kreditë dhe pasqyrojnë vlerësimin e Bankës Raiffeisen në Kosovë të rrezikut në portofolin e kredive më 31 dhjetor 2020. Rritja e provizioneve gjatë vitit vjen si rezultat i drejtpërdrejtë i krizës globale të pandemisë pasi përkeqësimi kreditor i një sërë biznesesh pritet të ketë efekte të qëndrueshme. Është vlerësuar duke aplikuar një qasje holistike ku nuk është zbuluar ndonjë zhvlerësim individual në nivel klienti. Rezervat totale të humbjeve nga kreditë për kreditë joperformuese në vitin 2020 ishin 104 për qind (2019: 96 për qind).

Depozitat totale të klientëve të Bankës Raiffeisen në Kosovë arritën në 916 milionë € më 31 dhjetor 2020, një rritje kjo nga 859 milionë € sa ishte më 31 dhjetor 2019. Kjo shënon një rritje prej 6.6 për qind. Gjenerimi i brendshëm i financave gjithashtu kontribuoi drejt një stabiliteti më të madh në sektorin bankar dhe uli ndikimin e çdo paqëndrueshmërie nga tregjet ndërkombëtare.





Kontribuesi më i madh i depozitave nga klientët ishin llogaritë rrjedhëse me 85 për qind. Llogaritë e kursimeve kanë pjesëmarrje prej 14 për qind të totalit të depozitave të klientëve të bankës. Depozitat e afatizuara nga klientët dhe llogaritë e tjera përbëjnë 1 për qind të bazës totale të depozitave. Rritja në bilancet e llogarive rrjedhëse mund të shpjegohet gjithashtu me rënien e normave të interesit në treg për llogaritë e kursimeve dhe depozitat e afatizuara në vitet e fundit. Struktura e detyrimeve të Bankës Raiffeisen në Kosovë ishte e dominuar nga depozitat e klientëve, dhe e njëjta gjë ndodhi edhe me regun e Kosovës.


Në vitin 2020, kapitali aksionar i Bankës Raiffeisen në Kosovë mbeti i pandryshuar në 63 milionë €. Kapitali total më 31 dhjetor 2020 ishte 144 milionë € (2019: 127,4 milionë €), përfshirë edhe 80.6 milionë € në formën e fitimeve të mbajtura. Banka Raiffeisen në Kosovë nuk bëri asnjë shpërndarje të dividendëve gjatë vitit si përgjigje ndaj thirrjeve nga rregullatorët për të shmangur pagesa të tilla për shkak të krizës globale të pandemisë.

Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdon të jetë e kapitalizuar mirë, gjë që u pasqyrua në raportet rregullore të kapitalit të Klasit 1 ndaj aseteve totale me rrezik të ponderuar prej 13.7 për qind (kërkesa ligjore mbi 9 për qind) dhe një raport të kapitalit total (përfshirë Klasin 2) ndaj aseteve me rrezik të ponderuar prej 15.5 për qind (kërkesa ligjore 12 për qind). Në llogaritjen e kapitalit të Klasit 2, Banka Raiffeisen në Kosovë ka përfshirë shumën prej 19 milionë € të borxhit të varur me një maturim fillestar prej dhjetë vjetësh, i ulur me 60 për qind në përputhje me kërkesat rregullore. Kërkesat e mësipërme të kapitalit u llogaritën në përputhje me rregulloren e BQK-së mbi mjaftueshmërinë e kapitalit dhe rregulloret dhe rregullat tjera rregullative të zbatueshme.

Të ardhurat neto pas tatimit në vitin 2020 ishin 16.7 milionë € (2019: 18.3 milionë €). Ky rezultat është llogaritur bazuar në Pasqyrat Financiare sipas SNRF, të përfshira në këtë raport. Banka Raiffeisen në Kosovë gjithashtu përgatiti raporte financiare duke u bazuar në SNRF, të cilat pasqyrojnë kërkesat shtesë nga Rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës deri në përmbylljen e vitit financiar 2019. Sidoqoftë, më 1 janar 2020, BQK-ja miratoi një rregullore të re për zbatimin e plotë të SNRF-ve. Pasqyrat sipas SNRF-ve i dërgohen Bankës Qendrore në baza të rregullta mujore dhe gjithashtu publikohen në baza tremujore në faqen e internetit të Bankës Raiffeisen në Kosovë si dhe në portalet lokale të lajmeve elektronike. Më shumë detaje mbi tranzicionin dhe efektet e këtij tranzicioni nga rregullat e BQK-së në pasqyrat e plota të SNRF-ve shpalosen në seksionin që përmban pasqyrat financiare sipas SNRF-ve.


Zhvillimi dhe struktura e të ardhurave bruto

në milionë euro



Zhvillimi i shpenzimeve të përgjithshme administrative

në milionë euro



Të ardhurat e Bankës Raiffesen në Kosovë ishin të dominuara fuqimisht nga të ardhurat e gjeneruara nga kreditë dhe paradhëniet për klientët lokalë. Të ardhurat nga interesi për kreditë dhe paradhëniet vazhdojnë të jenë burimi kryesor i të ardhurave me gjithë rënien e normave për kredi në treg si dhe rendimenteve shumë të ulëta e nganjëherë negative në bonot e lëshuara nga qeveritë e OECD-së ose plasmaneve të tregut të parave.

Në vitin 2020, të ardhurat neto nga interesi u rritën krahasuar me një vit më parë me 5 për qind edhe pse ekonomia po kalonte kohë të vështira me krizën pandemike. Sektori zbatoi një program të madh të moratoriumit të pagesës së kredive në përputhje me udhëzimet e BQK-së që nënkuptonte se interesi dhe pagesa e principalit u shtynë. Sidoqoftë, të ardhurat nga interesi llogariten pavarësisht nga moratoriumi, duke marrë parasysh parimin akrual të kontabilitetit.

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet dhe të ardhurat e tjera gjithashtu mbetën të fuqishme, pavarësisht krizës pasi shumica e të ardhurave nga tarifat gjenerohen në biznesin e degëve që ndonjëherë kërkon prani fizike. Ndërsa të ardhurat e tjera u rritën pavarësisht krizës, si rezultat i rritjes së aktivitetit nga Qendra e Kompetencës së bankës. Këto shërbime jobankare përbajnë të ardhura në lidhje me një numër të kufizuar të shërbimeve të TI-së të ofruara për Zyrën Qendrore të RBI-së në Vjenë dhe kompanitë e tjera të konsoliduara të RBI-së.

Shpenzimet e përgjithshme dhe ato administrative më 31 dhjetor 2020 ishin 30.8 milionë € (2019: 29.4 milionë €). Raporti të ardhura/kosto ishte 54 për qind (2019: 53.3 për qind). Kostot më të larta raportohen në kostot rrjedhëse të bankës dhe në shpenzimet e zhvlerësimit kryesisht si rezultat i investimeve të bankës në zyrën e re qendrore me lokacion në Prishtinë. Kostot e stafit përfshijnë gjithashtu kosto, të tilla si trajnime dhe zhvillime tjera profesionale. Këto kosto vazhduan të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve operacionale. Këtë vit, banka njohu gjithashtu një humbje të modifikimit të kredive prej 170 mijë € e cila u llogarit si rezultat i shtyrjeve të pagesave në moratoriumet e kredive të vendosura për shkak të pandemisë COVID-19.

Theuari, menaxhimi i aseteve dhe detyrimeve

Menaxhimi i aseteve dhe detyrimeve

Viti 2020 do të mbahet mend si vit i pandemisë. Sidoqoftë, kosovarët ruajtën besimin e tyre në sistemin bankar si një strehë e sigurt për kursimet e tyre dhe morën kredi për bizneset dhe ekonomitë e tyre familjare, me një rritje pak më të ulët se në vitin 2019. Bilanci i përgjithshëm i sektorit bankar tejkaloi € 5.35 miliardë dhe kreditë arritën në rreth 3.246 miliardë €, që është baras me 47 për qind të BPV-së. Depozitat totale arritën në 4,34 miliardë € dhe tregu mbajti një raport të shëndoshë të depozitave ndaj kredive prej më pak se 75 për qind në fund të vitit 2020. Sektori bankar në Kosovë është i vetëmjaftueshëm për sa i përket financimit, duke pasur 2.94 miliardë € në financim nga ekonomitë familjare më 31 dhjetor 2020.

Raporti i kredive për ekonomitë familjare është rreth 110 për qind, gjë që tregon për një burim të shëndoshë, të besueshëm dhe të vetëqëndrueshëm të financimit për bankat në Kosovë. Tregu përbëhet nga njëmbëdhjetë banka, dhe tri bankat kryesore mbajnë 55.8 për qind të totalit të aseteve, dhe nëntë bankat që janë në pronësi të huaj përbëjnë 86.5 për qind të totalit të aseteve. Norma mesatare e kredive përcaktohet në 6 për qind në sektorin bankar dhe kthimi në asete është 1.6 për qind në vitin 2020. ROE mesatare është 14 për qind dhe raporti i likuiditetit në treg është 39.8 për qind. Performanca e sektorit bankar është solide dhe për këtë arsye ai ka arritur ta mbështesë ekonominë, pavarësisht vitit pandemik, dhe sektori bankar tani është i kapitalizuar mjaft mirë. Të ardhurat nga interesi janë më të larta nominalisht, megjithatë, rënia e normave të interesit të kredive vazhdon, e mbështetur nga NPL-të e ulëta dhe kostoja e ulët e fondeve për bankat që veprojnë në Kosovë.

Raporti i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) mbi treguesit kryesorë financiarë

Parametrat kryesorë të sektorit bankar	2019	2020
Rritja e kredive	10%	7.1%
Rritja e depozitave	16.2%	11.5%
Raporti i kredive ndaj depozitave	77.6%	74.5%
Raporti i likuiditetit	38.7%	39.8%
NPL	2%	2.7%
Raporti i mbulueshmërisë së NPL	163.5%	141.4%
Kthimi në asete	2.2%	1.6%
Kthimi në kapital	18.9%	14%
Nr. i punonjësve	3,331	3,391
Nr. i bankave	10	11
Fitimi	86.2	79.9
Të ardhurat	263.2	279.3
Prej tyre të ardhura nga interesi	200.9	212.2
Shpenzimet e interesit	-21.5	-20.9
Kostot administrative	-107.1	-108.1
Norma e interesit të kredisë	6.4%	6%

Përkundër një performace solide bankare, FMN-ja në raportin e saj të shkurtit të vitit 2021, parashikon vitin 2020 si një tkurrje ekonomike të vlerësuar prej - 6.4 për qind dhe një deficit të llogarisë rrjedhëse rreth - 7.5 për qind. Pritshmëritë e inflacionit duken të ankoruara në rreth 1.5 për qind deri në vitin 2022, sipas pritshmërive të FMN-së.

Në vitin 2020, banka rriti depozitat e saj me 8.8 për qind dhe portofolin e kredive të klientëve me 6.7 për qind. Banka përqendrohet në depozitat e qëndrueshme të ekonomive familjare me klientët si bazën e saj kryesore të financimit për operacionet kreditore.

Financimi kryesor

Banka Raiffeisen në Kosovë përdor modelimin sasior për ta matur pandryshueshmërinë e depozitave të klientëve për asetet dhe detyrimet e saj të jomaturuese, për qëllime të rrezikut të normës së interesit por edhe për qëllime të rrezikut të likuiditetit, si për klientët Retail ashtu edhe për ata Joretail. Burimet e financimit të bankës erdhën kryesisht nga depozitat e qëndrueshme të klientëve Retail që arrinin në 85 për qind të depozitave totale të bankës. Efekti i përbashkuar i një pozicioni likuiditeti të lartë dhe një pozicioni të lartë pandryshueshmërie krijoi një pozicion të qëndrueshëm likuiditeti.

Likuiditeti

Në fund të vitit 2020, banka kishte raport të financimit të qëndrueshëm neto (NSFR) mbi 139 për qind, dhe Raport të Mbulueshmërisë së Likuiditetit (LCR) prej 497 për qind. Të dy raportet tregojnë rritje në krahasim me fundin e vitit 2019. Likuiditeti i bankës përbëhet nga mbajtja e investimeve në para të gatshme nëpër degë, Bonot Qeveritare, Bonot e Korporatave dhe FI, investimet në Tregun e Parave.

Rreziku i normës së interesit në librin bankar dhe strategjia

Në disa pjesë, banka ka rritur kohëzgjatjen e saj të normës së interesit për bonot dhe strategjia e saj parashikon transformim pozitiv të maturitetit të bankës në një mjedis me kthime më të ulëta. Kjo qasje ishte jashtëzakonisht e dobishme në situatën e paqëndrueshme të pandemisë. Për më tepër, një përqindje më e lartë e kredive të klientëve me normë të ndryshueshme, krahasuar me vitet më parë, u mundëson klientëve të përfitojnë nga rendimente më të ulëta, ndërsa banka mban marzhën e saj fikse. Pozicionimi i duhur dhe i matur i bilancit të normës së interesit është shumë i rëndësishëm për menaxhmentin dhe aksionarët e bankës.

Në një kontekst më të gjerë: tabela më poshtë tregon ekspozimet e P&L, sipas valutës, për ndryshim prej 1 pike bazë në lakore. Banka mban afatgjata fikse dhe afatgjata variabile, siç përshkruhet në tabelën më poshtë. Banka aktualisht nuk është e angazhuar në ALM aktive por ofron dhe mirëmban produkte me normë të ndryshueshme për ta përmirësuar ndryshueshmërinë e aseteve të bankës.

Ekspozimi BPV

Valuta	Ekspozimi për CCY	Deri në 1 vit	Deri në 3 vjet	Deri në 5 vjet	Deri në 10 vjet	Mbi 10 vjet
BPV totale	15,204					
CHF	(2)	(2)	-	-	-	-
EUR	12,895	(11,129)	40,644	25,731	(41,073)	(1,279)
GBP	(5)	(5)	-	-	-	-
USD	2,303	(932)	705	2,530	-	-

Vlera e pikëve bazë të normave të interesit (BPV), në vitin 2020, tregoi pozicion të BPV në fund të vitit prej rreth 15.2 mijë dhe rritje prej afërsisht 2.7 mijë, krahasuar me fundin e vitit 2019. Vlera në rrezik 99 Ditore në fund të vitit 2020 ishte 443 mijë € .

Derivatët financiarë në lidhje me librin bankar

Portofoli i shkëmbimeve të normave të interesit të Bankës Raiffeisen në Kosovë është mjet i rëndësishëm për menaxhimin e rrezikut për portofolin e saj afatgjatë. Sidoqoftë, efekti i përgjithshëm i IRS është zvogëluar në shumën nominale prej më pak se 6,63 milionë €, më 31 dhjetor të vitit 2020. Banka mbështetet në mbrojtjen natyrore të pozicionit të saj të normës së interesit duke përdorur produkte me normë të ndryshueshme.

Letrat me vlerë të Qeverisë/FI dhe korporatave


Banka rriti zotërimet e saj të investimeve financiare në vitin 2010 për 26.7 milionë €, duke e përfunduar vitin me një vëllim prej 177 milionë €. Rritja e vëllimit është e ngjashme me rritjen që ka ndodhur në vitin 2019. Bankat duhet të mbajnë shumicën e aseteve në Asete Likuide të Cilësisë së Lartë, në mënyrë që të përmbushin likuiditetin e tyre të detyrueshëm (të kërkuar ligjërishi). Sidoqoftë, rreth 20 për qind e këtij portofoli është alokuar në bono të korporatave dhe institucioneve financiare (FI) në mënyrë që të përmirësohet performanca e përgjithshme e rendimentit. Tabela më poshtë paraqet alokimin e saj aktual në fund të vitit 2020.

Sistemi i përdorur i **Vlerësimit të Moody-t** si % e alokimit të bonove në tabelën më poshtë:

Val/Vitet	<0.5V	<1V	<2V	<3V	<=5V
EUR					
Aaa	5.77	2.88	2.88	-	-
Aa1	-	13.27	8.08	-	-
Aa2	-	8.65	5.54	-	-
A2	-	2.71	-	1.73	-
A3	16.44	-	-	-	-
Të pavlerësuar	4.03	-	5.53	2.17	2.43
USD					
Aaa	6.77	4.23	4.94	1.95	-

(*)% e obligacioneve të mbajtura nga Banka Raiffeisen në Kosovë në librin e saj të obligacioneve (**) të renditura sipas tabelës referuese të vlerësimit të Moody-t

Paralelisht, tregu i përgjithshëm për bonot e thesarit të Kosovës vazhdoi ritmin e tij të zhvillimit. Në rolin e saj si tregtues (dealer) kryesor, Banka Raiffeisen në Kosovë dhe klientët e saj vazhduan të përcaktojnë krijimin e tregut sekondar të borxhit të qeverisë të Kosovës, megjithëse me një ritëm më të ngadaltë për shkak të atraktivitetit të tij në rënie, duke pasur parasysh rendimentet më të ulëta të arritura në dy vitet e fundit. Raporti shuma e kërkuar/shuma e emetuar (Bid to Cover) në Ankandin e Kosovës rregullisht tejkalon një raport prej 2, duke treguar një treg shumë likuid në ankandet primare. Tregu sekondar është ende i pazhvilluar mjaftueshëm.



Tregëtimi në valuta dhe tregje

Banka është lidere në shitjet valutare që nga viti 2002 në Kosovë. Megjithëse në një vend ku përdoret monedha Euro, Banka Raiffeisen në Kosovë mban pozicionin e saj si lidere e tregut në shitjet FX dhe shitjet e brokerimit në tregun sekondar për bonot e thesarit dhe shitjet e ekuitetit. Në fund të vitit 2019, banka ka prezantuar sistemin e tregtimit elektronik për klientët e saj dhe llogarinë e shitjeve elektronike për pjesën më të madhe të biznesit të shitjeve FX në vitin 2020.

Për më tepër, numri i klientëve që tregtojnë në ekuitet dhe fonde u rrit në vitin 2020. Klientët shfrytëzuan mundësinë për të investuar në tregjet e maturuara të ekuitetit në vitin 2020 dhe Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdon të jetë ofruesi kryesor i një mundësie ndërkombëtare të tregut që nga viti 2012.

Segmentet e biznesit

Korporata

Kombinimi i fuqisë financiare, bazës së lartë të kapitalit dhe njohurisë dhe ekspertizës së thellë të menaxherëve të marrëdhënieve të korporatave dhe të produkteve mundëson që biznesi i korporatave të Bankës Raiffeisen në Kosovë të ketë pozicion unik në krahasim me konkurrencën. Si rezultat, banka vazhdoi ta ruajë pozicionin e saj si lidere e tregut në Kosovë duke mbështetur më tej rritjen e marrëdhënieve të saj me klientët dhe përvetësimin e klientëve të rinj në vitin 2020.

Një nga prioritetet kryesore të bankës ishte procesi i moratoriumit të pagesës së kredive me qëllim për t'i ndihmuar klientët ta kapërcejnë situatën e vështirë dhe të paparashikueshme të krijuar nga COVID-19, duke siguruar pajtueshmëri me rregulloren dhe duke menaxhuar në mënyrë aktive parandalimin e delikuençave. Përkundër situatës pandemike, biznesi i korporatave vazhdoi të ketë performancë shumë të mirë gjatë vitit 2020 dhe rriti portofolin e kredisë me 8 për qind. Gjithashtu u mbajti një portofol me cilësi shumë të mirë me një raport të NPL-ve prej 2.67 për qind.

Në vitin 2020, biznesi i korporatave mbajti portofol të lartë rekord të kredidhënies me 240 milionë €, me përmirësim shumë të mirë të cilësisë së asetëve që rezultoi në kredi joperformuese prej vetëm 2.67 për qind të portofolit të kredive. Një portofol i kolateralizuar shumë mirë gjithashtu rezultoi në një kthim të qëndrueshëm në kapitalin e korigjuar për rrezikun (RoRAC) prej 131.23 për qind. Prioritet i lartë iu dha gjithashtu sigurimit të përputhshmërisë së plotë me kërkesat e rritura rregullatore, si në nivelin vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar, po ashtu edhe me kërkesat e grupit.

Ndërmarrjet e vogla

Viti 2020 ishte shumë sfidues për ndërmarrjet e vogla në përgjithësi në Kosovë, duke pasur parasysh ndikimin e pandemisë COVID-19. Kështu, fokusi kryesor i bankës ishte identifikimi i mundësive se si të sigurohet mbështetje për klientët NV për ta kapërcyer këtë situatë të paparashikuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Banka ofroi dy faza moratoriumi për klientët e saj. Në të njëjtën kohë, segmenti i Ndërmarrjeve të Vogla (NV) vazhdoi të kultivojë marrëdhëniet me klientët përmes menaxherëve të marrëdhënieve me përvojë, të vendosur në katër rajone të Kosovës. Si rezultat, banka arriti të mbajë një portofol të NV relativisht të qëndrueshëm dhe të cilësisë së mirë.

Një sërë iniciativash në efikasitetin e procesit u ndërmorën gjatë vitit 2020. Shumica e këtyre iniciativave u përqendruan në thjeshtimin e përvojës së klientit, duke e bërë atë më të lehtë ose të përshtatshme për madhësinë dhe kompleksitetin e aplikacioneve. Si rrjedhojë, Segmenti i NV-ve në Bankën Raiffeisen në Kosovë është vlerësuar si Banka më e mirë e Rrjetit në përmirësimin e Efikasitetit të NV në vitin 2020, nga Raiffeisen Bank International (RBI).

Gjatë vitit 2020, banka ka lansuar një nga projektet më të rëndësishme, Retailizimi i NV-ve (SE Retailization). Përveç rritjes së thjeshtësisë, qëllimi i kësaj iniciative ishte digjitalizimi i procesit për klientët e NV që aplikojnë për kredi, duke u mundësuar menaxherëve të marrëdhënieve të NV të kenë një pamje prej 360 shkallë në dosjen e klientit, si dhe kohë shumë më të shpejtë aprovimi, të cilat pritet të sjellin rritje të ndjeshme të efikasitetit dhe përmirësimit të përvojës së klientit.

Ndërmarrjet mikro

- Prandaj, banka angazhohet të harmonizojë strukturat dhe proceset e saj të menaxhimit me këtë qëndrim. Në tre fushat e përgjegjësive të qëndrueshmërisë strategjike, pra "Bankier i Përgjegjshëm", "Partner i Drejtë" dhe "Qytetar i Angazhuar", të cilat janë të lidhura ngushtë me aktivitetet e saj të biznesit, banka përpiqet të zbatojë në mënyrë profesionale dhe efektive vlerat dhe kompetencat e saj për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm si në kompani ashtu edhe në shoqëri.

Qëllimi i qëndrueshmërisë së bankës është të përqendrohet në ato fusha me një ndikim të rëndësishëm potencial. Kjo kërkon që banka të përmirësojë vazhdimisht ndikimin e qëndrueshmërisë së aktiviteteve të saj të biznesit dhe të zhvillojë mënyra për të matur dhe verifikuar këtë ndikim. Duke vepruar kështu, banka shpreson të rrisë vlerën afatgjatë të bankës duke kontribuar gjithashtu në mënyrë aktive në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë.

Banka e kupton qëndrueshmërinë si aktivitete të përgjegjshme korporative për sukses afatgjatë ekonomik duke marrë parasysh aspektet kryesore shoqërore dhe mjedisore. Si një filial i RBI-së, Banka Raiffeisen në Kosovë është e angazhuar të veprojë në përputhje me Parimet e "Global Compact" të OKB-së.

Dhjetë parimet e Kompaktit Global të OKB-së

Të drejtat e njeriut

Parimi 1: Ne e mbështesim dhe respektojmë mbrojtjen e të drejtave ndërkombëtare të njeriut brenda sferës tonë të ndikimit.

Parimi 2: Ne sigurohemi që nuk jemi bashkëpunëtorë në abuzimin me të drejtat e njeriut.

Labour

Parimi 3: Ne e mbështesim lirinë e asociimit dhe njohjen e efikasë të së drejtës për negociata lidhur me Marrëveshjen Kolektive.

Parimi 4: Ne e mbështesim eliminimin e të gjitha formave të punës së detyruar ose të dhunshme.

Parimi 5: Ne e mbështesim heqjen e punës së fëmijëve.

Parimi 6: Ne e mbështesim eliminimin e diskriminimit në punësim dhe profesion.

Environment

Parimi 7: Ne e mbështesim qasjen parandaluese ndaj sfidave mjedisore.

Parimi 8: Ne ndërmarrim iniciativa për promovimin e përgjegjësisë më të madhe mjedisore.

Parimi 9: Ne e inkurajojmë zhvillimin dhe përhapjen e teknologjive miqësore ndaj mjedisit.

Anti-Corruption

Parimi 10: Ne punojmë kundër korrupsionit në të gjitha format e tij, përfshirë zhvatjen dhe rryshfetin.

Si anëtar i kahmotshëm i Iniciativës Financiare UNEP, RBI nënshkroi “Parimet për Bankimin e Përgjegjshëm” në fillim të vitit 2021, duke u zotuar kështu të zbatojë gjashtë parimet në të gjithë Grupin e saj si dhe në Banka Raiffeisen në Kosovë. Këto parime ofrojnë kornizën për një bankë të qëndrueshme dhe ndihmojnë industrinë të tregojë se si mund të japë një kontribut pozitiv në shoqëri. Ato ankorojnë qëndrueshmërinë në një nivel strategjik, portofoli dhe transaksionesh dhe në të gjitha fushat e biznesit.

Parimet për shërbime të përgjegjshme bankare të Iniciativës Financiare të UNEP

Harmonizimi

Parimi 1: Ne do ta harmonizojmë strategjinë tonë biznesore për të qenë në përputhje dhe për të kontribuar në nevojat individuale dhe qëllimet e shoqërisë, siç shprehen në Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm, Marrëveshjen e Parisit për Klimën dhe kornizat relevante kombëtare dhe rajonale.

Ndikimi dhe vendosja e caqeve

Parimi 2: Ne vazhdimisht do t'i rrisim ndikimet tona pozitive përdërisa i zvogëlojmë ndikimet negative dhe i menaxhojmë rreziqet ndaj personave dhe mjedisit që rezultojnë nga aktivitetet, produktet dhe shërbimet tona. Për këtë qëllim, ne do të vendosim dhe publikojmë caqe se ku do të mund t'i kemi ndikimet më të mëdha.

Klientët dhe konsumatorët

Parimi 3: Ne do të punojmë me përgjegjësi me konsumatorët tanë për t'i inkurajuar praktikatat e qëndrueshme dhe për t'i mundësuar aktivitetet ekonomike që krijojnë prosperitet të përbashkët për gjeneratat e tanishme dhe të ardhshme.

Akterët

Parimi 4: Ne do të konsultohemi, angazhohemi dhe krijojmë partneritete në mënyrë proaktive dhe me përgjegjësi me akterët përkatës për t'i arritur objektivat e shoqërisë.

Qeverisja dhe kultura


Parimi 5: Ne do t'i zbatojmë zotimet tona për këto parime nëpërmjet qeverisjes efikase dhe kulturës së shërbimeve bankare me përgjegjësi.

Transparenca dhe llogaridhënia

Parimi 6: Ne do ta shqyrtojmë në baza periodike zbatimin tonë individual dhe kolektiv të këtyre parimeve dhe do të jemi transparent dhe llogaridhënës për ndikimet tona pozitive dhe negative dhe kontributin tonë për objektivat e shoqërisë.

Strategjia e qëndrueshmërisë

Strategjia e Qëndrueshmërisë e Bankës Raiffeisen në Kosovë përbëhet nga nëntë fusha kryesore veprimi brenda të cilave banka përqendron menaxhimin e saj të qëndrueshmërisë. Në mënyrë që të adresojë sistematikisht këto fusha thelbësore, të cilat janë gjithashtu të rëndësishme për palët e saj të interesit, banka vazhdimisht përpiqet të përmirësojë strategjinë e saj të qëndrueshmërisë. Në identifikimin e fushave kryesore të veprimit, banka mbështetet në perspektivën RBI-së si dhe perspektivat e aktorëve të saj që përfshijnë punonjësit e saj, klientët, aksionarët dhe furnizuesit, si dhe organizatat joqeveritare dhe një numër grupesh të tjera të palëve të interesit. Banka kryen një analizë shumë-fazëshe të materialitetit, mbi një bazë të rregullt, për t'i prioritetizuar këto fusha të veprimtarisë. Për këtë arsye, si dhe për të bërë ndonjë rregullim në strategjinë e saj të qëndrueshmërisë, banka e sheh si shumë të vlefshëm mbajtjen e dialogut me palët e saj të interesit.



Qasja e Bankës si krijues të një institucioni dhe shoqërie të qëndrueshme

Bankier i përgjegjshëm

Banka Raiffeisen në Kosovë në vitin 2020 kishte shumë aktivitete që kanë efektin e të qenit një bankier i përgjegjshëm në Kosovë. Për sa i përket qeverisjes dhe pajtueshmërisë, banka i zbaton këto vlera në të gjitha aktivitetet e saj. Baza për këtë është Kodi i Sjelljes i bankës, i cili zbatohet në të gjithë Grupin, për të gjithë anëtarët e stafit dhe partnerët e saj të biznesit.

Politika e huadhënies dhe politika e vendimeve të huadhënies

Modeli i biznesit i bankës është i orientuar rreth qëllimit strategjik të nivelit të lartë të krijimit të vlerës afatgjatë. Huadhënia e përgjegjshme është një komponentë e rëndësishme e këtij modeli. Banka e arrin këtë me një politikë huadhënieje që bazohet në vazhdimësi. Mbetet një huadhënës i drejtë dhe i besueshëm për bizneset me perspektivë në të ardhmen, edhe në kohë të vështira. Për më tepër, banka mban një pozicion të qartë në lidhje me trajtimin e fushave të ndjeshme të biznesit. Banka Raiffeisen në Kosovë ka prezantuar një sistem të menaxhimit mjedisor dhe social, duke përfshirë politikën shoqëruese. Qëllimi i kësaj politike është kryerja e biznesit si një qytetar korporativ i mirë dhe i përgjegjshëm. Në përputhje me këtë, banka përpiqet të veprojë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e Kosovës, përfshirë ato që kanë të bëjnë me çështje mjedisore dhe sociale dhe është e angazhuar për të përmirësuar kapacitetin e menaxhimit të rrezikut mjedisor dhe social për të zvogëluar rreziqet e kredisë dhe përgjegjësisë.

Huadhënia e qëndrueshme

Gjatë vitit 2020, situata ishte e ndryshme nga vitet e tjera pasi situata e pandemisë ka prekur edhe huadhënien tjetër të qëndrueshme, dhe fokusi i bankës ishte të ndihmonte klientët e saj të përballojnë situatën dhe t'i ndihmojë ta kapërcejnë atë përmes moratoriumeve.

Huadhënia e përgjegjshme

Banka Raiffeisen në Kosovë është e përkushtuar ndaj politikave të përgjegjshme të huadhënies. Gjatë vitit 2020 me COVID-19, roli i bankës ishte të ndihmonte klientët e saj për të kapërcyer barrën e tyre financiare duke iu ofruar moratorium individëve dhe bizneseve. Kjo nënkuptonte që banka ishte përgjegjëse të mos i linte klientët e saj të dështonin në pagesa për shkak të situatës së pandemisë dhe statusit të tyre financiar.

Kënaqshmëria e klientëve

Kënaqshmëria e klientëve është prioriteti kryesor i bankës. Prandaj, kjo matet rregullisht si në biznesin retail ashtu edhe në atë të korporatave, në mënyrë që të mundësohet veprimi i duhur kur është e nevojshme.

Praktikat e përgjegjshme të shitjeve dhe marketingu

Çështjet financiare janë çështje besimi. Prandaj, Banka Raiffeisen në Kosovë përpiqet për etiketim të qartë dhe transparent të produkteve dhe shërbimeve për të gjithë klientët dhe palët e interesuara. Gjatë reklamimit dhe marketingut të produkteve të saj, banka u përmbahet parimeve strikte që synojnë të mbrojnë klientët e saj. Reklamimi i rremë ose mashtrues është diçka që banka mendon se është e papranueshme.

Partner i ndershëm*Korrupsioni dhe pastrimi i parave*

Banka ndërmerr të gjitha veprimet në mënyrë që të shmangët çdo formë e korrupsionit, pastrimit të parave, mashtrimit ose tregtimit "insajder". Një parakusht në biznesin dhe praktikën e saj operacionale është sjellja e drejtë, etike dhe në përputhje me ligjin e të gjithë anëtarëve të stafit. Mekanizmat për respektimin e tij janë përmes Kodit të Sjelljes (CoC) dhe rregulloreve të qarta dhe të hollësishme që përfshihen në Manualin e Pajtueshmërisë.

Burimet njerëzore

Të qenit punëdhënësi i preferuar në Kosovë mbetet objektivi kryesor i bankës. Gjatë pandemisë kjo u bë më edhe më e rëndësishme ndërsa në fokus ishte mirëqenia dhe menaxhimi i shëndetit. Në përgjithësi, banka ishte e qëndrueshme me një rënie të lehtë të numrit të stafit gjatë vitit 2020. Mosha mesatare e punonjësve mbetet 37 vjeç, duke treguar një kapital njerëzor relativisht të ri të angazhuar në bankë ndërsa 53 për qind e totalit të punonjësve ishin gra, ndërsa 47 për qind e gjithsej punonjësve ishin burra.

Zhvillimi profesional

Banka është e përkushtuar të ngritë dhe zhvillojë njerëzit, njohuritë dhe aftësitë e tyre duke ofruar një larmi mundësish të të mësuarit dhe zhvillimit. Një fokus specifik iu dha konceptit të vetë-zhvillimit dhe iniciativës vetjake për mësim vetanak online në vitin 2020. Sistemi i përditësuar rishtas i Menaxhimit të të mësuarit online ofron shërbime me cilësi të lartë dhe përvojë moderne të të mësuarit për personat që përdorin teknologjinë më të fundit.

Ekologjia e brendshme

Menaxhimi i rreziqeve klimatike - jo vetëm në ekologjinë e brendshme - është një detyrë gjithnjë e më e rëndësishme për ekonominë. Jo pa arsye Forumi Ekonomik Botëror klasifikoi ndryshimet klimatike si njërin ndër pesë rreziqet më të mëdha në Raportin Global të Rreziqeve 2021. Prandaj, në Bankën Raiffeisen në Kosovë, mbrojtja efektive e klimës është bërë një faktor konkurrues dhe një aktivitet i rëndësishëm për bankën. Banka e sheh mbrojtjen e mjedisit dhe klimës si pjesë të përgjegjësisë së saj ndaj shoqërisë dhe e sheh veten si një partner të drejtë të mjedisit.

Qytetar i angazhuar

Banka e konsideron veten një qytetar të angazhuar korporativ, i cili në mënyrë aktive përkrah zhvillimin e qëndrueshëm në shoqëri. Angazhimi si qytetar korporativ shkon përtej biznesit kryesor dhe synon zhvillimin e popullatës së re të Kosovës në kulturë, sport, teknologji dhe arsim. Përveç kësaj, banka gjithashtu kontribuoi në projektet e mirëqenies sociale, me një fokus të veçantë tek fëmijët dhe nënat në Kosovë.

Projekte dhe nisma të mbështetura

Gjatë vitit 2020, Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdoi të sponsorizojë projekte të ndryshme në pesë fushat kryesore: mirëqenia sociale, kultura, arsimit, shëndetësia dhe sporti. Lidhur me mirëqenien sociale, banka vazhdoi të mbështesë organizatën Aksioni për Nënën dhe Fëmijë që punon në rritjen e ndërgjegjësisë dhe mbështetjen e nënave të reja në Kosovë dhe këtë vit për

shkak të situatës me pandeminë COVID-19, banka siguroi pajisjet dhe materialet e nevojshme për njësinë në kuadër të Klinikës Gjinekologjike, që është krijuar për trajtimin e grave shtatzëna të infektuara me COVID-19, përmes AMC me qëllimin kryesor të trajtimit dhe mbrojtjes më të mirë të nënës dhe fëmijëve të tyre të porsalindur nga COVID-19.

Ndërsa pandemia COVID-19 vazhdoi të rritet, një nga gjërat që ishte bërë e qartë ishte se nuk kishte pajisje të mjaftueshme mbrojtëse personale për t'i pajisur të gjithë profesionistët shëndetësorë dhe kujdestarët që e kanë vënë veten në rrezik duke trajtuar njerëzit e goditur me sëmundjen. Prandaj, si pjesë e mirëqenies sociale, Banka Raiffeisen në Kosovë gjatë vitit 2020 mbështeti prodhimin e 1300 maskave mbrojtëse "mburoja të fytyrës" nga Bonevet për mjekët që punojnë në qendrat rajonale të kujdesit shëndetësor.

Një bashkëpunim tjetër në fushën e mirëqenies gjatë vitit 2020 ishte nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) me Zyrën e Unicef-it në Kosovë, ku banka dhe Unicef-i ranë dakord të bashkëpunojnë dhe mbështesin njëri-tjetrin për çështje të rëndësishme shoqërore, duke përfshirë por pa u kufizuar në, të drejtat themelore të njeriut, kujdesin për fëmijët, promovimi i shëndetit dhe gjithashtu duke synuar zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe mbrojtës për familjet në nevojë që preken nga COVID-19. Si pjesë e Memorandumit të Mirëkuptimit me Unicef-in, banka dhuroi gjithashtu dy makina për Qendrat e Kujdesit Shëndetësor në dy qendra rajonale të kujdesit shëndetësor me numrin më të lartë të vizitave dhe makinat do të përdoren për vizita në shtëpi.

Kultura mbetet një nga fushat kryesore ku banka vazhdoi të angazhohej. Projekti kryesor kulturor që banka po mbështet për më shumë se dhjetë vjet me radhë është festivali i mirënjohur: Prishtina Film Festival. Ndërsa një nga ngjarjet më të rëndësishme të PriFest është seria e ngjarjeve "PriFORUM Regional Coproduction", e cila sjell kineastië nga vende të ndryshme të Evropës dhe botës në Kosovë. Punëtori të ndara dhe kurse master për artistë të rinj ishin gjithashtu pjesë e festivalit.

Për më tepër, banka vazhdoi të promovojë artin me Galerinë Raiffeisen. Ideja ishte t'u jepte artistëve të rinj, të ardhshëm, mundësinë për të prezantuar punimet e tyre para publikut. Për këtë qëllim, banka ka marrë me qira një hapësirë në Albi Mall, qendra më e madhe tregtare e Kosovës, dhe kjo hapësirë u shndërrua në një hapësirë inovative ku ekspozohen punime të reja nga artistë të rinj çdo muaj. Kjo i ndihmon komunitetit të ketë një vend ku ata mund të kenë një ekspozitë pa asnjë kosto.

Për sa i përket arsimit dhe inovacionit në vitin 2020, Banka Raiffeisen në Kosovë mbështeti projektin Atomi që fokusohet në identifikimin dhe mbështetjen e njerëzve me inteligjencë të jashtëzakonshme, njerëz me dhunti dhe të talentuar në Kosovë. Më saktësisht, qëllimi i Atomi është identifikimi i hershëm i nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme, nxënësve me dhunti dhe të talentuar (këtu e tutje: atomist) në mënyrë që t'u ofrohen mundësi të përshtatshme, kushte, kujdes dhe shkollim të veçantë (pasurim) për këta studentë bazuar në potencialet e tyre intelektuale, talentin, dhuntinë, personalitetin, ambiciet, interesat, motivimin dhe kushtet dhe rrethanat e tyre socio-ekonomike. Të gjitha këto shërbime dhe aktivitete ofrohen në mënyrë që t'u mundësojnë këtyre nxënësve të zhvillojnë dhe realizojnë potencialin e tyre të plotë intelektual dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë së pari në zhvillimin e tyre personal dhe njëkohësisht në interesin shoqëror dhe kombëtar.

Një aktivitet tjetër në fushën e arsimit ishte dhurimi i Tabletave dhe mjeteve shkollore për fëmijët në nevojë. Banka Raiffeisen në Kosovë në bashkëpunim me Fondin e Bamirësisë H. Stepic CEE dhuruan mbi 150 Tableta dhe mbi 250 mjete shkollore për nxënësit me gjendje të dobët ekonomike të shkollave të mesme të ulëta në komunën e Prizrenit.

Gjatë vitit 2020, Banka Raiffeisen në Kosovë gjithashtu mbështeti Green Fest në Mitrovicë me qëllimin e përgjithshëm për të kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe ndërmarrësinë e gjelbër, përmes programit arsimor dhe aktivizmit kulturor.

Pasqyrat financiare

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat e veçanta financiare për vitin e përmbyllur më 31 dhjetor 2020 janë të përgatitura në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Raporti i auditorit të pavarur	41
Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar	42
Pasqyra e veçantë e të ardhurave gjithëpërfshirëse	43
Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në ekuitet	44
Pasqyra e veçantë e rrjedhës së parasë	45
Shënimet për pasqyrat financiare të veçanta	46-111

Deklarata mbi përgjegjësinë e menaxhmentit

Për aksionarët dhe Bordin Mbikëqyrës të Raiffeisen Bank Kosovo Sh.a.


Ne kemi përgatitur pasqyrat financiare si më datën 31 dhjetor 2020 dhe për vitin e mbyllur në atë datë, të cilat paraqesin në mënyrë të saktë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Raiffeisen Bank Kosovo Sh.a. (në tekstin e mëtejshëm "Banka") si më 31 dhjetor 2020 si dhe rezultatet e veprimtarisë së saj dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur. Menaxhmenti është përgjegjës për të siguruar se Banka i mbanë llogaritë në pajtueshmëri me rregulloret bankare të Kosovës dhe të cilat mund të ndryshohen në mënyrë të përshtatshme për të shpalosur me saktësi të arsyeshme pozitën financiare të Bankës dhe rezultatet e veprimtarisë së saj dhe rrjedhën e parasë sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar që përfshijnë edhe Standardet dhe Interpretimet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, të cilat janë nxjerrë nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (IASB) dhe Komiteti Ndërkombëtar për Interpretime të Raportimit Financiar (IFRIC) i IASB-së, të cilat janë relevante për veprimtarinë e saj dhe të cilat ishin në fuqi për periudhën të cilën e mbulojnë të dhënat. Menaxhmenti ka edhe përgjegjësi të përgjithshme për t'i ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm në dispozicionin e vet për të ruajtur asetet e Bankës dhe për të parandaluar dhe zbuluar mashtrimet dhe parregullsitë tjera.

Menaxhmenti konsideron se, gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, Banka i ka shfrytëzuar politikat adekuate kontabël, të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente dhe janë mbështetur nga gjykime dhe vlerësime të arsyeshme dhe të matura, dhe se gjatë kësaj janë respektuar Standardet përkatëse Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Rrjedhimisht, pasqyrat financiare konsiderohen të miratuara nga Bordi Menaxhues.

Pristinë, Kosovë
12 prill 2021


Bordi Menaxhues i Bankës Raiffeisen në Kosovë



Robert Wright
Kryesues i Bordit Menaxhues



Shukri Mustafa
Anëtar i Bordit Menaxhues



Iliriana Toçi
Anëtare e Bordit Menaxhues



Anita Kovacic
Anëtare e Bordit Menaxhues



Johannes Riepl
Anëtar i Bordit Menaxhues

Raporti i auditorit të pavarur

Për aksionarët e Raiffeisen Bank Kosova Sh.A.

Grant Thornton LLC
Rr. Rexhep Mala 18
10 000 Pristina
Kosovo
T +381 38 247 771
+381 38 247 801
F +381 38 247 802
www.granthornton-ks.com

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të ndara të Raiffeisen Bank Kosovë Sh.A. ("Banka"), të cilat përmbajnë pasqyrën e ndarë të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020, dhe pasqyrën e ndarë të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndarë të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e ndarë të flukseve të parasë për vitin e përmbyllur në këtë datë, dhe shënimet e pasqyrat financiare të ndara, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese të ndara paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2020 dhe performancën e saj financiare dhe flukset e saj të parasë për vitin e përmbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të ndara. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me kërkesat etike që janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike të tjera në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin IESBA. Ne besojmë se provat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuarve me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare të ndara

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të ndara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur pasqyrat përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të ndara, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet që lidhen me vijimësinë dhe duke përdorur bazën e vijimësisë të kontabilitetit, përveç nëse menaxhmenti synon të likujdijë Bankën ose të të ndërprisë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare të ndara

Objektivat tona janë të marrim një siguri të arsyeshme mbi atë nëse pasqyrat financiare të ndara në tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, dhe të lëshojmë një raport të auditorit që përshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalië mund të vijnë si rezultat i mashtrimit ose gabimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, mund të pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare të ndara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale të pasqyrave financiare të ndara, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë të auditimit që është e mjaftueshme dhe e përshatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, interpretime të deformuara ose anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një të kuptuar të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, në mënyrë që të hartojmë procedurat e auditimit që janë të përshatshme sipas rrethanave, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një konkluzë mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga menaxhmenti të bazës kontabël të vijimësisë dhe, bazuar në provat e marra të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme në aftësinë e Bankës për të vazhduar veprimtarinë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, neve na kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në lidhje me informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare të ndara ose, nëse këto informacione shpjeguese janë joadekuata, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditorit. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të bëjnë që Banka të ndërprisë veprimtarinë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të ndara, përfshirë informacionet shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare të ndara përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me personat që janë të ngarkuar me qeverisjen e Raiffeisen Bank Kosovë Sh.A., përveç të tjerave, në lidhje fushën e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të konsiderueshme në kontrollin e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit.

Grant Thornton LLC
Pristinë,
12 prill 2021

Suzana Stavrik
Auditore ligjore




Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar

(shumat në € '000)	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Pasuritë			
Paraaja dhe ekuivalentët e saj dhe rezerva e detyrueshme	8	156,178	123,677
Detyrime nga bankat	9	28,575	35,483
Pasuritë financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes	10	3,306	6,060
Pasuritë financiare me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	10	173,453	143,979
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	11	709,515	669,498
Pasuritë e tjera	12	3,428	1,713
Pasuri e shtyrë tatimore	23	118	-
Investimet në filiale	13	2,234	2,234
Pronat, pajisjet dhe pasuritë e paprekshme	14	39,177	39,258
Gjithsej pasuritë		1,115,984	1,021,902
Detyrimet			
Detyrimet ndaj bankave	15	26,882	7,602
Depozitat nga klientët	16	915,626	858,717
Detyrimet financiare të matura me vlerën e drejtë	17	600	687
Detyrimet e tjera	18	8,211	7,351
Provizionet	18	1,234	579
Detyrimi i tatimit të shtyrë	26	-	230
Kreditë e varura	19	19,298	19,325
Gjithsej detyrimet		971,851	894,491
Kapitali i aksionarëve			
Kapitali aksionar		63,000	63,000
Rezerva e vlerës së drejtë		550	480
Rezervat e tjera		1,955	-
Fitimet e mbajtura		78,628	63,931
Gjithsej kapitali i aksionarëve	20	144,133	127,411
Gjithsej detyrimet dhe kapitali i aksionarëve		1,115,984	1,021,902

Pasqyrat Financiare janë aprovuar që të lëshohen në emër të menaxhmentit të Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C dhe janë nënshkruar në emër të tyre më 12 prill 2021.



Fatos Shllaku
Udhëheqës i Financave



Robert Wright
Drejtor Ekzekutiv
Anëtar i Bordit Menaxhues

Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar lexohet së bashku me shënimet që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të veçanta të paraqitura në faqet 48 deri 114.

Pasqyra e veçantë e të ardhurave gjithëpërfshirëse

(shumat në € '000)	Shënimet	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019
Të ardhurat nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv	21	47,381	44,667
Shpenzimet nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv	21	(2,395)	(2,653)
Të ardhurat neto nga interesi		44,986	42,014
Të ardhurat nga dividendi	13	-	804
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	22	17,153	18,174
Shpenzimet nga tarifat dhe komisionet	22	(7,726)	(7,875)
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet		9,427	11,103
Të ardhurat/(shpenzimet) tregtare neto		(15)	113
Shpenzimet e humbjes kreditore për pasuritë financiare	6	(8,085)	(5,737)
Rikuperimet nga kreditë e shlyera më parë		1,127	961
Fitimet neto të pasurive financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	17	70	81
Të ardhurat e tjera operative	23	1,743	1,404
Të ardhurat neto operative		49,253	49,939
Shpenzimet e personelit	24	(13,687)	(13,518)
Zhvlrësimi i pronave dhe pajisjeve dhe ROU	14, 25	(3,874)	(2,870)
Amortizimi i pasurive të paprekshme	14, 25	(1,884)	(1,909)
Shpenzimet e tjera operative	25	(11,334)	(11,132)
Fitimi para tatimit mbi të ardhurat		18,474	20,510
Shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat	26	(1,822)	(2,229)
Fitimi për vitin		16,652	18,281
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse			
<i>Zërat që do të riklasifikohen në fitim ose humbje</i>			
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse		70	866
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		16,722	19,147

Pasqyra e veçantë e të ardhurave gjithëpërfshirëse lexohet së bashku me shënimet që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të veçanta të paraqitura në faqet 48 deri 114.

Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në ekuitet

(shumat në '000 Euro)	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Rezerva e vlerës së drejtë	Kapitali total i aksionerit
Gjendja më 1 janar 2019	63,000	65,050	-	(386)	127,664
Fitimi i vitit	-	18,281	-	-	18,281
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	866	866
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	63,000	83,331	-	480	146,811
Kontributet dhe shpërndarjet					
Dividendët ndaj pronarëve të kapitalit	-	(19,400)	-	-	(19,400)
Gjendja më 31 dhjetor 2019/01 janar 2020 - siç paraqitet	63,000	63,931	-	480	127,411
Efektet nga kalimi nga raportimi i BQK-së në raportimin e SNRF-së sipas kërkesave të BQK-së (shënimi 20)	-	(1,955)	1,955	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019/01 janar 2020 - e riparaqitur/rilëshuar	63,000	61,976	1,955	480	127,411
Fitimi i vitit	-	16,652	-	-	16,652
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	70	70
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	63,000	78,628	1,955	550	144,133
Kontributet dhe shpërndarjet					
Dividendët ndaj pronarëve të kapitalit	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	63,000	78,628	1,955	550	144,133

Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në kapitalin neto lexohet së bashku me shënimet që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të veçanta të paraqitura në faqet 48 deri 114.

Pasqyra e veçantë e rrjedhës së parasë

(shumat në € '000)	Shënimet	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019
Rrjedhat e parasë nga aktivitetet operative			
Interesi i pranuar në kredi		44,878	43,109
Interesi i paguar në plasmane		(26)	116
Interesi i pranuar në investimet në letra me vlerë		940	(833)
Dividendët e pranuar		-	804
Interesi i paguar në depozita dhe kredi të varura		(2,366)	(2,528)
Tarifat dhe komisionet e pranuar		17,153	18,174
Tarifat dhe komisionet e paguara		(7,726)	(7,875)
Të ardhura të tjera nga aktivitetet jobankare		2,797	2,315
Shpenzimet e personelit të paguara		(13,053)	(13,463)
Shpenzimet të tjera operative të paguara		(10,739)	(16,319)
Tatimi në të ardhura i paguar		(1,400)	(2,500)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrime operative		30,458	21,000
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
- Rezerva e detyrueshme e likuiditetit		(4,505)	(11,492)
- Detyrimet nga bankat		48	(11)
- Kreditë dhe paradhënie për klientët		(48,636)	(83,548)
- Pasuritë e tjera		(1,716)	1,386
- Detyrimet ndaj klientëve		58,606	129,230
- Depozitat nga bankat		18,570	2,432
- Detyrimet e tjera		208	1,198
Rrjedha neto e parasë nga/(të përdorura në) aktivitetet operative		53,033	60,195
Rrjedhat e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e pronës, pajisjeve dhe pasurive të paprekshme	14	(5,308)	(10,625)
Të ardhurat nga shitja e pronave dhe pajisjeve		73	49
Të ardhurat nga letrat me vlerë të investimeve		1,005	60,003
Investimi në letra me vlerë		(27,992)	(84,367)
Paraja neto e (të përdorur në)/nga aktivitetet investuese		(32,222)	(34,940)
Rrjedhat e parasë nga aktivitetet financuese			
Kthimi e huamarrjeve		-	-
Të ardhurat nga huamarrjet		709	5,046
Kthimi i detyrimeve me qira		(385)	-
Dividendët e paguar		-	(19,400)
Rrjedha neto e parasë (të përdorur në) aktivitetet financuese		324	(14,354)
Efekti i ndryshimit të normës së këmbimit valutor		2	(14)
Zvogëlimi neto i parasë dhe ekuivalenteve të saj		21,137	10,887
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit	8	75,532	64,644
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor 2020	8	96,669	75,531

Pasqyra e veçantë e rrjedhës së parasë lexohet së bashku me shënimet që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të veçanta të paraqitura në faqet 48 deri 114.

Shënimet për pasqyrat financiare e veçantë për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2020

1 Njësia raportuese

Raiffeisen SEE Region Holding GmbH është aksionari që ka në pronësi 100 për qind të Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C. Raiffeisen SEE Region Holding GmbH është 100 për qind në pronësi indirekte të Raiffeisen Bank International AG, banka amë.

Banka operon sipas licencës bankare të lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - ("BQK") më 8 nëntor 2001. Aktivitetet kryesore afariste të Bankës janë aktivitetet bankare komerciale dhe retail brenda Kosovës.

Më 31 dhjetor 2020, Banka ka 7 degë dhe 34 nëndegë brenda Kosovës (31 dhjetor 2019: 8 degë dhe 37 nëndegë). Zyra e regjistruar e Bankës është e vendosur në adresën në vijim: Rruga Robert Doll 99, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

2 Baza e përgatitjes

2.1 Baza kontabël

Pasqyrat financiare të veçanta janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") dhe interpretimet e saj të miratuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (BNSK). Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke përdorur supozimin e vijimësisë së biznesit.

Më shumë informacione në lidhje me rrethanat e shkaktuara nga pandemia globale e COVID-19 që ndikuan në operacionet dhe aktivitetet e Bankës në vitin 2020 shpalosen në Shënimin 2.2. Këto rrethana nuk ndikuan në përshtatshmërinë e supozimit të vijimësisë së biznesit të Bankës.

2.2 Ngjarje të rëndësishme në periudhën raportuese

Ndikimi nga pandemia e COVID-19

Mbyllja ekonomike e shkaktuar nga pandemia e COVID-19 në mars 2020, ka pasur pasojë të pashembullta ekonomike. Shumica e vendeve në Evropë dhe në SH.B.A., njëri pas tjetrit, vendosën kufizime për të penguar transmetimin e COVID-19. Në mënyrë që të lehtësohen pasojat ekonomike të shkaktuara nga kufizimet e tilla, ndërhyrjet e politikave u miratuan për të ndihmuar individët, familjet dhe bizneset. Masat e stabilizimit që prekin Bankën përfshijnë moratoriume pagese, programe direkte të ndihmës qeveritare dhe subvencione për të zbutur ndikimin ekonomik, si dhe kufizime në pagesat e dividendit. Masat e paraqitura nga shumë qeveri në mars të vitit 2020, në mënyrë që të kufizonin kontaktet, çuan në mbyllje të ekonomive kombëtare.

Rreth fillimit të qershorit të vitit 2020, Kosova filloi një rihapje graduale dhe të kontrolluar. Që nga fundi i verës, infektimet e reja ditore në shumë vende u rritën mbi nivelet e regjistruara në pranverë. Duke rivendosur masat për të kufizuar kontaktet, qeveritë po përpiqen të rikthejnë nën kontroll përhapjen e virusit. Sidoqoftë, politikanët kanë deklaruar qëllimin e tyre për të shmangur një mbyllje të dytë gjithëpërfshirëse të ekonomisë. Akoma priten efekte negative afatgjata në situatën ekonomike në sektorë të caktuar. Për shkak të recesionit të rëndë global, pritet rënie e konsiderueshme e fitimit për vitin aktual financiar. Si pasojë e drejt-përdrejtë në vitin 2020, humbjet e pritshme shtesë të zhvlerësimit prej rreth 3.5 milion Euro u raportuan përtej modelit ECL. Këto ishin rregullime pas modelit për vlerësimet e humbjeve të pritshme të kredisë. Rregullimet ishin të nevojshme pasi modelet nuk kapin plotësisht shpejtësinë e ndryshimeve dhe ashpërsinë e efekteve ekonomike të pandemisë. Sektorë individualë si Hotelet dhe Restorantet dhe biznese të tjera të vogla janë goditur më rëndë. Informacione të mëtejshme mbi zhvillimin në provizionimin neto për humbjet nga zhvlerësimi mund të gjenden në shënimet e pasqyrave financiare.

Përveç situatës, BQK-ja ka prezantuar udhëzuesin për një moratorium të pagesave të kredive. Huamarrësve u jepet një shtyrje e përkohshme e detyrimeve për të bërë shlyerjet e principalit, si dhe pagesat për interesat dhe tarifrat.

Duke marrë parasysh situatën e krijuar për shkak të infektimeve të shkaktuara nga COVID 19, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka marrë masa adekuatë në lidhje me funksionimin normal të sistemit financiar.

BQK, së bashku me Shoqatën e Bankave të Kosovës, kanë vendosur së bashku që për biznesin dhe individët të cilët për shkak të situatës në vend kanë pësuar rënie të nivelit të të ardhurave të tyre, të jenë në gjendje të pezullojnë pagesën e kësteve të kredisë, nga data 16 mars 2020 deri më 30 prill 2020, dhe varësisht nga situata, ky pezullim duhet të konsiderohet për më gjatë.

Gjatë kësaj krize, Raiffeisen Bank Kosova ka arritur të shqyrtojë seriozisht të gjitha kërkesat për moratorium, dhe që nga marsi i vitit 2020, në shumën totale prej 394,344 mijë Euro ose 56 për qind, (prill 2020 427,804 mijë Euro ose 61 për qind) e portofolit bruto u modifikua sipas Udhëzimeve të BQK-së

Vendimi i muajit mars ishte në fuqi deri në fund të qershorit të vitit 2020 dhe kjo u konsiderua faza e parë e modifikimeve të kredisë. Gjatë kësaj periudhe nuk u aplikua kamata ndëshkimore në lidhje me kreditë. Gjatë kësaj periudhe, nuk u aplikuan as masat e përkëqësimit të kredisë për huamarrësit. Gjatë qershorit të vitit 2020, BQK-ja ka aprovuar Udhëzuesin për ristrukturim e kredive gjatë periudhës me COVID 19. Një ristrukturim i tillë bëhet në përputhje me përkufizimet e mëposhtme:

- Përfshirja e ndryshimeve në periudhën e shlyerjes përmes pezullimit, vonesës ose zvogëlimit të principalit, interesit ose pagesave të plota, siç është rënë dakord ndërmjet institucionit huadhënës dhe huamarrësit duke marrë parasysh aftësinë e klientit për të kapërcyer vështirësitë e përkohshme financiare.
- Interesi i rregullt i llogaritur gjatë periudhës së pezullimit do të shpërndahet për një minimum prej 6 muajve të ardhshëm, ose deri në maturim, nëse periudha e maturimit të kredisë është më pak se 6 muaj.
- Ristrukturimi ose lehtësimi i pagesës së kësteve të kredisë (greis periudha, principali më i vogël, dhe të ngjashme) nuk mund të jepet për një periudhë më të gjatë se 12 muaj. Kreditë e ristrukturimit duhet të bëhen dhe të pranohen nga data e hyrjes në fuqi të udhëzuesit deri më 31 gusht 2020.
- Ristrukturimi i kredisë nuk do të thotë domosdoshmërisht se huamarrësi ka dështuar dhe transaksioni klasifikohet dhe konsiderohet joperformues. Institucionet huadhënëse duhet të numërojnë ditët e vonesës bazuar në planin e ri të pagesave që rezulton nga aplikimi i moratoriumit.

Më 31 dhjetor 2020, 331,807 mijë Euro e kredive të papaguara ishin subjekt i një moratoriumi. Një ndryshim në planet e pagesave mund të çojë në humbje të vlerës aktuale neto në një kontratë individuale të kredisë, që zakonisht njihet në rezultatit tjetër të Bankës si rregullim i njëhershëm i vlerës kontabël bruto që rezulton nga një modifikim jomaterial i kontratës. Kjo rënie e NPV e kredive të modifikuara për shkak të COVID 19 është kryesisht si rezultat i moratoriumit të pagesave deri në 9 muaj. Moratoriumi nënkupton që çdo pagesë e detyruar është shtyrë, duke rezultuar kështu në NPV më të ulët sesa kredia përpara zbatimit të moratoriumit nga banka. Në vitin 2020, 173 mijë Euro u pasqyruan në pasqyrën e të ardhurave si humbje për periudhën dhe bilancet në rënie të arkëtueshme në këtë drejtim. Në programet e drejtpërdrejta qeveritare për t'iu kundërvënë rënies ekonomike të shkaktuar nga pandemia COVID-19, Kosova miratoi masa të ndryshme mbështetëse për ekonominë dhe për të mbrojtur vendet e punës. Masat përfshijnë forma të ndryshme të mbështetjes financiare të drejtpërdrejta për individët, familjet dhe bizneset për të siguruar që kompanitë të kenë likuiditet të mjaftueshëm gjatë pandemisë së COVID-19.

2.3 Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara të miratuara nga Banka

Standardet dhe ndryshimet që janë efektive për herë të parë në vitin 2020 dhe janë të zbatueshme për Bankën janë:

- *Përkufizimi i një biznesi (Ndryshimet në SNRF 3)*

Në tetor të vitit 2018, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit lëshoi Përkufizimin e Biznesit (Ndryshimet në SNRF 3). Ndryshimet ngushtuan dhe sqaruan përkufizimin e biznesit. Ato gjithashtu lejojnë vlerësimin e thjeshtuar nëse një grup i fituar i aktiviteteve dhe pasurive është grup i pasurive e jo një biznes.

- *Përkufizimi i Materialit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8)* In October 2018, the IASB issued amendments to IAS 1 Në tetor të vitit 2018, IASB publikoi ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet" për të sqaruar përkufizimin e 'materialit' në kontekstin e zbatimit të SNRF-ve. Meqenëse koncepti i asaj se çfarë është dhe çfarë nuk është materiale është thelbësor në përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, një ndryshim në përkufizim mund të ndikojë thelbësisht se si personat që i përgatisin ato bëjnë gjykimet në përgatitjen e pasqyrave financiare.

- *Reforma e Standardit Krahasues të Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7)* The International Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") publikoi Ndryshimet në Reformën e Standardit Krahasues të Normës së Interesit në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7 që përfaqësojnë finalizimin e Fazës II të projektit më 27 gusht 2020 për të adresuar çështje që mund të ndikojnë në raportimin financiar kur një standard krahasues ekzistues i normës së interesit zëvendësohet me një normë alternative krahasuese interesi, d.m.th. çështje zëvendësimi. Çështjet kontabël që lindin përpara se një standard krahasues ekzistues i normës së interesit zëvendësohet me një normë alternative pa rrezik, d.m.th. çështjet para zëvendësimit, janë konsideruar më parë nga BSNK dhe janë adresuar në Reformën e Standardit Krahasues të Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7), publikuar në shtator të vitit 2019 ("Ndryshimet e Fazës I"). Këto ndryshime të Fazës I sigurojnë përjashtime të përkohshme nga kërkesat specifike të kontabilitetit mbrojtës, për të shmangur që njësitë ekonomike të ndërpresin marrëdhëniet mbrojtëse vetëm për shkak të pasigurisë që del nga reforma.

- *Ndryshimet në Referencat në Kornizën Konceptuale (Standarde të Ndryshme)*

BSNK vendosi të rishikojë Kornizën Konceptuale sepse disa çështje të rëndësishme nuk ishin mbuluar dhe disa udhëzime ishin të paqarta ose të vjetruara. Korniza Konceptuale e rishikuar, e lëshuar nga BSNK në mars të vitit 2018 përfshin:

- një kapitull i ri mbi matjen,
- udhëzime mbi raportimin e performancës financiare,
- përkufizime të përmirësuara të një pasurie dhe një detyrimi, dhe udhëzime që mbështesin këto përkufizime, dhe
- sqarime në fusha të rëndësishme, siç janë rolet e kujdestarisë, prudencës dhe pasigurisë në matje në raportimin financiar.

BSNK gjithashtu përditësoi referencat për Kornizën Konceptuale në Standardet e SNRF duke nxjerrë Ndryshime në Referencat e Kornizës Konceptuale në Standardet e SNRF. Kjo është bërë për të mbështetur kalimin në Kornizën Konceptuale të rishikuar për kompanitë që zhvillojnë politikat e kontabilitetit duke përdorur Kornizën Konceptuale kur asnjë Standard i SNRF nuk zbatohet për një transaksion të veçantë.

- *Koncesione të lidhura me qiranë si pasojë e COVID-19 (Ndryshime në SNRF 16)*

Ndryshimet prezantojnë një mjet praktik opsional që thjeshton sesi një qiramarrës kontabilizon koncesionet e qirasë që janë pasojë e drejtpërdrejtë e COVID-19. Një qiramarrës që zbaton mjetin praktik nuk është i detyruar të vlerësojë nëse koncesionet e pranueshme të qirasë janë modifikime të qirasë dhe i kontabilizon ato në përputhje me udhëzuesit e tjerë të zbatueshëm. Kontabiliteti që rezulton do të varet nga detajet e koncesionit të qirasë. Për shembull, nëse koncesioni është në formën e një uljeje të njëhershme të qirasë, ai do të kontabilizohet si një pagesë e ndryshueshme e qirasë dhe do të njihet në fitim ose humbje.

Këto ndryshime nuk kanë ndikim të rëndësishëm në Pasqyrat Financiare të Bankës dhe për këtë arsye nuk janë bërë shpallje shtesë.

2.4 Standardet dhe interpretimet e reja ende jo të miratuara nga Banka

Standardet dhe ndryshimet tjera që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar herët nga Banka përfshijnë:

- SNRF 17: Kontratat e Sigurimeve
- Ndryshimet në SNRF 17: Kontratat e Sigurimeve (Ndryshimet në SNRF 17 dhe SNRF 4)
- Referencat ndaj Kornizës Konceptuale
- Të ardhurat para përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontratat e ngarkuara – Kostoja e përbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimet vjetore të Ciklit të Standardeve të SNRF-së 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)
- Klasifikimi i detyrimeve si rrjedhëse ose jo-rrjedhëse (ndryshimet në SNK 1)

Këto ndryshime nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën e aplikimit fillestar dhe për këtë arsye nuk janë bërë shpallje.

2.5 Valuta funksionale dhe e prezantimit

Valuta funksionale e Bankës e përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta është Euro, pasi që është valuta e mjedisit ekonomik primar në të cilin punon Banka dhe pasqyron substancën ekonomike të ngjarjeve të lidhura ("valuta funksionale"). Të gjitha shumat janë rrumbullkuar në mijëshen më të afërt, përveç kur specifikohet ndryshe.

2.6 Përdorimi i gjykimeve dhe i vlerësimeve

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare të veçanta, menaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

3 Politikat e rëndësishme kontabël

Informacioni për fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare të veçanta janë përshkruar në shënime 3.4, 4 dhe 5. Politikat kontabël të mëposhtme janë zbatuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare të veçanta.

3.1 Filialet dhe konsolidimi

Filialet janë entitete të kontrolluara nga Banka. Kontrolli ekziston kur Banka është e ekspozuar, ose ka të drejta, ndaj kthimit variabil nga përfshirja e saj me të investuarin (filialin) dhe ka aftësinë të ndikojë në atë kthim përmes pushtetit të vet mbi të investuarin. Këto pasqyra financiare paraqesin rezultatin dhe pozitën financiare vetëm të Bankës dhe nuk përfshijnë ato të filialeve të saj, siç është dhënë në detaje në shënimin 13.

Banka përgatitë pasqyra financiare të veçanta dhe të konsoliduara në përputhje me SNRF. Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur për qëllime rregullatore lokale dhe nuk janë publikuar sepse Banka në vetvete është njësi vartëse në pronësi të plotë dhe kompania mëmë përfundimtare Raiffeisen Bank International përgatitë pasqyra financiare të konsoliduara, në dispozicion për përdorim publik në <http://www.rbinternational.com>, që janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Interesat në filiale janë llogaritur në bazë të koston në pasqyrat financiare të veçanta.

3.2 Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj regjistrohen me kursin në ditën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet monetare të shprehura në valutë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutor si rezultat i pagesës së transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi në kursin e këmbimit në fund të vitit të pasurive dhe detyrimeve monetare në valutë të huaj paraqiten në fitim dhe humbje.

3.3 Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare

3.3.1 Klasifikimi i pasurive financiare

Nga 1 janari 2018, Banka klasifikon të gjitha pasuritë e saj financiare bazuar në modelin e biznesit për menaxhimin e pasurive dhe kushteve kontraktuale të pasurisë, të matura në:

- koston e amortizuar,
- vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI), dhe
- vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL).

3.3.2 Klasifikimi i detyrimeve financiare

Sipas SNRF 9, të gjitha detyrimet financiare klasifikohen si më pas të matura me koston e amortizuar përveç për zërat e mëposhtëm që maten në FVTPL:

- Detyrimet financiare që mbahen për tregtim - duke përfshirë derivativët,
- Detyrimet financiare që lindin kur një transferim i një pasurie financiare nuk kualifikohet për çregjistrim ose kur zbatohet qasja e përfshirjes së vazhdueshme,
- Garancitë financiare dhe zotimet kreditore nën normat e interesit të tregut,
- Detyrimet kontingjente të njohura nga një blerës në një kombinim biznesi,
- Detyrimet financiare që janë përcaktuar si në FVTPL në njohjen fillestare.

Banka klasifikon detyrimet e saj financiare me koston e amortizuar dhe me vlerë të drejtë (të pagueshmet në norma e interesit të Swap).

3.3.3 Modeli i biznesit

Banka përcakton modelin e saj të biznesit në nivelin që reflekton më mirë se si menaxhon grupet e pasurive financiare për të arritur objektivin e saj të biznesit. Modeli i biznesit i Bankës nuk vlerësohet në bazën e secilit instrument veç e veç, por në një nivel më të lartë të portofoleve të agreguara dhe bazohet në faktorë të vëzhgueshëm si në vijim:

- Si vlerësohet dhe raportohet performanca e modelit të biznesit dhe pasurive financiare të mbajtura brenda atij modeli biznesi të personeli drejtues kryesor i njësisë ekonomike,
- Risqet që ndikojnë në ecurinë e modelit të biznesit (dhe pasuritë financiare të mbajtura brenda atij modeli biznesi) dhe, në veçanti, mënyrën se si menaxhohen ato risqe,
- Si kompensohen menaxherët e biznesit (për shembull, nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të pasurive të administruara ose në flukset monetare të arkëtuara),
- Frekuenca e pritshme, vlera dhe koha e shitjeve janë gjithashtu aspekte të rëndësishme të vlerësimit të Bankës.

Megjithatë, pritjet e Bankës janë se niveli më i lartë i imundshëm i agregimit është në nivel të Departamentit të Bankës. Duhet të përdoren nën-portofole të mëtejshëm në mënyrë që çdo portofol të jetë i njëjtë ose i ngjashëm me karakteristikat më poshtë:

- Fusha e biznesit,
- TKP-të e vlerësimit të performancës,
- Personeli kryesor i menaxhimit (B-1),
- Rreziqet dhe proceset e menaxhimit të rreziqeve,
- Infrastruktura e IT-së.

Vlerësimi i modelit të biznesit bazohet në skenarë të pritshëm, pa marrë në konsideratë skenarët e "rastit më të keq" ose "rastin e stresit". Nëse flukset monetare pas njohjes fillestare realizohen në një mënyrë të ndryshme nga pritjet origjinale të Bankës, Banka nuk ndryshon klasifikimin e pasurive të mbetura financiare të mbajtura në atë model biznesi, por përfshin informacion të tillë gjatë vlerësimit të pasurive financiare të sapo krijuara apo të sapo blera.

3.3.4 Karakteristika e flukseve monetare kontraktuale

Pasi Banka të përcaktojë se modeli i biznesit të një portofoli specifik është mbajtija e mjeteve financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale (ose duke mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe duke shitur pasuritë financiare), vlerëson nëse kushtet e kontratës së pasurisë financiare shkaktojnë në datat specifike flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit për shumën e principalit të papaguar. Për këtë qëllim, interesi përcaktohet si shpërblim për vlerën kohore të parasë dhe për riskun kreditor të ndërlidhur me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe për risqet e tjera bazë (p.sh. likuiditeti) dhe shpenzimet (p.sh. administrative), si dhe një marzhë fitimi. Në vlerësimin nëse flukset kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, banka do të marrë parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo do të përfshijë vlerësimin nëse pasuria financiare përmban një term kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale ashtu që të mos plotësojë këtë kusht. Banka konsideron:

- Parapagimet, kushtet e zgjatjes,
- Karakteristikat e leverazheve,
- Pretendimi kufizohet në pasuritë e specifikuara ose flukset monetare,
- Instrumentet e lidhura në mënyrë kontraktuale.

Ky vlerësim duhet të kryhet në secilin instrument në datën e njohjes fillestare të pasurive financiare.

3.3.5 Modifikimi i vlerës në kohë të parasë dhe testit Benchmark

Vlera në kohë e parasë është elementi i interesit që ofron konsideratë vetëm për kalimin e kohës. Nuk merr parasysh risqet e tjera (kredi, likuiditet etj.) ose kostot (administrative, etj.) të lidhura me mbajtjen e një pasurie financiare.

Në disa raste, vlera në kohë e elementit të parasë mund të modifikohet (e papërsosur). Ky do të ishte rasti, për shembull, nëse norma e interesit të një pasurie financiare rikthehet periodikisht, por frekuenca e atij adaptimi nuk përputhet me normën e interesit. Në këtë rast njësitë duhet të vlerësojnë modifikimin mbi atë nëse flukset monetare kontraktuale ende përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe të interesit, d.m.th. termi i modifikimit nuk ndryshon ndjeshëm flukset monetare nga një instrument referent 'i përsosur'. Ky vlerësim nuk është një zgjedhje e politikës kontabël dhe nuk mund të shmanget thjesht duke konkluduar që një instrument, në mungesë të një vlerësimi të tillë, do të matet me vlerën e drejtë. Për karakteristikat e mëposhtme kontraktuale kryesore që potencialisht mund të modifikojnë vlerën kohore të parasë, zbatohet një test benchmark:

- Shpejtësia e interesit të ri nuk përputhet me maturimin e interesit,
- Treguesin e trendit,
- Klauzolën zbutëse,
- Greis periudhën,
- Referenca e rendimentit të tregut dytësor.

Testi benchmark për çdo produkt të zbatueshëm në nivel bankar drejtohet nga zyra qendrore e RBI në Vjenë.

3.3.6 Njohja e pasurive dhe detyrimeve financiare

Banka fillimisht njeh kreditë, të arkëtueshmet dhe detyrimet e tjera financiare në datën në të cilën ato janë krijuar. Të gjitha instrumentet të tjera financiare (përfshirë blerjet e rregullta dhe shitjet e pasurive financiare) njihen në datën e tregtimit, që është data në të cilën Banka bëhet pjesë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Pasuria financiare ose detyrimi financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus, për zërin që nuk është me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostove të transaksionit që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen apo emetimin.

3.3.7 Çregjistrimi i pasurive dhe detyrimeve financiare

3.3.7.1 Çregjistrimi për shkak të modifikimit thelbësor të termave dhe kushteve

Banka çregjistron një pasuri financiare, të tillë si një hua për një klient, kur kushtet janë rinegociuar në atë masë që, në thelb, bëhet një hua të re, me diferencën e njohur si fitim ose humbje e çregjistrimit, në masën që një humbje nga zhvlerësimi nuk është regjistruar ende. Huatë e regjistruara rishitas klasifikohen si Faza 1 për qëllimet e matjes ECL, përveç nëse kredia e re konsiderohet të jetë POCL. Gjatë vlerësimit nëse do të çregjistrohet apo jo një kredi për një klient, ndër të tjera, Banka konsideron faktorët e mëposhtëm:

- Ndryshimi në valutën e kredisë,
- Prezantimi i një tipari të kapitalit neto,
- Ndryshimi në palën tjetër,

- Nëse modifikimi është i tillë që instrumenti të mos plotësojë më kriterin e SPPI.

Nëse modifikimi nuk rezulton në flukse monetare që janë në thelb të ndryshme, modifikimi nuk rezulton në çregjistrim. Bazuar në ndryshimet në flukset monetare të skontuara në EIR origjinale, Banka regjistron një fitim ose humbje modifikimi, në masën që një humbje nga zhvlerësimi nuk është regjistruar ende.

3.3.7.2 Çregjistrimi përveç modifikimit thelbësor

Pasuritë financiare

Një pasuri financiare (ose, kur është e mundur, një pjesë e një pasurie financiare ose një pjesë të një grupi të pasurie financiare të ngjashme) çregjistrohet kur të drejtat për të marrë flukse monetare nga pasuria financiare kanë skaduar. Banka gjithashtu çregjistron pasurinë financiare nëse ka transferuar pasurinë financiare dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim.

Banka ka transferuar pasurinë financiare nëse dhe vetëm nëse:

- Banka ka transferuar të drejtat e saj kontraktuale për të marrë flukse monetare nga pasuria financiare, ose
- Ajo ruan të drejtat e flukseve monetare, por ka marrë përsipër detyrimin për të paguar flukset e pranuar monetare në tërësi pa vonesë materiale për një palë të tretë nën një marrëveshje kalimtare.

Marrëveshjet kalimtare janë transaksione ku Banka ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare të një pasurie financiare ('pasuria origjinale'), por merr përsipër një detyrim kontraktual për të paguar këto flukse monetare për një ose më shumë subjekte ('përfituesit eventualë'), kur plotësohen të gjitha tri kushtet e mëposhtme:

- Banka nuk ka asnjë detyrim për të paguar shumat për përfituesit eventualë, nëse nuk ka mbledhur shuma ekuivalente nga pasuria origjinale, duke përjashtuar paradhëniet afatshkurtra me të drejtën e rimbursimit të plotë të shumës së huasë plus interesin e përlogaritur me normat e tregut,
- Banka nuk mund të shesë ose të zotojë pasurinë origjinale përveçse si siguri për përfituesit eventualë,
- Banka duhet të dorëzojë çdo mjet monetar që mbledh në emër të përfituesve eventual pa vonesë thelbësore.

Përveç kësaj, Banka nuk ka të drejtë të riinvestojë flukse të tilla monetare, me përjashtim të investimeve në para dhe ekuivalentët e parasë duke përfshirë interesin e fituar, gjatë periudhës midis datës së arkëtimit dhe datës së dërgesës së kërkuar për përfituesit eventualë. Një transferim kualifikohet për çregjistrim vetëm nëse:

- Banka ka transferuar kryesisht të gjithë riskun dhe përfitimet e pasurisë, ose
- Banka nuk ka transferuar ose ruajtur në mënyrë të konsiderueshme të gjitha risqet dhe përfitimet e pasurisë, por ka transferuar kontrollin e pasurisë.

Banka e konsideron kontrollin të transferuar nëse dhe vetëm nëse transferuesi ka aftësinë praktike për të shitur pasurinë në tërësinë e saj për një palë të tretë të palidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë atë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa vendosur kufizime shtesë për transferimin.

Kur Banka nuk ka transferuar ose ruajtur në mënyrë të konsiderueshme të gjitha risqet dhe përfitimet dhe ka ruajtur kontrollin e pasurisë, pasuria vazhdon të njihet vetëm në masën e përfshirjes së vazhdueshme të Bankës, në të cilin rast, Banka njihet edhe një detyrim shoqëruar. Pasuritë e transferuara dhe detyrimi shoqëruar maten në një bazë që pasqyron të drejtat dhe detyrimet që Banka ka ruajtur.

Nëse përfshirja e vazhdueshme merr formën e një opsioni të shkruar ose të blerë (ose të dyja) në pasurinë e transferuar, përfshirja e vazhdueshme matet në vlerën që Banka do të kërkohej të paguajë pas riberjes. Në rastin e një opsioni të vënë me shkrim mbi një pasuri që matet me vlerën e drejtë, shkalla e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë ekonomike kufizohet në vlerën më të ulët të vlerës së drejtë të pasurisë të transferuar dhe çmimit të ushtrimit të opsionit.

Detyrimet financiare

Detyrimi financiar çregjistrohet kur obligimi nga detyrimi zbatohet, anulohet ose skadon. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet nga një tjetër nga i njëjti huadhënës në kushte thelbësisht të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues ndryshohen në mënyrë substanciale, një shkëmbim ose modifikim i tillë trajtohet si një mosnjohje e detyrimit fillestar dhe njohje e një detyrimi të ri. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar fillestar dhe vlerës së paguar njihet në fitim ose humbje.

3.3.8 Netimi

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare netohen reciprokisht dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur, Banka ka të drejtë ligjore për të kompensuar shumat dhe synon ose t'i shlyejë ato në bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe ta shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF.

3.3.9 Matja e kostos së amortizuar

'Kostoja e amortizuar' e një pasurie financiare ose detyrimi financiar është shuma me të cilën pasuria financiare ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare minus shlyerjet e kryegjësë, plus ose minus amortizimi i akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus zbritjet eventuale për shkak të rënies në vlerë.

3.3.10 Matja e vlerës së drejtë

'Vlera e drejtë' është çmimi që do të merrej nëse shitet një pasuri ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në tregun kryesor ose, në mungesë të tij, tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e detyrimit pasqyron riskun e mos performancës së tij.

Qëllimi i përdorimit të një teknike vlerësimi është të përcaktojë se cili do të ishte çmimi i transaksionit (p.sh. një çmim dalës) në datën e matjes në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut. Vlera e drejtë vlerësohet në bazë të rezultateve të një teknike vlerësimi që bën përdorimin maksimal të inputeve të tregut dhe mbështetet sa më pak të jetë e mundur në inputet specifike të entitetit. Një teknikë vlerësimi pritet të arrijë një vlerësim real të vlerës së drejtë nëse:

- reflekton në mënyrë të arsyeshme se si mund të pritet çmimi i tregut për vlerën e instrumentit, dhe
- inputet në teknikën e vlerësimit në mënyrë të arsyeshme paraqesin pritjet e tregut dhe masat e faktorëve të riskut-kthimit të qenësishme në instrumentin financiar.

Prandaj, një teknikë vlerësimi

- përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do ta konsideronin në vendosjen e një çmimi, dhe
- është në përputhje me metodologjitë e pranuar ekonomike për çmimet e instrumenteve financiare.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është çmimi i transaksionit (d.m.th. vlera e drejtë e shumë të dhënës ose të marrë). Metodologjitë e tjera përfshijnë krahasimin e vlerës së drejtë të atij instrumenti në krahasim me transaksionet e tjera të tregut të tanishëm të vëzhguar në instrumentin e njëjtë / të ngjashëm (d.m.th. pa modifikim ose ripaketim) ose bazuar në një teknikë vlerësimi ndryshore të cilave përfshijnë të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme.

Qasja e rrjedhës monetare të skontuar është një teknikë e përdorur për të lidhur shumat e ardhshme (rrjedhat e mjeteve monetare) me të tashmen nëpërmjet një norme skontimit.

Konceptet e vlerës aktuale janë të rëndësishme kyçe për zhvillimin e teknikave për vlerësimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare, sepse çmimi i daljes nga tregu i një instrumenti financiar përfaqëson vlerësimin kolektiv të pjesëmarrësit të tregut të vlerës aktuale të rrjedhave të pritura të parave. Prandaj, rrjedha parave dhe norma e skontimit duhet të pasqyrojnë vetëm faktorët që janë specifikë për instrumentin financiar që matet dhe duhet të reflektojnë supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdorin në vlerësimet e tyre të vlerës së drejtë. Gjithashtu, duke qenë se rrjedhat e parave të përdorura janë më shumë vlerësime sesa shuma të njohura, një vlerësim me vlerën e drejtë, duke përdorur vlerën aktuale, bëhet në kushtet e pasigurisë. Ndërsa pjesëmarrësit e tregut në përgjithësi kërkojnë kompensim për mbajtjen e pasigurisë së qenësishme në rrjedhën e parasë (primit të rrezikut), efekti i ndryshueshmërisë (rrezikut) në rrjedhën e parave duhet të pasqyrohet ose në rrjedhën e parasë ose në normën e skontimit.

Në zbatimin e analizës së rrjedhës së parave të skontuara ("DCF"), Banka duhet të përdorë norma skontim të barabarta me normat mbizotëruese të kthimit për instrumentet financiare që kanë në thelb të njëjtat kushte dhe karakteristika, duke përfshirë cilësinë e kreditorit të instrumentit, afati i mbetur gjatë së cilit norma e interesit kontraktuale është fikse, afati i mbetur për ripagesën e principalit dhe valuta në të cilën duhet të bëhen pagesat. Rrjedhat e parasë të përdorura në modelin DCF duhet të "përshtaten" me normën e skontimit dhe gjithashtu duhet të marrin në konsideratë karakteristikat e përmendura më lart (p.sh. periudha e mbetur e normës së interesit kontraktuale dhe e principalit).

Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Tregu konsiderohet si aktiv nëse transaksionet për pasurinë ose detyrimin zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të njafueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në baza të vazhdueshme. Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknikën e vlerësimit që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve që nuk vëzhgohen. Teknika e përzgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në çmimet e një transaksioni.

Vlera e drejtë e depozitës sipas kërkesës nuk është më pak se shuma e pagueshme sipas kërkesës, e skontuar nga data e parë në të cilën shuma mund të kërkohet për t'u paguar. Banka njeh transferet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

3.3.11 Garancitë financiare, letër kreditë dhe zotimet e patërhequra të huasë

Banka lëshon garanci financiare, letra kredie dhe kredi. Garancitë financiare fillimisht njihen në pasqyrat financiare me vlerë të drejtë, duke qenë primi i marrë. Pas njohjes fillestare, detyrimi i Bankës sipas secilës garanci matet me shumën më të madhe

të shumës së njohur fillimisht minus amortizimi kumulativ i njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe sipas SNRF 9 - një provizion i ECL. Primi i pranuar njihet në pasqyrën e të ardhurave në shpenzimet neto dhe të ardhurat nga komisionet në bazë të drejtpërdrejtë gjatë jetës së garancisë. Zotimet e patërhequra të huasë dhe letër kreditë janë zotime nën të cilat, gjatë kohëzgjatjes së zotimit, Bankës i kërkohet të ofrojë një hua me terma të paracaktuar për klientin. Ngjashëm me kontratat e garancisë financiare këto kontrata janë në kuadër të kërkesave të ECL.

Vlera nominale kontraktuale e garancive financiare, letër kredive dhe zotimeve të patërhequra të huasë, ku huatë e dakorduara për t'u ofruar janë në terma të tregut, nuk regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar. Vlerat nominale të këtyre instrumenteve janë të paraqitura në Shënimin 26 dhe ECL-të përkatëse janë dhënë në Shënimin 6.

3.3.12 Pasuritë financiare të rëna në vlerë

Miratimi i SNRF 9 ka ndryshuar rrënjësisht metodën e zhvlerësimit të humbjes kreditore të Bankës duke zëvendësuar metodën e humbjeve të ndodhura me SNK 39 me një qasje ECL afatgjatë. Nga 1 janari 2018, Banka ka regjistruar zbritjen për humbjet e pritshme kreditore për të gjitha huatë dhe pasuritë e tjera financiare të borxhit që nuk mbahen në FVPL, së bashku me zotimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare. Instrumentet e kapitalit neto nuk janë subjekt i zhvlerësimit sipas SNRF 9. SNRF 9 përdor një model të humbjeve të pritshme kreditore për të njohur zhvlerësimin në kundërshtim me SNK 39 i cili përdor një model humbjeje të shkaktuar. Modeli i humbjeve të pritshme kreditore zbatohet për instrumentet e borxhit me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse, të arkëtueshmeve të qirasë, asteve të kontratës dhe zotimeve të huasë dhe kontratave të garancisë financiare që nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Banka ka krijuar një politikë për të kryer një vlerësim, në fund të çdo periudhe raportuese, nëse risku kreditor i një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, duke marrë parasysh ndryshimin në riskun e mospagesës që ndodh gjatë jetës së mbetur të instrumentit financiar.

Bazuar në procesin e mësipërm, Banka grupon kreditë e saj në Faza 1, Faza 2, Faza 3 dhe POCL, siç përshkruhet më poshtë:

- Faza 1: Kur kreditë njihen për herë të parë, banka njeh një lejim në bazë të 12mECL. Kreditë e Fazës 1 gjithashtu përfshijnë instrumente ku risku kreditor është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Faza 2.
- Faza 2: Kur një hua ka shfaqur një rritje të konsiderueshme në riskun kreditor që nga krijimi, banka regjistron një lejim për jetëgjatësinë e humbjeve të pritshme kreditore - LTECL. Kreditë e Fazës 2 gjithashtu përfshijnë instrumente, ku risku kreditor është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Faza 3.
- Faza 3: Kreditë që konsiderohen të kreditit të zhvlerësuar (siç janë shënuar në Shënimin 4). Banka regjistron një lejim për LTECL-të.
- POCL: Asetet e blera ose të origjinuara të kreditit të zhvlerësuar (POCL) janë asete financiare që kanë pësuar zhvlerësim kreditor në njohjen fillestare. Pasuritë e POCL regjistrohen me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe të ardhurat nga interesi njihen më pas në bazë të një EIR të rregulluar nga kredia. ECL-të njihen ose njihen vetëm në masën që ka një ndryshim pasues në humbjet e pritura kreditore. Për pasuritë financiare për të cilat Banka nuk ka shpresa të arsyeshme për mbulimin e të gjithë shumës së papaguar, ose një pjesë të saj, vlera kontabël bruto e pasurisë financiare zvogëlohet. Kjo konsiderohet një çregjistrim (i pjesshëm) i pasurisë financiare.

Ekzistojnë tri qasje kryesore të cilat mund të përdoren për të llogaritur humbjet e pritura të kredive: qasja e përgjithshme, qasja e thjeshtuar dhe pasuritë financiare të blera ose të origjinuara të kreditit të zhvlerësuar (POCL).

Qasja e përgjithshme

Duke përdorur metodën e përgjithshme, shumat e humbjeve të pritshme të kreditorëve të njohura si një lejim (rezervë) për humbje ose provizion varet nga vlerësimi i shkallës së përkeqësimit të kredisë që nga njohja fillestare.

Qasja e përgjithshme aplikohet për vlerësimin ECL për huatë dhe paradhëniet për klientët, detyrimet nga bankat dhe investimet financiare, që kërkon përdorimin e modeleve komplekse dhe supozime të konsiderueshme për kushtet e ardhshme ekonomike dhe sjelljen e pagesave.

Nevojiten gjykime të konsiderueshme në zbatimin e kërkesave kontabël për matjen e humbjeve të pritura kreditore, ndër të tjera:

- Përcaktimi i kriterëve për rritje të ndjeshme të riskut kreditor,
- Zgjedhja e modeleve dhe supozimeve të përshatshme për matjen e humbjeve të pritshme kreditore,
- Humbjet e pritshme kreditore duhet të njihen bazuar në rritje të konsiderueshme të gjasave ose rrezikut të një mospagimi që nga njohja fillestare, pavarësisht nëse një instrument financiar është rivlerësuar për ta pasqyruar një rritje të rrezikut kreditor. Vendosja e numrit dhe ponderimit relativ të skenarëve parashikues për secilin lloj të produktit/tregut dhe humbjeve të pritura kreditore,
- Krijimi i grupeve të aseteve të ngjashme financiare për qëllimet e matjes së humbjeve të pritshme kreditore.

Përkufizimi i mospagimit

Banka e konsideron një instrument financiar të papaguar, rrjedhimisht Faza 3, kur një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme sasiore, cilësore ose të rezervës (backstop) janë plotësuar:

Kriteret sasiore

Huamarrësi është me vonesë për më shumë se 90 ditë për një detyrim material të kredisë. Zbatimi i kërkesave për pragun e materialitetit të detyrimit të kredisë Retail të vonuar.

Sipas kësaj politike në fuqi, pragu i materialitetit përbëhet nga një komponent absolut dhe relativ:

- Komponenti i pragut absolut është i barabartë me 100 €
- Komponenti i pragut relativ është i barabartë me 1 për qind të shumës totale të ekspozimit në bilancin e gjendjes. Numëruesi i llogaritjes së pragut relativ duhet të përfshijë të gjithë shumën e vonuar që ekziston për një instrument/huamarrës (llogaritjet në bazë të nivelit të përdorur të aplikimit të vonuar). Emëruesi i llogaritjes së pragut relativ duhet të përfshijë ekspozimin në bilancin e huamarrësit, duke përfshirë të gjitha shumat e vonuara të konsideruara në numërues.

Në Ekspozimin PI, pragu i vonuar i materialitetit llogaritet në nivel të instrumentit (në lidhje me secilën kredi/limit individual). Në rastin e Mikro-NVM-ve, materialiteti i çfarëdo pagese të vonuar gjithmonë vlerësohet në nivel të huamarrësit, pra në lidhje me të gjitha detyrimet ekzistuese të një huamarrësi.

Në Portofolin Joretail, komponenti i pragut absolut është i barabartë me 500 euro dhe komponenti i pragut relativ është ulur nga 2.5 për qind në 1.0 për qind të shumës totale të ekspozimit në bilancin e gjendjes. Asnjë përpjekje nuk është bërë për ta hedhur poshtë supozimin se asetet financiare që janë me vonesë më shumë se 90 ditë duhet të paraqiten në Fazën 3.

Kriteret cilësore

Huamarrësi plotëson kriteret e pamundësisë për të paguar, të cilat tregojnë se huamarrësi është në vështirësi domethënëse financiare dhe nuk ka gjasa të shlyejë ndonjë detyrim kredie në tërësi. Treguesit e pamundësisë për të paguar përfshijnë kur:

- Detyrimi kreditor vihet në status joakruar për shkak të përkeqësimit të cilësisë së kredisë,
- Rregullimet Specifike të Kredive (SCRA) për shkak të një rënie në cilësinë e kredisë së një huamarrësi,
- Detyrimi kreditor shitet me humbje materiale ekonomike,
- Detyrimi kreditor i nënshtrohet një ristrukturimi të vështirë,
- Huamarrësi ka falimentuar/është i paaftë të paguajë,
- Huamarrësi ka kryer mashtrim kredie,
- Huamarrësi është i vdekur,
- Një kontratë kredie ishte ndërprerë në mënyrë të parakohshme për shkak të mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale nga huamarrësi,
- Burimi/burimet e të ardhurave periodike të klientit nuk janë më të disponueshme për të përmbushur pagesën e kësteve,
- Situata financiare e klientit e disiplinës së pagesës është përkeqësuar,
- Shkelja e Marrëveshjeve Kontraktuale,
- Përvetësimi i kolateralit ose thirrja e garancisë,
- Blerja e origjinës në zbritje materiale (POCI).

Kriteret e mësipërme janë zbatuar për të gjitha instrumentet financiare të mbajtura nga banka dhe janë në përputhje me përkufizimin e mospagimit të përdorur për qëllime të brendshme të menaxhimit të rrezikut kreditor. Përkufizimi i mospagimit është zbatuar vazhdimisht për ta modeluar Probabilitetin e Mospagimit (PD), Ekspozimin në Mospagim (EAD) dhe Humbjen nga Mospagimi (LGD) përgjatë llogaritjeve të humbjeve të pritshme të bankës. Një detyrim kredie konsiderohet të mos jetë më i papaguar pas një periudhe provuese prej minimum tre muajsh (gjyashitë muaj pas një ristrukturimi të vështirë në retail), ku gjatë periudhës provuese, klienti demonstroi disiplinë të mirë paguese dhe asnjë tregues tjetër i pamundësisë për të paguar nuk ishte vërejtur.

Rritja e ndjeshme e rrezikut kreditor

Një numër faktorësh janë të rëndësishëm kur vlerësohet rritja e ndjeshme e rrezikut kreditor. Lista e shkaktarëve të SICR përmban kryesisht informata që janë në pjesën e modelit të brendshëm të vlerësimit të Bankës, pra përdoren si input për

caktimin e vlerësimit të kredisë. Duke pasur informatat tashmë të përfshira në vlerësimin e brendshëm, metoda sasiore është e mjaftueshme për vlerësimin e saktë të rritjes së ndjeshme të rrezikut kreditor.

Kriteri sasior i ndarjes në faza zbatohet individualisht për çdo instrument. Asnjë grupim i ekspozimit nuk kryhet, që do të thotë se matja e një rritje të ndjeshme të rrezikut kreditor nuk kryhet në baza kolektive. Për këtë qëllim, nëse huamarrësi është më shumë se 30 ditë vonesë për një detyrim material kreditor.

Kriteret cilësore

Kriteret cilësore të përdorura nga Banka në lidhje me SICR përfshijnë:

- Ndryshimet në qasjen e menaxhimit të kredisë të njësisë ekonomike në lidhje me instrumentin financiar,
- Ndryshimet e pritshme në dokumentacionin e kredisë (pra Ndryshimet në kushtet e kontratës),
- Ndryshime domethënëse në treguesit e jashtëm të tregut të rrezikut kreditor për një instrument të veçantë financiar ose instrumente të ngjashme financiare me të njëjtën jetëgjatësi të pritshme.

Vlerësimi i brendshëm

Banka përfshin gjithashtu vlerësimin e brendshëm për ta përcaktuar SICR:

- Ndryshime domethënëse në treguesit e brendshëm të çmimeve të rrezikut kreditor si rezultat i një ndryshimi në rrezikun kreditor që nga fillimi,
- Një ndryshim domethënës aktual ose i pritshëm në vlerësimin e jashtëm kreditor të instrumentit financiar,
- Një ulje aktuale ose e pritshme e vlerësimit të brendshëm kreditor për huamarrësin,
- Ndryshimet ekzistuese ose të parashikuara negative në kushtet e biznesit, financiare ose ekonomike,
- Një ndryshim domethënës aktual ose i pritshëm në rezultatet operative të huamarrësit,
- Rritje të ndjeshme të rrezikut kreditor në instrumente tjera financiare të të njëjtit huamarrës,
- Një ndryshim domethënës negativ aktual ose i pritshëm në mjedisin rregullator, ekonomik ose teknologjik të huamarrësit,
- Ndryshime domethënëse në vlerën e kolateralit që mbështet detyrimin,
- Një ndryshim domethënës në cilësinë e garancisë së siguruar nga një aksionar,
- Ndryshime domethënëse, të tilla si zvogëlimi, në mbështetjen financiare nga një njësi ekonomike amë ose një filial tjetër ose një ndryshim domethënës aktual ose i pritshëm në cilësinë e përmirësimit kreditor,
- Ndryshime domethënëse në performancën dhe sjelljen e pritshme të huamarrësit,
- Ndryshime të tjera në normat ose kushtet e një instrumenti financiar ekzistues që do të ishin shumë ndryshe nëse instrumenti ishte krijuar rishtas ose lëshuar në datën e raportimit.

Shpjegimi i inpueteve, supozimeve dhe teknikave të vlerësimit

Humbja e pritshme kreditore matet në bazë të një periudhe 12-mujore ose të jetëgjatësisë në varësi të faktit nëse ka ndodhur një rritje të ndjeshme të rrezikut kreditor që nga njohja fillestare ose nëse një aset konsiderohet të jetë i kreditit të zhvlerësuar. Informatat ekonomike parashikuese përfshihen gjithashtu në përcaktimin e PD-së 12-mujore dhe të jetëgjatësisë, EAD dhe LGD. Këto supozime ndryshojnë sipas llojit të produktit.

Humbjet e pritshme kreditore janë produkti i zbritur i probabilitetit të mospagimit (PD), humbjes nga mospagimi (LGD), ekspozimit në mospagim (EAD) dhe faktorit të zbritjes (D).

Probabiliteti i vonesës (PD)

Probabiliteti i mospagimit paraqet gjasat që një huamarrës të mos paguajë detyrimet e tij financiare gjatë 12 muajve të ardhshëm ose gjatë jetëgjatësisë së mbetur të detyrimit. Në përgjithësi, probabiliteti i jetëgjatësisë i mospagimit logaritet duke përdorur probabilitetin rregullator 12 mujor të mospagimit, me çdo marzhë të konservatorizmit të eliminuar, si pikënisje. Pas kësaj, metoda të ndryshme statistikore përdoren për të gjeneruar një vlerësim sesi do të zhvillohet profili i mospagimit nga pika e njohjes fillestare gjatë gjithë jetëgjatësisë së kredisë ose portofolit të kredive. Profili është i bazuar në të dhënat historike të vëzhguara dhe funksionet parametrike.

Modele të ndryshme janë përdorur për të vlerësuar profilin e mospagimit të shumave të kredive të papaguara dhe këto mund të grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- Sovranëve, qeverive lokale dhe rajonale, kompanive të sigurimeve dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive: profili i mospagimit iu gjenerohet duke përdorur një qasje të matricës së tranzicionit. Informatat parashikuese përfshihen në probabilitetin e mospagimit duke përdorur një faktor të modelit Vasicek.

- Klientëve të korporatave, financimit të projekteve dhe institucioneve financiare, profili i mospagimit iu gjenerohet duke përdorur një qasje të regresit parametrik të mbijetesës (Ēeibull). Informatat për të ardhmen përfshihen në probabilitetin e mospagimit duke përdorur një faktor të modelit Vasicek. Kalibrimi i normës së mospagimit bazohet në metodologjinë e Kaplan Maier me rregullimin e tërheqjes.
- Kredive hipotekare retail dhe huadhëniet e tjera retail, profili i mospagimit iu gjenerohet duke përdorur regresin parametrik të mbijetesës në kornizat konkurruese të rrezikut. Informatat për të ardhmen përfshihen në probabilitetin e mospagimit duke përdorur modele satelitore.

Në rrethana të kufizuara, kur disa inpute nuk janë plotësisht të disponueshme, përdoret grupimi, mesatarizimi dhe krahasimi i inputeve për llogaritje.

Humbja nga mospagimi (LGD)

Humbja nga mospagimi paraqet pritshmërinë e bankës për shkallën e humbjes në një ekspozim të papaguar. Humbja nga mospagimi ndryshon sipas llojit të palës tjetër dhe produktit. Shkallët e humbjes nga mospagimi vlerësohen për secilin klasë të aseteve si më poshtë:

- Sovranët: Humbja nga mospagimi gjendet duke përdorur burime të nënkuptuara në treg,
- Klientët e korporatave, financimi i projekteve, institucionet financiare, qeveritë lokale dhe rajonale, kompanitë e sigurimeve: Humbja nga mospagimi gjenerohet nga zbritja e flukseve të parave të gatshme të mbledhura gjatë procesit të ristrukturimit. Informatat parashikuese përfshihen në humbjen nga mospagimi duke përdorur modelin Vasicek,
- Kreditë hipotekare retail dhe huadhëniet e tjera retail: Humbja nga mospagimi gjenerohet duke eliminuar rregullimet e rënies dhe marzhave tjera të konservatorizmit nga humbja rregullatore nga mospagimi. Informatat për të ardhmen përfshihen në humbjen nga mospagimi duke përdorur modele të ndryshme satelitore.

Në rrethana të kufizuara, kur disa inpute nuk janë plotësisht në dispozicion, përdoren modele alternative të rikuperimit, krahasimi i inputeve dhe gjykimi i ekspertëve, për llogaritjen.

Ekspozimi në mospagim (EAD)

Ekspozimi në mospagim bazohet në shumat që banka pret që të jenë borxh në kohën e mospagimit, gjatë dymbëdhjetë muajve të ardhshëm ose gjatë jetëgjatësisë së mbetur. EAD-të 12 mujore dhe të jetëgjatësisë përcaktohen bazuar në profilin e pritshëm të pagesës, i cili ndryshon sipas llojit të produktit. Për produktet e amortizimit dhe shlyerjen e kredive "bullet", kjo bazohet në ripagimet kontraktuale që janë detyrim i huamarrësit gjatë një periudhe 12 mujore ose tërë jetëgjatësisë. Kur është e nevojshme, supozimet e parakohshme të ripagimit/rifinancimit konsiderohen gjithashtu në llogaritje. Për produktet revolvuere, ekspozimi në mospagim parashikohet duke marrë bilancin aktual të tërhequr dhe duke shtuar një faktor konvertimi kreditor që lejon tërheqjen e pritshme të limitit të mbetur nga koha e mospagimit. Margjinat rregullatore prudenciale hiqen nga faktori i konvertimit të kredisë. Në rrethana të kufizuara, kur disa inpute nuk janë plotësisht të disponueshme, krahasimi i inputeve përdoret për llogaritje.

Faktori i zbritjes

Në përgjithësi, për ekspozimin në bilancin e gjendjes i cili nuk është me lizing ose POCI, norma e zbritjes e përdorur në llogaritjen e humbjes së pritshme kreditore është norma efektive e interesit ose një përafrim i saj.

Llogaritja

Humbja e pritshme kreditore është produkt i PD, LGD dhe EAD herë probabiliteti për të mos paguar para periudhës së konsideruar kohore. Kjo e fundit shprehet nga funksioni i mbijetesës S. Kjo në mënyrë efektive llogarit vlerat e ardhshme të humbjeve të pritshme kreditore, të cilat më pas zbriten në datën e raportimit dhe mbledhen. Vlerat e llogaritura të humbjeve të pritshme kreditore peshohen më pas sipas skenarit për të ardhmen.

Modele të ndryshme janë përdorur për t'i vlerësuar provizionet e shumave të papaguara të huadhënies dhe këto mund të grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- Sovranët, klientët e korporatave, financimi i projekteve, institucionet financiare, qeveritë lokale dhe rajonale, kompanitë e sigurimeve dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive: provizionet e Fazës 3 llogariten nga menaxherët e ristrukturimit të cilët zbresin flukset e pritshme të parave për normën e përshtatshme efektive të interesit,
- Kreditë hipotekare retail: provizioni i Fazës 3 gjenerohet duke llogaritur vlerësimin më të mirë të nxjerrë statistiki-sht të humbjes së pritshme, e cila është rregulluar për kostot indirekte, si dhe duke llogaritur vlerën e realizimit të kolateralit të zbritur,
- Huadhëniet e tjera retail: provizioni i Fazës 3 gjenerohet duke llogaritur vlerësimin më të mirë të nxjerrë statistiki-sht të humbjes së pritshme, e cila është rregulluar për kostot indirekte.

Karakteristikat e përbashkëta të rrezikut kreditor

Pothuajse të gjitha humbjet e pritshme kreditore sipas SNRF 9 maten kolektivisht. Vetëm për Fazën 3 për Joretail, shumica e ECL vlerësohen individualisht. Për provizionet e humbjeve të pritshme kreditore, të modeluara në bazë kolektive,

grupimi i ekspozimeve kryhet mbi bazën e karakteristikave të përbashkëta të rrezikut kreditor, në mënyrë që ekspozimet brenda secilit grup të jenë të ngjashme. Karakteristikat e ekspozimit retail grupohen në klasifikimin kontabël (ekonomitë familjare dhe NVM-të), nivelin e produktit (p.sh. hipotekat, kreditë personale, instrumentet e mbitërheqjes ose kredit kartelat), shkallët e vlerësimit të PD dhe grupet e LGD/kredia ndaj vlerës. Për secilin kombinim të karakteristikave të mësipërme u zhvillua një model individual.

Humbja e pritshme kreditore – Portofoli i korporata

Ekspozimi në mospagim (EAD)

Ekspozimi total përkufizohet si ekspozim i papaguar, përfshirë interesin e përlogaritur dhe tarifat e përlogaritura sipas përkufizimit të SNRF-ve. Për letrat me vlerë në librin bankar, është vlera kontabël. Për zërat jashtë bilancit (garancitë e lëshuara, letrat e kredive, instrumentet e papaguara) ekspozimi total është ekspozimi para aplikimit të faktorëve të konvertimit të kredisë. Për instrumentet, ekspozimi total përfshin vetëm instrumentet e zotuara (menjëherë të anulueshme ose të anulueshme me periudhën e njoftimit). Instrumentet e pazotuara, në kuptimin e instrumenteve shtesë të aprovuara nga brenda, nuk janë të përfshira. Instrumentet financiare jashtë bilancit hyjnë gjithashtu në fushëveprimin e llogaritjes së zhvlerësimit. Për të pasqyruar rrezikun e mundshëm që vjen nga tërheqja e ekspozimit jashtë bilancit, banka përdor modele që parashikojnë gjasat e tërheqjes së një pozicioni të veçantë jashtë bilancit dhe që e konvertojnë atë në një instrument financiar jashtë bilancit.

Kolaterali

Kolaterali luan një rol të kufizuar në vlerësimin nëse ka pasur rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor. Metodrat e ndarjes në faza (kategori) bazohen në parametrat e rrezikut kreditor pa marrë parasysh kolateralin. Në kontrast me ndarjen në faza, kolaterali ndikon në matjen e humbjeve të pritshme kreditore. Nëse një kredi garantohej nga një palë e tretë, ajo do të marrë një zhvlerësim që rezulton nga rreziku i kombinuar kreditor të klientit origjinal dhe garantuesit, nëse zbatohet edhe në llogaritjen e aseteve të ponderuara ndaj rrezikut - (RĒA). Humbja e pritshme kreditore do të matet bazuar në PD të garantuesit dhe jo të klientit origjinal. Nëse kolaterali tejkalon shumën e ekspozimit, humbja e pritshme në atë instrument financiar do të jetë zero. Kolateralat në modelin e zhvlerësimit shprehen sa i përket vlerës së ponderuar të kolateralit (ĒCV), që është vlera e kolateralit sipas vlerësimit të brendshëm të kolateralit.

Ekspozimi i pasiguar

Nëse pritet nga të ardhurat e kolateralit (pra nëse supozojmë vlerësimin e duhur të brendshëm të kolateralit), zhvlerësimi zbatohet vetëm për pjesën e pasiguar të instrumentit financiar. Për secilin aset në portofolin përkatës të zhvlerësimit, kryhet llogaritja e tillë e ekspozimit të pasiguar. Ajo që i duhet modelit të llogaritjes së zhvlerësimit është, përfundimisht, një profil i ekspozimit në rënie të pjesës së pasiguar. Meqenëse shumata e fluksit të parasë përfshijnë një shlyerje të ekspozimit të plotë bruto si nga pjesa e siguar ashtu edhe nga ajo e pasiguar, ne rregullojmë kohën e shlyerjes fillestare duke përdorur faktorë të shkallëzimit për të modeluar fluksin e parave që mbulojnë vetëm një pjesë të pasiguar të ekspozimit. Në këtë mënyrë ruhet koha e flukseve të parave dhe vetëm shumata e fluksit të parave rregullohen proporcionalisht.

Humbja nga mospagimi LGD

Në rast të një ngjarje mospagimi, parametri LGD tregon se sa do të humbet nga ekspozimi i papaguar. Në rast se ka të dhëna të mjaftueshme për humbjet, LGD mund të vlerësohet duke krahasuar ekspozimin e papaguar me rrjedhat e parave të zbritura ('LGD e ristrukturuar). Nëse të dhënat e disponueshme për humbjet janë të kufizuara, mund të përdoren të dhëna të jashtme ('LGD e nënkuptuar e tregut').

Norma efektive e interesit (EIR)

Norma efektive e interesit përcaktohet në fluksin kontraktuale të parasë. Për një aset financiar me normë fikse, duhet të përdoret EIR në njohjen fillestare, ndërsa për një aset financiar me normë luhatëse, duhet të zbatohet EIR aktuale. Për një aset financiar POCI, kërkohet EIR e rregulluar për kredi, e përcaktuar në njohjen fillestare. Për një aset financiar në mospagim, do të përdoret EIR e fundit e disponueshme para riklasifikimit.

Faza 1

Faza 1 e zhvlerësimit paraqet humbjet e pritshme nga ngjarjet e mundshme të mospagimit brenda 12 muajve nga data e raportimit. Humbjet e pritshme të Fazës 1 përcaktohen si një pjesë e humbjes së pritshme kreditore të jetëgjatësisë. Një humbje e pritshme kreditore 12-mujore njihet në dy raste:

- nëse nuk ka ndodhur ndonjë rritje e konsiderueshme e rrezikut kreditor në instrumentin financiar ose
- në njohjen fillestare të instrumentit financiar.

Faza 1 mbulon humbjen e pritshme nga ngjarjet e mospagimit që priten deri në 12 muaj pas datës së bilancit të gjendjes. Ajo nuk mbulon humbjet në instrumentet financiare që mund të rezultojnë në mospagim në 12 muaj. Ose shprehur ndryshe, ajo nuk mbulon mungesat e parave të gatshme të pritshme për 12 muaj. Në Fazën 1, periudha maksimale për t'u marrë parasysh kur llogariten humbjet e pritshme është 12 muaj. Për të gjitha instrumentet financiare afatgjata (me maturitet më të gjatë se 1 vit), zhvlerësimi bazohet në ECL 12-mujore në vend të ECL të jetëgjatësisë, e cila është përparësia kryesore e Fazës 1. Parametrat e përfshirë në llogaritjen e ECL kanë horizont 12 mujor, i cili është në një farë mase i ngjashëm me modelin e llogaritjes së humbjes kreditore të portofolit të SNK 39. Sidoqoftë, të gjitha instrumentet financiare afatshkurtra (me maturitet më pak se 1

vit) trajtohen në përputhje me qasjen e humbjes së pritshme të jetëgjatësisë. Ndryshe nga SNK 39, lejohet të zbatohet një llogaritje e humbjes së pritshme të bazuar në maturim në vend të një llogaritje të humbjes së pritshme 12-mujore. Praktikisht, instrumentet financiare afatshkurtra janë në Fazën 1 të matura me humbjen e pritshme kreditore të jetëgjatësisë, që përfaqëson vetëm pjesën e humbjes së pritshme kreditore 12-mujore. Në raste të tilla, humbjet e pritshme kreditore të Fazave 1 dhe 2 do të jenë humbjet e pritshme kreditore të jetëgjatësisë dhe, për këtë arsye, ato do të jenë të barabarta. Për instrumentet financiare jashtë bilancit, një vlerësim i humbjes së pritshme kreditore 12-mujore (ose të jetëgjatësisë për maturitetet afatshkurtra) bazohet në pritshmëritë e pjesës së pozicionit jashtë bilancit që do të tërhiqet brenda 12 muajve nga data e raportimit. Llogaritja e humbjes së pritshme nuk ndryshon midis Fazës 1 dhe Fazës 2. Vetëm horizonti kohor është i ndryshëm.

Faza 2

Standardi përkufizon humbjen kreditore si diferenca midis të gjitha flukseve kontraktuale të parave që janë në vonesë në përputhje me kontratën dhe të gjitha flukset e parave që banka pret t'i marrë (pra, të gjitha mungesat e parave), zbritur në normën origjinale efektive të interesit (ose normën efektive të interesit të përshtatur për kredi për asetet POCL). Humbjet e pritshme kreditore të jetëgjatësisë përcaktohen si humbjet e pritshme kreditore që vijnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të mospagimit gjatë jetëgjatësisë së pritshme të një instrumenti financiar. Duhet vlerësuar rreziku i ndodhjes së një mospagimi në instrumentin financiar gjatë jetëgjatësisë së tij të pritshme. Për llogaritjen e humbjes së pritshme kreditore (ECL) për Fazën 1 dhe Fazën 2 po përdoret i njëjti ekuacion. Dallimi i vetëm midis Fazës 1 dhe Fazës 2, përveç perspektivës së ndryshme kohore, është se për Fazën 2, humbja e pritshme kreditore zbritet me normën efektive të interesit (EIR) për të gjitha instrumentet financiare, ndërsa në Fazën 1, vetëm humbjet e pritshme për instrumentet financiare në maturim në 12 muaj zbriten me EIR.

Faza 3

Kur përcaktohet ECL e jetëgjatësisë për Fazën 3, vlejën të njëjtat kërkesa si për asetet e Fazës 2. ECL është vlerësimi më i mirë me probabilitet të ponderuar të humbjeve kreditore duke marrë parasysh informatat përkatëse të arsyeshme dhe të mbështetura që janë në dispozicion në datën e raportimit pa kosto ose përpjekje të panevojshme. Një humbje kreditore përcaktohet si diferenca midis flukseve të parave që i detyrohen një njësie ekonomike në përputhje me kontratën si dhe flukseve të parave që njësia ekonomike pret t'i marrë, zbritur me normën origjinale efektive të interesit.

Si parim i përgjithshëm, humbjet e pritshme të jetëgjatësisë duhet të përcaktohen, sa herë që RBKO të jetë e informuar, që jo të gjitha detyrimet e klientit ndaj bankës do të përmbushen/shlyhen dhe, rrjedhimisht, banka do të pësojë humbje në:

- Faljen e shlyerjeve të principalit,
- Faljen e interesit,
- Shitjen e ekspozimit nën vlerën kontabël,
- Humbjen e pësuar nga banka gjatë mbylljes së zërave të FX ose zërave të tjerë jashtë bilancit të lidhura me klientin dhe klienti nuk i përmbush dhe/ose nuk është në gjendje t'i përmbushë detyrimet e tij,
- Dhënen e normave të interesit për klientin dukshëm nën ato të tregut (nën koston e financimit të bankës ose zero),
- Shkaktimin e shpenzimeve të brendshme/të jashtme të parikuperueshme,
- Rikuperimin e një pjese më të vogël se sa ajo e papaguar përmes realizimit të kolateralit.

Humbjet e pritshme të jetëgjatësisë duhet të merren parasysh në rast se:

- Shumat janë vonuar për më shumë se 90 ditë,
- Falimentimi, paafësia paguese, ose procedura të ngjashme kundër klientit kanë filluar,
- Vështirësitë ekonomike të klientit, të cilat ka shumë të ngjarë të rezultojnë në rikuperime për bankën më pak se shuma e papaguar (pavarësisht nga koha e shlyerjes së mundshme - të pjeshme).

Informatat parashikuese dhe rregullimi makroekonomik i parametrit të probabilitetit të mospagimit PD(t)

Probabiliteti i mospagimit, kur është e përshtatshme, rregullohet për statusin aktual të makroekonomisë dhe perspektivën e saj në të ardhmen. Përmes kësaj rregullimi, informatat parashikuese hyjnë në llogaritjen e ECL. Rregullimi i probabiliteteve të mospagimit kryhet përmes një modeli makroekonomik, i cili përshkruan statusin e ciklit të kredisë. Ky model makroekonomik përfaqësohet nga faktori i vetëm i rrezikut, për kohën. Modeli makroekonomik përbëhet nga disa variabla makroekonomikë. Këto variabla azhurnohen rregullisht dhe shpesh për ta pasqyruar statusin aktual të makroekonomisë dhe informatat parashikuese Rregullimi makroekonomik i probabilitetit të mospagimit kryhet për llogaritjen e humbjes së pritshme kreditore dhe kriterin sasior.

Vlerësimi i modelit një-faktor dhe modelit makroekonomik

Brenda secilin grupim vlerësimi, modeli vlerësohet në mënyrën vijuese:

- Duke përdorur të dhënat e mospagimit, vlerësimi për secilin grupim X_{bucket} dhe p_{bucket} nxirret përmes gjasave maksimale. Vlerësimi X_{bucket} i faktorit të vetëm të rrezikut mund të interpretohet si statusi i ciklit të kredisë, bazuar në nivelin e normave të mospagimit, të cilat janë vërejtur për periudhën përkatëse kohore.

- Për secilin grupim vlerësimi, merret një model linear për vlerësimet X_{bucket} duke përdorur të dhëna makro, p.sh. $X_{\text{bucket}}(s) = \beta_0 + \beta_1 \cdot \text{GDP}_{\text{(bucket)s}}$. Vlerësimi X_{bucket} i nxjerrë në hapin 1 shërben si variabël e varur për modelin e regresit linear, ndërsa variablat makroekonomike shërbejnë si variabla shpjeguese. Qëllimi i këtij hapi është që ta shpjegojë statusin e ciklit të kredisë, pra nivelin e normave të mospagimit, përmes variablave makroekonomike.

Humbja e pritshme kreditore - Portofoli i Retail

Banka mat humbjet e pritshme kreditore të një instrumenti financiar në një mënyrë që reflekton:

- Një sasi të paanshme dhe me probabilitet të ponderuar që përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme,
- Vlerën kohore të parave,
- Informatat e arsyeshme dhe të mbështetura që janë në dispozicion pa kosto apo përpjekje të panevojshme në datën e raportimit për ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme ekonomike të pasqyruara përmes mbulimit makroekonomik.

Në përcaktimin e flukseve të parave që banka pret t'i marrë, ajo do ta miratojë një qasje të shumëzës së humbjeve margjinale, përmes së cilës ECL-të llogariten si shuma e humbjeve margjinale që ndodhin në çdo periudhë kohore nga data e raportimit. Humbjet margjinale rrjedhin nga parametrat individualë që vlerësojnë ekspozimet dhe humbjet në rast të mospagimit dhe probabilitetin margjinal të mospagimit (PD) për secilën periudhë. Periodiciteti që do të përdoret do të jetë mujor (pra, do të merren parasysh humbjet margjinale ndërmjet muajve).

Faza 1 dhe 2

Përafrimi i PD

Në raste të caktuara, metodologjia e plotë e modelimit të analizës së mbijetesës e përshkruar më sipër ose nuk është e zbatueshme (p.sh. sasi e ulët e të dhënave në shkallët e vlerësimit) ose çon në rezultate të painterpretueshme (p.sh. përshtatja e dobët për shkallët e vlerësimit të mospagimit të ulët). Nëse për ndonjë arsye, metoda e përgjithshme e analizës së mbijetesës e përshkruar më lart ka rënë, lakoret e PD mund të përafrohen duke përdorur metodologji më të thjeshta.

Opsioni 1: Në rast se analiza e mbijetesës dështon në nivelin e shkallëve të vlerësimit (p.sh. për shkak të sasisë së ulët të të dhënave), zbatoheni atë në nivelin e plotë të portofolit për të nxjerrë lakoret e PD dhe PFP në nivel produkti. Kjo është e zbatueshme edhe nëse njësitë ekonomike nuk ka pasur kurrë një sistem vlerësimi. Dallimi për këto portofole më të vogla do të ishte që ato do të kenë vetëm një lakore PD për të gjithë portofolin, e jo lakore të ndryshme bazuar në shkallën e vlerësimit. Ky mund të konsiderohet si një version i thjeshtuar i analizës së mbijetesës, por që është në përputhje me metodologjinë për portofolet e tjera dhe që lejon gjithashtu edhe mbulimin makroekonomik. Për llogaritjen e ECL, duhet të mbahet shuma e humbjeve margjinale.

Opsioni 2: Nëse Opsioni 1 dështon, njësitë ekonomike kanë mundësinë t'i përdorin normat e tyre mesatare të realizuara 12-mujore të Mospagimit (PD Mesatare Afatgjatë me Ponderimin e Vëzhgimit dhe të Dhënave Reale).

Opsioni 3: Nëse Opsioni 2 nuk mund të përdoret, për shembull për shkak të historisë së pamjaftueshme të mospagimit, mungesës së të dhënave ose në rast të produkteve të reja, opsioni i fundit është përdorimi i një standardi për PD 12-mujore. Standardet janë krijuar nga Zyra Qendrore e RBI në Vjenë - Rreziku Retail, duke përdorur vlerat mesatare të PD të llogarive me vlerësime ekzistuese të PD. Llogaritja bazohet në të dhënat ekzistuese të disponueshme në Zyren Qendrore, duke përfshirë llogaritjet me mospagim dhe ato që pavlerësuar dhe duke përdorur mesataret e thjeshta. Standardet e përdorura për bankën janë ato që përfshijnë vende nga rajoni i Evropës Juglindore (EJL). Standardet grupohen sipas Produktit dhe Rajonit Gjeografik dhe janë rrumbullakuar me një hap prej 50bps. Ato do të rivlerësohen çdo vit dhe do të azhurnohen nëse është e nevojshme, nga Rreziku Retail i RBI. Standardet e vlefshme 12-mujore të PD-së aktualisht janë::

Segmenti	Lloji i produktit	SEE
PI	Kredi hipotekare	2,0%
	Kredi personale	5,5%
	Kredit Kartelë	3,5%
	Mbitërheqje	3,5%
	Kreditë për makina	2,5%
	Produkte të Tjera	5,0%
Mikro NVM	Të gjitha produktet	5,5%

Mbulimi makroekonomik

Vlerësimet e SNRF 9 duhet të përfshijnë parashikime të kushteve të ardhshme ekonomike. Kjo trajtohet përmes të ashtuquajturit "mbulimi makroekonomik" i cili do të zbatohet për vlerësime. Si rezultat, një vektor i PD-ve dhe PFP-ve kumulative do të përshtatet për secilin skenar makroekonomik.

LGD

Përafrimi i LGD

Në rast se nuk ekziston vlerësimi i LGD i Bazelit, vlerësimi i LDG i përputhshëm me SNRF 9 mund të përafrohet nga modele më të thjeshta.

Opsioni 1: Modeli i rikuperimit sipas vjetërsisë (vintage),

Opsioni 2: Norma e thjeshtë ekzistuese 12-mujore e rikuperimit,

Opsioni 3: Standardet e LGD.

Nëse asnjë nga modelet e tjera nuk janë të zbatueshme, do të përdoren standardet e LGD. Standardet janë krijuar nga Zyra Qendrore e RBI në Vjenë - Rreziku Retail, duke përdorur vlerat mesatare të LGD të llogarive me vlerësime ekzistuese të LGD. Llogaritja bazohet në të dhënat ekzistuese të disponueshme në Zyrën Qendrore, duke përfshirë llogaritë me mospagim dhe ato të pavlerësuar dhe duke përdorur mesataret e thjeshta. Standardet e përdorura për bankën janë ato që përfshijnë vende nga rajoni i Evropës Juglindore (EJL). Standardet grupohen sipas Produktit dhe Rajonit Gjeografik dhe janë rumbullakuar me një hap prej 5pp. Ato do të rivlerësohen çdo vit dhe do të azhurnohen nëse është e nevojshme, nga Rreziku Retail i RBI. Standardet aktuale të vlerësime të LDG për rajonin e EJL janë:

Segmenti	Lloji i produktit	EJL
PI	Kredi hipotekare	30%
	Kredi personale	50%
	Kredit Kartelat	40%
	Mbitërheqjet	50%
	Kreditë për makina	50%
	Produkte të Tjera	50%
Mikro NVM	Të gjitha produktet	50%

Mbulimi makroekonomik

Sic kërkohet nga SNRF 9, vlerësimi i LGD-së duhet të marrë në konsideratë parashikimet përkatëse makroekonomike për vitet e ardhshme nëse ka prova të arsyeshme dhe të mbështetura se marrëdhënia midis normave të rikuperimit dhe faktorëve makroekonomikë ekziston për portofolin në shqyrtim. Për ekspozimet e siguruar, kjo LGD mund të përshtatet më tej për t'i pasqyruar zhvillimet e pritura në vlerat e kolateralit gjatë viteve të ardhshme, kur kjo ka ndikim në rikuperime.

Rregullimet makroekonomike do të aplikohen në baza mujore. Vlerësimet përfundimtare të LGD me mbulim makroekonomik do të bëhen kështu vektor i vlerave (i varur nga skenari makroekonomik).

EAD

Ekspozimi në mospagim është një tjetër komponent kyç i llogaritjes së ECL. Megjithatë SNRF 9 nuk kërkon në mënyrë të qartë që bankat ta modelojnë EAD, të kuptuarit se si ekspozimet e kredive priten të ndryshojnë me kalimin e kohës është thelbësore për një matje të paanshme të ECL. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për Fazën 2, ku pika e mospagimit mund të jetë disa vjet në të ardhmen. Injorimi i një rënie të pritshme të ekspozimit (p.sh. në një kredi të ripagueshme me këste) mund të çojë në matje shumë të larta të ECL-ve. Injorimi i një rritje të pritshme të ekspozimit (tërheqjet brenda një kufiri të rënë dakord për një instrument revolves) mund të çojë në matje shumë të ulëta të ECL-ve.

Përafrimi i CCF

Në rast të mungesës së vlerësimit të CCF, duhet të përdoren vlerat referuese të CCF (të nxjerra nga Direktiva e BE 575 (CRR), Kapitulli 2 "Qasja e standardizuar" dhe Shtojca I). Më të rëndësishmet për Retail janë:

- 100 për qind për garancitë që kanë karakter të zëvendësuesve të kredive,
- 50 për qind për zërat jashtë bilancit të financimit tregtar,
- 20 për qind për zërat jashtë bilancit të financimit tregtar.

Humbja e pritshme kreditore për ekspozimet në mospagim (Faza 3)

Për një aset financiar me kredi të zhvlerësuar në datën e raportimit, por që nuk është aset financiar i blerë ose i origjinës me kredi të zhvlerësuar, një njësi ekonomike do të masë humbjet e pritshme kreditore si diferenca midis vlerës kontabël neto të asetit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parave të gatshme të zbritura në normën origjinale efektive të interesit të asetit financiar.

Në rast të zotimeve të papaguara (patërhequra) që ekzistojnë akoma për një ekspozim në mospagim, ato do të konsiderohen me CCF = 100% kur përcaktohet EAD.

Nëse nuk ekzistojnë informata të arsyeshme dhe të mbështetura për ta matur ECL në bazë të një instrumenti individual, ECL e jetëgjatësisë për asetet në Fazën 3 do të njihet mbi një bazë kolektive që merr parasysh informata gjithëpërfshirëse të rrezikut kreditor (SNRF 9.5.5.4) - i njëjti trajtim si për asetet në fazat 1 dhe 2. Tri metodat që do të përdoren në segmentin retail janë:

- Vlerësimi kolektiv për ekspozimet e pasiguara - vlerësimi më i mirë i humbjes së pritshme;
- Vlerësimi kolektiv për ekspozimet e siguruara - vlera e ponderuar e zbritur e kolateralit;
- Vlerësimi individual.

Vlerësimi kolektiv për ekspozimet e pasiguara - Vlerësimi më i mirë i humbjes së pritshme (BEEL)

Në këtë kuptim, Rreziku Retail i Bankës konsideron se mënyra më e përshtatshme për ta pasqyruar përvojën historike të humbjeve në vlerësimin e flukseve të pritshme të parave të gatshme të një ekspozimi të pasiguara të mospagimit është duke e përdorur parametrin e ashtuquajtur Vlerësimi më i Mirë i Humbjes së Pritshme (BEEL). Sipas përkufizimit, ky parametër pasqyron potencialin më të mundshëm të humbjes për llogaritë në mospagim, të cilat kanë profil të ngjashëm të rrezikut dhe rikuperimit si dhe siguron një nivel të vlerësuar të nxjerrë statistikiqisht të humbjes për llogari të tilla. Prandaj, duhet të sigurohet që përdorimi i BEEL për të rregulluar flukset kontraktuale të parave në rikuperimin e tyre të vlerësuar po zbatohet në një grup homogjen të llogarive.

Modeli i vlerësimit për BEEL konsideron rikuperimet e zbitura për ekspozimet që janë tashmë në mospagim. Pasi modeli është krijuar që të sigurojë vlerësimin më të mirë të potencialit të humbjes deri në fund të periudhës së ristrukturimit, llogaritë për të cilat pika e vëzhgimit përkon me fundin e periudhës së ristrukturimit supozohet të kenë rikuperim zero, pra, Vlerësimi më i mirë i humbjes së pritshme është 100 për qind. Në mënyrë që të jetë e përshtatshme për qëllime provizionimi, duhet të sigurohet që në secilën periudhë raportuese secila llogari në mospagim të shoqërohet me një vlerësim që pasqyron përvojën më të fundit të rikuperimit për këtë llogari dhe kështu të përcaktohet potenciali i pritshëm i rikuperimit. Vlerat e BEEL duhet të azhurnohen çdo muaj.

Qasja e thjeshtuar

Ekziston një qasje e thjeshtuar e cila ka disa thjeshtësime operacionale dhe duhet të zbatohet ose është zgjedhje e politikave për të arkëtueshmet tregtare, asetet e kontratës dhe të arkëtueshmet nga qiraja. Kjo përfshin kërkesën ose zgjedhjen e politikave për ta zbatuar qasjen e thjeshtuar që nuk kërkon që njësitë ekonomike t'i përcjellin ndryshimet në rrezikun kreditor dhe mjetin praktik për t'i llogaritur humbjet e pritshme kreditore për të arkëtueshmet tregtare, duke përdorur një matricë provizionit. Për çdo ekspozim të tillë për të cilin zbatohet qasja e thjeshtuar, banka do t'i njohë humbjet e pritshme kreditore të jetëgjatësisë në fitim dhe humbje.

Asetet financiare të blera ose të origjinës të kreditit të zhvlerësuar (asete që tashmë kanë rënie në vlerë në matjen fillestare në bilancin e gjendjes-POCI)

Për asetet financiare të cilat janë me kredi të zhvlerësuar gjatë njohjes fillestare, një njësi do t'i njohë vetëm ndryshimet kumulative në humbjet e pritshme kreditore të jetëgjatësisë që nga njohja fillestare, si lejim i humbjes për asetet financiare të blera ose të origjinuara me kredi të zhvlerësuar. Një aset financiar ka kredi të zhvlerësuar (rënie në vlerë) kur kanë ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë ndikim të dëmshëm në flukset e vlerësuar të parave për të ardhmen të këtij aseti financiar.

Shkaktarët e fazës 2

Rritja e konsiderueshme e rrezikut kreditor për qëllimin e lejimit të fazës 2 perceptohet në aspektin e:

- Një mase sasiore, kur mund të llogaritet,
- Një mase cilësore në raste të tjera, dhe
- Treguesit e rezervës (backstop).

Ekziston një supozim i kundërshtueshëm që rreziku kreditor për një aset financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, më së voni kur pagesat kontraktuale janë më shumë se 30 ditë të vonuara. Supozimi mund të kundërshtohet nëse një njësi ka informata të arsyeshme dhe të mbështetura që demonstrojnë se rreziku kreditor nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. Prandaj mund të ndodhë që supozimi të jetë i kundërshtueshëm kur pagesat kontraktuale janë më shumë se 30 ditë në vonesë nëse:

- Mospagesa ishte një mbikëqyrje administrative,
- Banka ka qasje në prova historike që demonstrojnë se ekziston një korrelacion midis rritjeve të konsiderueshme të rrezikut kreditor dhe më shumë se 30 ditëve në vonesë.

Në rastet kur supozimi i kundërshtueshëm hidhet poshtë duhet të theksohet se banka nuk mund të rregullojë kohën e rritjeve të konsiderueshme të rrezikut kreditor dhe njohjen e humbjeve të pritshme kreditore të jetëgjatësisë me kohën kur një aset financiar konsiderohet se ka kredi të zhvlerësuar ose kur instrumenti financiar konsiderohet të jetë i papaguar. Në rastet kur 30 ditët në vonesë janë hedhur poshtë do të jetë e nevojshme të vendoset një kufi për një rezervë (backstop) të re, i cili nuk do të jetë më i lartë se 90 ditë në vonesë dhe të sigurojë prova për këtë.

Vlerësimi i transferimit të fazave mbi baza kolektive

Mund të mos jetë e mundur të vlerësohet nëse ka pasur rritje të rrezikut kreditor mbi një bazë individuale dhe për këtë arsye ky vlerësim mund të kryhet gjithashtu mbi një bazë kolektive. Për shembull, ky mund të jetë rasti për kreditë retail, ku ka pak informata

ose aspak informata të azhurnuara të rrezikut kreditor që merren dhe monitorohen në mënyrë rutinore në një instrument individual, derisa një klient të shkelë kushtet e kontratës. Nëse banka mbështetet vetëm në informatat e vonesave, kjo nuk do të përfaqësojë në mënyrë të besueshme ndryshimet në rrezikun kreditor që nga njohja fillestare. Në raste të tilla, humbjet e pritshme kreditore të jetëgjatësisë do të njihen mbi një bazë kolektive që merr në konsideratë informatat gjithëpërfshirëse të rrezikut kreditor. Këto informata gjithëpërfshirëse të rrezikut kreditor duhet të përfshijnë jo vetëm informatat e vonesave, por edhe të gjitha informatat përkatëse të kredisë, përfshirë informatat makroekonomike për të ardhmen, në mënyrë që të përafrohet rezultati i njohjes së humbjeve të pritshme kreditore të jetëgjatësisë, kur ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor që nga njohja fillestare. Për qëllime të përcaktimit të rritjeve të konsiderueshme të rrezikut kreditor dhe njohjes së një lejimi për humbje mbi një bazë kolektive, banka do të grupojë instrumentet financiare në bazë të karakteristikave të përbashkëta të rrezikut kreditor me qëllim të bëjë të mundur një analizë që synon për të mundësuar që rritjet e konsiderueshme të rrezikut kreditor të identifikohen në kohë.

Karakteristikat e përbashkëta të rrezikut kreditor mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Llojin e instrumentit,
- Vlerësimet e rrezikut kreditor,
- Llojin e kolateralit,
- Datën e njohjes fillestare,
- Afatin e mbetur deri në maturim,
- Industrinë,
- Vendndodhjen gjeografike të huamarrësit.

Vlera e kolateralit në raport me asetin financiar nëse ka ndonjë ndikim në probabilitetin e ndodhjes së një mospagimi (për shembull, kreditë pa rekurs në disa juridiksione ose raportet e kredisë ndaj vlerës). Kërkohej që humbjet e pritshme kreditore të jetëgjatësisë të njihen në të gjitha instrumentet financiare për të cilat ka pasur rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor që nga njohja fillestare. Për ta përmbyshur këtë objektiv, nëse banka nuk është në gjendje të grupojë instrumentet financiare për të cilët rreziku kreditor konsiderohet të jetë rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, bazuar në karakteristikat e përbashkëta të rrezikut kreditor, atëherë banka do t'i njohë humbjet e pritshme kreditore të jetëgjatësisë në një pjesë të asetëve financiare për të cilat rreziku kreditor vlerësohet të jetë rritur ndjeshëm. Për më tepër, kur përdoret përvoja e humbjes historike kreditore në vlerësimin e humbjeve të pritshme kreditore, është e rëndësishme që informatat në lidhje me normat e humbjes historike kreditore të zbatohen për grupet që përcaktohen në atë mënyrë që është në përputhje me grupet për të cilat janë vërejtur normat e humbjeve historike kreditore. Si pasojë, metoda e përdorur do të lejojë që secili grup i asetëve financiare të shoqërohet me informata në lidhje me përvojën e humbjes kreditore në të kaluarën në grupe të asetëve financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut dhe me të dhëna përkatëse të vëzhgueshme që pasqyrojnë kushtet aktuale.

Prapakthimi i transferimit të fazave

Nëse banka ka matur lejimin e humbjes për një instrument financiar në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të jetëgjatësisë gjatë periudhës raportuese të mëparshme, por përcakton në datën aktuale të raportimit që ndryshimi në rrezikun kreditor nga njohja fillestare nuk është më domethënës, banka do ta masë lejimin e humbjes në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme kreditore për 12 muaj në datën aktuale të raportimit. Duhet të theksohet se prapakthimi i transferimit të fazës, kur është e sigurt se ka pasur një ulje të rrezikut kreditor në një nivel që nuk është më domethënës dhe për më tepër që flamuj, të tillë si shtyrja/riprogramimi (forbearance), nuk ekzistojnë më.

Transferimi i fazave për asetet financiare të modifikuara

Nëse flukset kontraktuale të parave në një aset financiar janë rinegociuar ose modifikuar dhe asetit financiar është çregjistruar, atëherë asetit konsiderohet si aset financiar "i ri" dhe data e modifikimit konsiderohet të jetë data e njohjes fillestare. Kjo nënkupton matjen e lejimit të humbjes në një shumë e cila është e barabartë me humbjet e pritshme kreditore 12-mujore derisa të plotësohen kërkesat për njohjen e humbjeve të pritshme kreditore të jetëgjatësisë. Sidoqoftë, në disa raste kur modifikimi rezulton në çnjohje/çregjistrim të asetit origjinal financiar, mund të ketë prova që asetit financiar i modifikuar është me kredi të zhvlerësuar që nga njohja fillestare, dhe kështu, asetit financiar duhet të njihet si aset financiar i origjinaluar me kredi të zhvlerësuar dhe humbjet e pritshme të jetëgjatësisë duhet të përdoren si bazë për t'i matur humbjet e pritshme kreditore.

Nëse flukset kontraktuale të parave në një aset financiar janë rinegociuar ose modifikuar dhe asetit financiar nuk është çnjohur, banka do të vlerësojë nëse ka pasur rritje të konsiderueshme në rrezikun kreditor të instrumentit financiar duke krahasuar:

- Rrezikun e një mospagimi në datën e raportimit (bazuar në kushtet e modifikuara kontraktuale),
- Rrezikun e një mospagimi në njohjen fillestare (bazuar në kushtet kontraktuale origjinale, të pa modifikuara).

Për më tepër, provat se kriteret për njohjen e humbjeve të pritshme kreditore të jetëgjatësisë nuk përmbyshen më mund të përfshijnë një histori të performancës së azhurnuar dhe në kohë të pagesave kundrejt kushteve të modifikuara kontraktuale. Në mënyrë tipike, një klient do të duhet që vazhdimisht të demonstrojë sjellje të mirë paguese për një periudhë kohore para se rreziku kreditor të konsiderohet të ketë rënë. Për shembull, një histori e pagesave të humbura ose jo të plota zakonisht nuk do të fshihet duke bërë thjesht një pagesë në kohë pas një modifikimi të kushteve kontraktuale.

Shkaktarët e fazës 3

Sipas modelit të përkeqësimit, një instrument financiar duhet të transferohet në fazën 3 (pra, është me kredi të zhvlerësuar) kur të kenë ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë ndikim të dëmshëm në flukset e vlerësuar të ardhshme të parave të gatshme. Nëse kërkesat për transferimin e fazave nuk përmbushen më (pra, instrumenti nuk është më i kreditit të zhvlerësuar), ai do të transferohet përsëri në fazën 1 ose 2 (pra, qasja është simetrike). Lista e mëposhtme merret si tregues për “kreditit të zhvlerësuar”:

- vështirësi të konsiderueshme financiare të huadhënësit ose huamarrësit,
- shkelje e kontratës, të tilla si ngjarje mospagimi ose vonese,
- huadhënësi/t e huamarrësit, për arsye ekonomike ose kontraktuale në lidhje me vështirësinë financiare të huamarrësit, i ka dhënë huamarrësit një koncesion të cilin huadhënësi nuk do ta merrte parasysh në rastin e kundërt,
- po bëhet e mundshme që huamarrësi do të hyjë në falimentim ose riorganizim tjetër financiar,
- zhdukja e një tregu aktiv për atë aset financiar për shkak të vështirësive financiare, ose
- blerja ose origjinimi i një asemi financiar me një zbritje të madhe që pasqyron humbjet e pësuarat kreditorë.

Për shkak të fushës së ndryshuar të SNRF 9, krahasuar me SNK 39, edhe zotimet e kredive dhe kontratat e garancisë financiare do të mbuloohen nga i njëjti proces (zëvendësimi i vlerësimit të SNK 37). Ekziston një supozim i kundërshtueshëm që mospagimi nuk ndodh më vonë sesa kur një aset financiar është 90 ditë në vonesë, përveç nëse banka ka informata të arsyeshme dhe të mbështetura për të demonstruar se një kriter më i ngecur i mospagimit është më i përshtatshëm. Përcaktimi i mospagimit të përdorur për këto qëllime do të zbatohet vazhdimisht për të gjithë instrumentet financiare përveç nëse ka informata të disponueshme që demonstrjnë se një përkufizim tjetër i mospagimit do të ishte më i përshtatshëm për një instrument të veçantë financiar.

Për shkak të fushëveprimit të ndryshuar të SNRF 9 - Zhvlerësimi krahasuar me SNK 39, do të merren parasysh aspektet e mëposhtme. Së pari, zotimet e kredive dhe kontratat e garancisë financiare do të mbuloohen nga i njëjti proces (zëvendësimi i vlerësimit të SNK 37), nëse nuk janë përfshirë tashmë në proceset aktuale. Së dyti, instrumentet e kapitalit nuk përfshihen në fushëveprimin e SNRF 9 - Zhvlerësimi. Të gjithë instrumentet në fushëveprimin e SNRF 9 –Zhvlerësimi, kur pala tjetër është në mospagim do të transferohet në fazën 3. Për më tepër, kreditë plotësisht të kolateralizuara me provizion zero të rrezikut, kur pala është në mospagim, do të caktohen në fazën 3 (nëse zbatohet ‘modeli i përkeqësimit të kredisë’).

Qasja ndaj zërave jashtë bilancit

Për zotimet e kredive dhe kontratat e garancisë financiare, data kur njësia bëhet palë e zotimit të parevokueshëm do të konsiderohet të jetë data e njohjes fillestare për qëllimet e zbatimit të kërkesave për zhvlerësim. Për zotimet e kredive, një njësi i shqyrton ndryshimet në rrezikun e mospagimit të një kredie me të cilën lidhet një zotim i kredisë. Për kontratat e garancisë financiare, një njësi shqyrton ndryshimet në rrezikun që debitori i specifikuar do të ketë mospagim në kontratë. Në të dy rastet për një aset financiar, humbja kreditorë është vlera aktuale e diferencës midis flukseve kontraktuale të parave që i detyrohen një njësie sipas kontratës dhe flukseve të parave që njësia pret t’i marrë. Në rastin e zotimeve të kredisë së patërhequr, humbja kreditorë është vlera aktuale e diferencës midis flukseve kontraktuale të parave që i detyrohen njësisë nëse mbajtësi i zotimit të kredisë tërheq kredinë dhe flukseve të parave që njësia pret t’i marrë nëse kredia tërhiqet.

Vlerësimi i Bankës për humbjet e pritshme kreditorë për zotimet e kredive do të jetë në përputhje me pritshmëritë e saj për tërheqje të këtij zotimi të kredisë, pra, ajo do të marrë parasysh pjesën e pritshme të zotimit të kredisë që do të tërhiqet brenda 12 muajve nga data e raportimit, kur vlerësohen humbjet e pritshme kreditorë 12 mujore dhe pjesën e pritshme të zotimit të kredisë që do të tërhiqet gjatë jetëgjatësisë të zotimit të kredisë kur vlerësohen humbjet e pritshme kreditorë të jetëgjatësisë.

Për një kontratë garancie financiare, njësisë i kërkohet të bëjë pagesa vetëm në rast të një mospagimi nga debitori, në përputhje me kushtet e instrumentit që është garantuar. Në përputhje me rrethanat, mungesat e parave të gatshme janë pagesat e pritshme për ta rimbursuar mbajtësin për një humbje kreditorë që shkakton, minus shumat që njësia pret të marrë nga mbajtësi, debitori ose ndonjë palë tjetër. Nëse asemi është plotësisht i garantuar, vlerësimi i mungesave të parave të gatshme për një kontratë garancie financiare do të ishte në përputhje me vlerësimet e mungesave të parave të gatshme për asetin që i nënshtrohet garancisë.

Humbjet e pritshme kreditorë për një zotim të kredisë do të zbriten duke përdorur normën efektive të interesit, ose një përafrim të saj, që do të zbatohet kur njihet asemi financiar që rezulton nga zotimi i kredisë. Kjo ndodhë sepse për qëllimin e zbatimit të kërkesave për zhvlerësim, një aset financiar që njihet pas tërheqjes së një zotimi kredie do të trajtohet si vazhdim i atij zotimi,, e jo si një instrument i ri financiar. Humbjet e pritshme kreditorë në asemi financiar do të maten duke marrë parasysh rrezikun fillestar të zotimit të kredisë nga data kur njësia u bë palë e zotimit të parevokueshëm.

Banka vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka prova objektive që një aset financiar ose një grup asetesh financiare është zhvlerësuar. Një aset financiar ose një grup asetesh financiare zhvlerësohen vetëm nëse ka prova objektive të zhvlerësimit, si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të asetit (një ‘ngjarje humbjeje’) dhe ajo ngjarje humbjeje ka ndikim në flukset e vlerësuar të ardhshme të parave të asetit financiar ose grupit të asetëve financiare që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme.

Kriteret që Banka përdor për të përcaktuar se ka dëshmi objektive të humbjes nga zhvlerësimi përfshijnë:

- Vonesën (delinkuencën) në pagesa për pagesat kontraktuale të kryejësë ose interesit,

- Vështirësitë për huamarrësin sa i përket rrjedhës së parave të tij,
- Shkeljen e kushteve kreditore,
- Inicimin e procedurave të falimentimit,
- Përkeqësimin e pozicionit konkurrues të huamarrësit,
- Përkeqësimin e vlerës së kolateralit.

Periodha e vlerësuar ndërmjet humbjeve që ndodhin dhe identifikimi i saj përcaktohet nga menaxhmenti lokal për çdo portfolio të identifikuar. Në përgjithësi, periudha e përdorura variojnë nga 3 muaj deri në 12 muaj; në raste të jashtëzakonshme, jepen periudha më të gjata.

3.3.13 Informacioni parashikues

Banka përfshin informacionin parashikues në llogaritjen e zhvlerësimit. Kjo bëhet përmes modeleve makroekonomike, gjë që çon në një rregullim të drejtpërdrejtë të probabiliteteve të mospagesës. Për të qenë të saktë, informacioni parashikues inkorporohet nëpërmjet parametrave makroekonomikë të inputit të modelit makroekonomik. Meqenëse Banka nuk do të njohë me siguri realizimet e ardhshme të këtyre parametrave makroekonomikë, pasiguria e qenësishme e bën të nevojshme që të merret parasysh llogaritja e një skenari.

Banka i konsideron tre skenarë: Një skenar bazë, një skenar optimist dhe një skenar pesimist. Dy skenarëve të fundit i caktohet një peshë prej 25 për qind. Skenari bazë ka një peshë të caktuar prej 50 për qind në llogaritje. Qëllimi i skenarëve është gjithashtu të kujdesen për çdo jolinearitet të pranishëm në llogaritjen (humbjen e pritshme). Interpretimi i tre skenarëve është se secili nga tre skenarët është një skenar përfaqësues i kuartilin optimist, për kuartilin pesimist dhe për 50 për qind të pjesës së mbetur. Ky interpretim është i domosdoshëm pasi që probabiliteti që të ndodhë një skenar i caktuar është gjithmonë 0 për qind.

Për secilin skenar, një grup vlerash për variablat përkatës makroekonomikë jepet nga RBI Raiffeisen Research. Ky grup vlerash përdoret si një input për modelin makroekonomik, i cili më pas zbatohet për të rregulluar parametrin përkatës të inputit.

Analiza e ndjeshmërisë

Supozimet më të rëndësishme që ndikojnë në lejimin për humbjen e pritshme kreditore janë si më poshtë:

- Bruto produkti vendor,
- Shkalla e papunësisë,
- Norma e obligacioneve/bondeve afatgjata qeveritare,
- Norma e inflacionit.

3.3.14 Kreditë e riprogramuara dhe të modifikuara

Banka ndonjëherë bën lëshime ose modifikime të kushteve origjinale të kredive si një përgjigje ndaj vështirësive financiare të huamarrësit, në vend se të marrë në posedim ose të zbatojë mbledhjen e kolateralit. Banka konsideron një kredi si të riprogramuar kur koncesionet ose modifikimet e tilla ofrohen si rezultat i vështirësive financiare të pranishme ose të pritshme të huamarrësit dhe banka nuk do të kishte rënë dakord për të njëjtat nëse huamarrësi do të ishte financiarisht i shëndoshë. Treguesit e vështirësive financiare përfshijnë mospërbushjet e marrëveshjeve, ose shqetësime të konsiderueshme ngritur nga Departamenti i Riskut Kreditor. Riprogramimi mund të përfshijë zgjatjen e marrëveshjeve të pagesës dhe dakordimin e kushteve të reja të kredisë. Sapo kushtet të jenë rinegociuar, çdo zhvlerësim matet duke përdorur normën efektive origjinale të interesit siç llogaritet para modifikimit të termave. Është politikë e bankës që të monitorojë huatë e riprogramuara për të siguruar që pagesat e ardhshme të vazhdojnë të jenë të mundshme. Vendimet e çregjistrimit dhe klasifikimi ndërmjet Fazës 2 dhe Fazës 3 përcaktohen në bazë të secilit rast veç e veç. Nëse këto procedura identifikojnë një humbje në lidhje me një hua, ajo shpalolet dhe menaxhohet si një pasuri e zhvlerësuar e modifikuar e Fazës 3, derisa të mblidhet ose shlyhet. Nga 1 janari 2018, kur kredia është rinegociuar ose modifikuar, por nuk është çregjistruar, Banka gjithashtu rivlerëson nëse ka pasur një rritje të ndjeshme të risku kreditor, siç përcaktohet në Shënimin 4.

Banka gjithashtu shqyrton nëse asetet duhet të klasifikohen si Faza 3. Sapo një aset të klasifikohet si i riprogramuar, ai do të mbetet i tillë për periudhën provuese minimale 24 mujore. Në mënyrë që kredia të riklasifikohet nga kategoria e riprogramuar, klienti duhet të plotësojë të gjitha kriteret e mëposhtme:

- Të gjitha instrumentet e tij kreditore duhet të konsiderohen që janë performuese,
- Periudha e provës prej dy vjet ka kaluar nga data kur kontrata e modifikuar është konsideruar performuese,
- Pagesa të rregullta të më shumë se një shume të principalit ose interesit janë bërë gjatë së paku gjysmës së periudhës së provës,
- Konsumatori nuk ka ndonjë kontratë që ka më shumë se 30 ditë vonesë.

3.3.15 Humbjet nga zhvlerësimi i asetëve financiare

Matja e humbjeve nga zhvlerësimi sipas SNRF 9 në të gjitha kategoritë e asetëve financiare kërkon gjykim, në veçanti, vlerësimin e shumës dhe kohën e rrjedhave të ardhshme të parave dhe vlerave të kolateralit gjatë përcaktimit të humbjeve nga zhvlerësimi dhe vlerësimi i një rritje të konsiderueshme në rrezikun kreditor. Këto vlerësime janë të nxitura nga një numër faktorësh, ndryshime në të cilat mund të rezultojnë në nivele të ndryshme të lejimeve. Llogaritjet humbjeve të pritshme kreditore të bankës janë rezultatet e modeleve komplekse me një numër supozimesh themelore në lidhje me zgjedhjen e inputeve të ndryshueshme dhe ndërvarësinë e tyre. Elementet e modeleve të humbjeve të pritshme kreditore që konsiderohen gjykime dhe vlerësime kontabël përfshijnë:

- Modeli i brendshëm i klasifikimit të kredive të Bankës, i cili cakton probabilitetin e vonesave për vlerësimet individuale,
- Kriteret e Bankës për të vlerësuar nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në riskun kreditor dhe kështu lejimet për asetet financiare duhet të maten në bazë të LTECL dhe vlerësimit cilësor,
- Segmentimi i asetëve financiare kur humbjet e tyre kreditore vlerësohen në baza kolektive,
- Zhvillimi i modeleve të humbjeve të pritshme kreditore, duke përfshirë formulat e ndryshme dhe zgjedhjen e inputeve,
- Përcaktimi i ndërlidhjeve ndërmjet skenarëve makroekonomikë dhe inputeve ekonomike, siç janë nivelet e papunësisë dhe vlerat e kolateralit, dhe efekti në probabilitetin e vonesave, EAD-të dhe LGD-të,
- Përzgjedhja e skenarëve makroekonomikë parashikues dhe peshave të tyre të probabilitetit, për të nxjerrë inputet ekonomike në modelet e humbjeve të pritshme kreditore.

Më poshtë janë klasifikimet e brendshme të vlerësimit kreditor të bankës, të përdorura për qëllime të brendshme dhe të dhënat krahasuese përkatëse:

Shkalla e vlerësimit të brendshëm	Përshkrimi i vlerësimit të brendshëm	Periudha 12 mujore Basel II PD		Vlerësimi i S&P		
		Lower PD bound	Upper PD bound			
1A	shkëlqyeshëm	>0.0000%	≤0.0026%	AAA		
1B		>0.0026%	≤0.0088%	AA+		
1C		>0.0088%	≤0.0300%	AA, AA-		
2A	shumë mirë	>0.0300%	≤0.0408%	A+, A, A-		
2B		>0.0408%	≤0.0553%			
2C		>0.0553%	≤0.0751%			
3A		>0.0751%	≤0.1019%			
3B		>0.1019%	≤0.1383%			
3C		>0.1383%	≤0.1878%			
4A	mirë	>0.1878%	≤0.2548%	BBB+, BBB		
4B		>0.2548%	≤0.3459%			
4C		>0.3459%	≤0.4694%			
5A		>0.4694%	≤0.6371%			
5B		>0.6371%	≤0.8646%			
5C		>0.8646%	≤1.1735%			
6A		majftueshëm	>1.1735%		≤1.5927%	BB-
6B	>1.5927%		≤2.1616%			
6C	>2.1616%		≤2.9338%			
7A	>2.9338%		≤3.9817%			
7B	nënstandard	>3.9817%	≤5.4040%	B+		
7C		>5.4040%	≤7.3344%			
8A		>7.3344%	≤9.9543%			
8B	nënstandard	>9.9543%	≤13.5101%	B-		
8C		>13.5101%	≤18.3360%			
9A		>18.3360%	≤24.8857%			
9B		>24.8857%	≤33.7751%			
9C		>33.7751%	<100%			
10		kredia e zhvlerësuar	100%		100%	CCC+
						CCC
				CCC-		
				CC, C		
				D		

3.3.16 Kategoria e kostos së amortizuar

Banka kërkon që, gjatë njohjes fillestare, asetet financiare dhe detyrimet financiare të maten me vlerën e drejtë plus kostot e pranueshme të transaksionit.

- evidenca më e mirë e vlerës së drejtë në njohjen fillestare është normalisht çmimi i transaksionit – d.m.th vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë për instrumentin financiar, dhe
- nëse ka ndonjë dallim në mes të vlerësimit të vlerës së drejtë të njësisë ekonomike në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit, atëherë,
- nëse vlerësimi i vlerës së drejtë përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme, atëherë diferenca njihet në fitim ose humbje, ose,
- në të gjitha rastet e tjera, diferenca shtyhet si rregullim i vlerës kontabël të instrumentit financiar.

Portofoli kreditor dhe paradhëniet në bankës mbartet me koston e amortizuar dhe të ardhurat nga interesi njihen në fitim dhe humbje duke përdorur normën efektive të interesit.

3.3.17 Vlera e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse FVOCI

Një aset financiar klasifikohet si i matur më pas në FVOCI nëse ai mbahet brenda një modeli biznesi qëllimi i të cilit është mbledhja e rrjedhave monetare kontraktuale dhe shitja e aseteve financiare dhe plotëson kriterin e pagesave vetëm të principalit dhe interesit mbi principalin (SPPI). Vlera e drejtë e instrumenteve financiare përcaktohet në përputhje me SNRF 13.

Kur nuk është e mundur të përcaktohet vlera e drejtë e një instrumenti financiar duke iu referuar çmimeve të tregut (p.sh. për kredi), Banka dueht të përdorë teknika të tjera vlerësimi (modelet dhe metodologjitë e çmimeve). Përderisa ato kërkojnë më shumë vlerësime dhe supozime, ato janë domosdoshmërisht më subjektive sesa qasja e çmimit të tregut. Dy teknika vlerësimi që përdoren gjerësisht janë qasja e zbritjes (skontimit) të rrjedhës së parasë së gatshme (vlera aktuale) dhe modelet e çmimeve të opsioneve (p.sh. Modeli Black dhe Scholes). Të arkëtueshmet afatshkurtra dhe të pagueshmet pa normë interesi të deklaruar mund të maten me shumën origjinale të faturës nëse efekti i skontimit është i parëndësishëm.

3.3.18 Vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes FVTPL

Të gjitha asetet e tjera financiare – p.sh. asetet financiare që nuk përmbushin kriteret për klasifikim siç maten më pas me koston e amortizuar ose FVOCI - klasifikohen si të matura më pas me vlerën e drejtë, me ndryshimet në vlerën e drejtë të njohura në fitim ose humbje.

Për më tepër, Banka ka mundësinë që në njohjen fillestare të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një aset financiar si në FVTPL nëse veprimi i tillë eliminon ose zvogëlon ndjeshëm një mospërputhje të matjes ose njohjes – d.m.th një “mospërputhje kontabël” që do të lindte nga matja e aseteve ose detyrimeve, ose duke njohur fitimet dhe humbjet në to, në baza të ndryshme.

Në njohjen fillestare, asetet financiare të klasifikuara si në vlerë të drejtë do të maten me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e asetit financiar. Pas njohjes fillestare, asetet financiare të klasifikuara si në vlerë të drejtë do të maten me vlerën e drejtë dhe kostot e transaksionit njihen në fitim dhe humbje.

Për instrumentet e borxhit, të gjitha fitimet ose humbjet që vijnë nga ndryshimet në vlerën e drejtë të këtyre aseteve financiare njihen në fitim ose humbje në të njëjtën mënyrë si për asetet financiare të matura me koston e amortizuar:

- të ardhurat nga interesi duke përdorur metodën e interesit efektive,
- humbjet e pritshme kreditore dhe kthimet; dhe
- fitimet dhe humbjet në valutë që rrjedhin nga rivlerësimi i shumës së kostos së amortizuar.

3.3.19 Instrumentet financiare derivative

Instrumentet derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë në datën në të cilën lidhet kontrata derivative dhe më pas maten me vlerën e tyre të drejtë. Vlerat e drejta merren nga çmimet e kuotuar të tregut në tregjet aktive, duke përfshirë transaksionet e fundit të tregut dhe teknikat e vlerësimit, duke përfshirë modelet e flukseve monetare të skontuara, sipas rastiit. Të gjithë instrumentet derivative barten si asete kur vlera e drejtë është pozitive dhe si detyrime kur vlera e drejtë është negative. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve derivateve përfshihen në Të ardhurat neto nga instrumentet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes' në fitimin ose humbjen e periudhës. Banka përdor instrumente financiare derivative të tilla si kundër këmbime të normave të interesit që blihen jashtë bursave (OTC) për të menaxhuar riskun që del nga luhatjet e normave të interesit të tregut. Për instrumentet derivative nuk zbatohet kontabiliteti mbrojtës.

3.3.20 Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj dhe rezervat e detyrueshme

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përfshijnë fletënotat dhe paranë në dorë (duke përfshirë rezervat e kufizuara - shih më poshtë), bilancet e pakufizuara të mbajtura me bankat qendrore dhe asetet financiare shumë likuide me maturitet origjinal prej tre muajsh ose më pak nga data e blerjes që janë subjekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga Banka në menaxhimin e zotimeve afatshkurtra të saj. Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

3.4 Gjykime, vlerësime dhe supozime të rëndësishme kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare të Bankës kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumën e raportuar të të ardhurave, shpenzimeve, asetëve dhe detyrimeve, si dhe dhënien e informacioneve shpjeguese shoqëruese, si dhe shpalosjen e detyrimeve kontingjente. Pasiguria në lidhje me këto supozime dhe vlerësime mund të rezultojë në rezultate që kërkojnë një rregullim material të vlerës kontabël të asetëve ose detyrimeve të prekura në periudhat e ardhshme. Në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Bankës, menaxhmenti ka bërë gjykimet dhe supozimet e mëposhtme në lidhje me të ardhmen dhe burimet e tjera kryesore të pasigurisë të vlerësimit në datën e raportimit, të cilat kanë një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një rregullim material në vlerën kontabël të asetëve dhe detyrimit brenda vitit të ardhshëm financiar.

Rrethanat ekzistuese dhe supozimet rreth zhvillimeve të ardhshme mund të ndryshojnë për shkak të rrethanave përtej kontrollit të Bankës dhe pasqyrohen në supozime nëse dhe kur ato ndodhin. Zërat me efektin më të rëndësishëm në shumën e njohura në pasqyrat financiare të veçanta me gjykim substancial të menaxhmentit dhe/ose vlerësime janë grupuar më poshtë në lidhje me gjykimet/vlerësimet e përfshira. Si rezultat i pandemisë COVID-19, e cila preku ekonominë dhe tregjet financiare, Menaxhmenti i Bankës zhvilloi një vlerësim shtesë të përshtatshmërisë së politikave kontabël, vlerësimeve dhe supozimeve të përdorura gjatë vitit 2020 dhe ndikimin e tyre në zhvlerësimin e mundshëm të asetëve dhe pozicionit financiar, rrjedhat e mëtejshme të parasë dhe rezultatit e operacioneve të Bankës. Vlerësimet e kryera nuk tregojnë ekzistencën e një ndikimi materialisht të rëndësishëm në përshtatshmërinë e politikave kontabël, vlerësimeve dhe supozimeve, as ekzistencën e treguesve për zhvlerësimin e asetëve të Bankës.

Gjykimet e rëndësishme kontabël përshkruhen në shënimet e mëposhtme:

- 3.3.12 Zhvlerësimi i asetëve financiare,
- 3.3.16 Humbjet nga zhvlerësimi i asetëve financiare,
- 3.3.17 Kostoja e amortizuar dhe kategoria,
- 3.3.18 Kategoria FVOCI,
- 3.3.19 Kategoria FVTPL,
- 3.8 Pronat e riposeduara.

3.5 Rezervat e detyrueshme të likuiditetit

Në përputhje me rregullat e BQK-së, Banka duhet të përmbushë kërkesën e likuiditetit mesatar minimal. Kërkesa për likuiditet llogaritet në bazë javore si 10 për qind e bazës së depozitave, e përcaktuar si mesatare e përgjithshme e detyrimeve të depozitave ndaj publikut jo-bankar në Euro dhe valuta të tjera, gjatë ditëve të punës të periudhës së mirëmbajtjes. Asetet me të cilat Banka mund të përmbushë kërkesat e saj për likuiditet janë depozitat në euro në BQK dhe 50 për qind të ekuivalentit në Euro në valuta lehtësisht të konverueshme. Depozitat në BQK nuk duhet të jenë më pak se 5 për qind e bazës së zbatueshme të depozitave. Përderisa asetet përkatëse likuide nuk janë në dispozicion për të financuar aktivitetet e përditshme të Bankës, ato janë përjashtuar nga paraja dhe ekuivalentët e saj për qëllimet e pasqyrës së rrjedhës së parasë.

3.6 Prona dhe pajisjet

3.6.1 Prona dhe pajisjet në pronësi

Prona dhe pajisjet paraqiten me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin e akumuluar, nëse ka.

Kostot vijuese përfshihen në vlerën bartëse të asetit ose njihen si asete të veçanta, sipas rastit, vetëm kur është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me këtë zë do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera i ngarkohen shpenzimeve të tjera operative gjatë periudhës financiare në të cilën ato ndodhin.

Vlerat bartëse të pronës dhe pajisjeve rishikohen për zhvlerësim kur ngjarjet ndryshojnë ose ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera bartëse mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ka indikacione të tilla dhe ku vlerat bartëse tejkalojnë shumën e parashkuar të rikuperueshme, asetet ose njësitë krijuese të parasë (NKPI) shlyhen deri në vlerën e tyre të rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e pronës dhe pajisjeve është vlera e drejtë minus kostot e shitjes dhe vlera në përdorim, cilado që është më e lartë. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhat e ardhshme të parasë zbriten në vlerën e tyre aktuale

duke përdorur një normë zbritjeje para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut të vlerës kohore të parasë dhe reziqeve specifike për ato asete.

Për një aset që nuk gjeneron rrjedha të parave kryesisht të pavarura, shumta e rikuperueshme përcaktohet për njësitë krijuese të parave (NKP) të cilave i përket asetit.

Humbjet nga zhvlerësimi (rënia në vlerë) njihen në fitim ose humbje.

Zhvlerësimi i aseteve ngarkohet në bazë të metodës lineare në normat e përcaktuara për të alokuar koston e pronës dhe pajisjeve mbi jetëgjatësinë e tyre të përdorimit. Normat vjetore të amortizimit përcaktohen nga jeta e dobishme e vlerësuar e aseteve të caktuara sipas tabelës më poshtë:

Përmirësimet e pronës me qira zhvlerësohen përgjatë jetëgjatësisë së tyre të përdorimit ose afatit të qirasë, cilado që është më e shkurtë. Puna në proces nuk zhvlerësohet derisa asetet të vihet në përdorim.

ATM, pajisje të tjera të bankës dhe për zyre	5-10 vjet
Hardueri kompjuterik	3-5 vjet
Ndërtesat e përdorura për qëllime vetanake	50 vjet

Metodat e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlerat e mbetura rishikohen në çdo datë raportimi.

3.6.2 Prona dhe pajisjet me qira

SNRF 16 i zbatueshëm për periudhat e raportimit pas datës 01 janar 2019 specifikon se si një entitet raportues i SNRF-ve do të njohë, matë, paraqesë dhe shpalosë qiratë. Standardi siguron një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit, duke kërkuar nga qiramarrësit t'i njohin asetet dhe detyrimet për të gjitha qiradhëniet, përveç qirave afatshkurtra dhe qirave me vlerë të ulët. Banka ka aplikuar SNRF 16 duke përdorur qasjen e modifikuar retrospektive dhe për rrjedhojë, informacioni krahasues nuk është përshtatur dhe vazhdon të raportohet sipas SNK 17 dhe KIRFN 4. Në këtë datë, Banka ka zgjedhur gjithashtu të matë asetet e së drejtës së përdorimit në një shumë të barabartë me detyrimin e qirasë të rregulluar për çdo pagesë të parapaguar ose të llogaritur të qirasë që ka ekzistuar në datën e tranzicionit.

Detajet e politikave kotabël sipas SNK 17 dhe KIRFN 4 janë shpalosur veçmas nëse ato janë të ndryshme nga ato nën SNRF 16.

Banka njih një aset të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim të qirasë në datën e fillimit të qirasë. Aseti i të drejtë së përdorimit fillimisht matet me koston, e cila përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë të rregulluar për çdo pagesë të qirasë të bërë në ose para datës së fillimit, plus çdo kosto fillestare direkte të kryer dhe një vlerësim të kostove për çmontimin dhe heqjen e asetit themelor ose për të rivendosur asetin themelor ose lokacionin në të cilën është vendosur, minus çdo stimul i marrë i qirasë.

Aseti i së drejtës së përdorimit zhvlerësohet më pas duke përdorur metodën lineare nga data e fillimit deri në fundin e jetëgjatësisë së dobishme të asetit të së drejtës së përdorimit ose përfundimit të afatit të qirasë, cilado që është më herët. Jetëgjatësia e aseteve të së drejtës së përdorimit përcaktohet në të njëjtën bazë sikurse ato të pronës dhe pajisjeve. Për më tepër, asetet e së drejtës së përdorimit zbriten në mënyrë periodike nga humbjet e zhvlerësimit, nëse ka, dhe rregullohen për rivlerësime të caktuara të detyrimeve të qirasë.

Detyrimi i qirasë fillimisht matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat nuk paguhën në datën e fillimit të kontratës, me zbritje duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, atëherë normën rritëse të huamarrjes së Bankës. Në përgjithësi, Banka përdor normën e saj rritëse të huamarrjes si normë zbritjeje.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimeve të qirasë përfshijnë si në vijim:

- pagesat fikse, përfshirë pagesat fikse në substancë,
- pagesat e ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose një normë, e matur fillimisht duke përdorur indeksin ose normën në datën e fillimit,
- shumtat që pritet të paguhën nën një garanci të vlerës së mbetur, dhe
- çmimin e ushtrimit sipas një opsioni blerjeje që Banka është e sigurt se do ta ushtrojë, pagesat e qirasë me periudhë opsionale rinovimi nëse Banka është e sigurt se do ta ushtrojë mundësinë e zgjatjes, dhe ndëshkimet për përfundim të parakohshëm të një qiraje, përveç nëse Banka është e sigurt se nuk do të bëjë përfundim të parakohshëm.

Detyrimi i qirasë matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Ai rivlerësohet kur ka një ndryshim në pagesat e qirasë në të ardhmen që vijnë nga ndonjë ndryshim në një indeks ose normë, nëse ka ndonjë

ndryshim në vlerësimin e Bankës lidhur me shumën që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur, ose nëse Banka ndryshon vlerësimin e saj nëse do të ushtrojë një mundësi blerjeje, zgjatjeje ose përfundimi. Kur detyrimi i qirasë është rivlerësuar në këtë mënyrë, bëhet një rregullim përkatës në vlerën kontabël të asetit të së drejtës së përdorimit, ose regjistrohet në fitim ose humbje nëse vlera kontabël e asetit të së drejtës së përdorimit është zvogëluar në zero.

Banka paraqet asetet e së drejtës së përdorimit që nuk përbushin përkufizimin e pronës së investimit në "prona, impiantet dhe pajisjet" dhe detyrimet e qirasë në "detyrimet tjera" në pasqyrën e pozicionit financiar (shënimi 17). Me kalimin në SNRF 16, norma mesatare e ponderuar inkrementale e huamarrjes e aplikuar për detyrimet e qirasë të njohura sipas SNRF 16 ishte 5 për qind. Banka përdor një ose më shumë nga mekanizmat praktik të mëposhtëm sipas SNRF 16.C10, duke e aplikuar atë mbi bazën e secilës qira veç e veç:

- Përdorimi i një norme të vetme zbritjeje në një portofol të qirave me karakteristika të ngjashme,
- Rregullimi i asetit të së drejtës së përdorimit për çdo provizion të njohur të qirasë, në vend të kryerjes së rishikimit të zhvlerësimit,
- Aplikimi i një përjashtimi nga njohja për qira për të cilat afati i qirasë mbaron brenda 12 muajve nga data e aplikimit fillestar dhe qiratë e pasurive me vlerë të ulët (për këtë qëllim, banka ka zgjedhur një prag prej rreth 5 mijë euro). Banka njeh pagesat e qirasë që lidhen me këto qira si një shpenzim në bazë lineare për periudhën e qirasë,
- Përjashtimi i kostove fillestare direkte nga matja e asetit të së drejtës së përdorimit,
- Përdorimi i supozimit nga përvoja, siç është përcaktimi i afatit të qirasë nëse kontrata përmban mundësi për zgjatjen ose përfundimin e qirasë.

Në fazën fillestare të lidhjes së një kontrate, Banka vlerëson nëse kontrata është kontratë qiraje, ose përmban një qira. Një kontratë është kontratë qiraje, ose përmban qira në të nëse po ajo kontratë jep të drejtën e kontrollit mbi përdorimin e një aseti të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të një shume. Për të vlerësuar nëse një kontratë jep të drejtën e kontrollit mbi përdorimin e një aseti të identifikuar, Banka vlerëson nëse:

- kontrata përfshin përdorimin e një aseti të identifikuar - kjo mund të specifikohet në mënyrë të eksplicite ose implicite (të qartë ose të nënkuptuar), dhe duhet të jetë i dallueshëm fizikisht ose të përfaqësojë kryesisht të gjithë kapacitetin e një aseti fizikisht të dallueshëm. Nëse furnizuesi ka të drejtë substanciale të zëvendësimit, atëherë aseti nuk identifikohet fare,
- banka ka të drejtë të marrë në mënyrë substanciale të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i asetit gjatë gjithë periudhës së përdorimit, dhe
- banka ka të drejtë të udhëheqë përdorimin e asetit. Banka gëzon këtë të drejtë nëse i takojnë edhe të drejtat për vendimmarrje, të cilat janë më të rëndësishmet për të ndryshuar se si dhe për çfarë qëllimi përdoret aseti. Në raste të rralla kur vendimi se si dhe për çfarë qëllimi përdoret aseti është i paracaktuar, atëherë banka ka të drejtë të udhëheqë përdorimin e asetit nëse:
- banka ka të drejtë të punojë me asetin; ose
- banka e projekttoi asetin në një mënyrë që paracakton se si dhe për çfarë qëllimi do të përdoret aseti.

Kjo politikë zbatohet për kontratat e lidhura ose të ndryshuara më datë 1 janar 2019, ose pas kësaj date. Në fazën fillestare të lidhjes ose gjatë rivlerësimit të një kontrate që përmban komponente të qirasë, Banka ndan shumën në kontratë për secilin komponentë të qirasë në bazë të çmimeve të tyre relative të pavarura. Sidoqoftë, për qiradhëniet e tokës dhe ndërtesave në të cilat është qiramarrëse, Banka ka zgjedhur që të mos i veçojë komponentët jo-qira dhe t'i konsiderojë komponentët qira dhe jo-qira si komponentë të vetëm të qirasë.

3.7 Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme njihen nëse parashihet se përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen pasurisë do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e pasurisë mund të matet me besueshmëri. Pasuritë e paprekshme fillimisht maten me kosto. Vlerat bartëse të pasurive të paprekshme rishikohen për rënie në vlerë, kur ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera bartëse mund të mos jetë e rikuperueshme/realizueshme. Pasuritë e paprekshme përbëhen tërësisht nga programe kompjuterike që amortizohen duke përdorur metodën lineare gjatë jetëgjatësisë së tyre të vlerësuar prej pesë vjet dhe licencave që amortizohen gjatë afatit të licencës.

3.8 Prona e rimarrë në posedim

Pasuritë e riposeduara sigurohen nëpërmjet ekzekutimit të sigurisë mbi huatë dhe paradhëniet joperformuese, nga klientët që nuk fitojnë të ardhura qiraje dhe nuk përdoren nga Banka dhe janë të destinuara për shitje në një periudhë të shkurtër kohe.

Pasuritë e riposeduara fillimisht njihen duke përdorur vlerën e caktuar nga përmbartuesi në ankandin e fundit dhe më pas maten me vlerën e kostos ose vlerës neto të realizueshme, cilado që është më e ulët dhe çdo zhvlerësim njihet ne fitim ose humbje.

3.9 Depozitat, huazimet dhe detyrimet e varura

Depozitat, huazimet dhe detyrimet e varura janë pjesë e burimeve të financimit të borxhit të Bankës. Depozitat, huazimet dhe detyrimet e varura njihen fillimisht me vlerën e drejtë, minus kostot e transaksioneve të shkaktuara. Më pas deklarohen me koston e amortizuar; çdo diferencë ndërmjet të ardhurave, minus kostot e transaksionit dhe vlerës së kthimit njihen në fitim ose humbje gjatë periudhës duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.10 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarje të mëparshme, Banka ka një detyrim të tanishëm ligjor ose të krijuar që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që do të duhen të harxhohen mjete monetare për të mbuluar detyrimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të pritshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parasë dhe risqet specifike ndaj detyrimit. Korrigjimi i skontimit njihet si kosto financiare.

Detyrimet kontingjente mund të zhvillohen në një mënyrë që nuk është pritur fillimisht. Prandaj ato vlerësohen vazhdimisht për të përcaktuar nëse dalja e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është bërë e mundshme. Në rast se detyrimi kontingjent rezulton në një detyrim aktual që mund të matet me besueshmëri, duhet të regjistrohet në bilanc provizioni për shumën. Vetëm zotimet e pakthyeshme shkaktojnë risk kreditor, pra vetëm kontigjencat dhe zotimet e pakthyeshme mund të jenë objekt i provizionimit. Për ekspozimet e mëdha, vlerësimi bëhet në mënyrë individuale. Në rast të vlerësimit të bazuar në portfolio, ndërtimi i portfolios dhe llogaritja e provizioneve të bazuara në portfolio llogariten siç tregohet në rënien në vlerë të kredive dhe paradhënieve.

3.11 Përfitimet e punonjësve

Banka paguan vetëm kontributet për planin pensional të administruar publikisht në baza të detyrueshme. Banka nuk ka detyrime tjera për pagesa pasi të jenë paguar kontributet. Kontributet njihet si shpenzim i përfitimeve të punonjësve në kohën kur ato duhet të paguhen.

3.12 Kapitali aksionar

Dividendët në aksionet e zakonshme

Dividendët në aksionet e zakonshme njihen në ekuitet në periudhën në të cilën janë aprovuar nga aksionarët e bankës. Dividendët për vitin që janë deklaruar pas datës së raportimit shpalosen si ngjarje pas fundit të periudhës së raportimit.

3.13 Rezervat e ekuitetit

Rezervat e ekuitetit përbëhen nga rezervat e vlerës së drejtë dhe fitimet e mbajtura.

Rezervat e regjistruara në ekuitet (OCI) në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës përfshijnë:

- Rezerva e vlerës së drejtë përfshin ndryshimet në vlerën e drejtë të pasurive financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Fitimet e mbajtura përfshijnë fitimet kumulative jo të shpërndara dhe shpërndahen me miratimin e Aksionarit të Përgjithshëm të Bankës dhe miratimin rregullator të Bankës Qendrore.

3.14 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi

Sipas SNRF 9 dhe SNA 39 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi për të gjitha instrumentet financiare me interes njihen nëpërmjet fitimit ose humbjes për periudhën brenda "të ardhurave nga interesi" dhe "shpenzimeve të interesit" duke përdorur metodën e interesit efektiv. Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së kostos së amortizuar të një pasurie financiare ose një detyrimi financiar dhe e shpërndarjes së të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma që zbrit saktësisht pagesat e ardhshme në para ose arkëtimet përgjatë jetëgjatësisë së pritur të instrumentit financiar ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër për vlerën bartëse neto të pasurisë financiare ose detyrimit financiar. Gjatë llogaritjes së normës së interesit efektiv, Banka vlerëson rrjedhat e parasë duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por nuk merr parasysh humbjet e ardhshme kreditore.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin kostot e transaksionit dhe tarifat dhe pagesat e paguara ose të pranuar që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve përfshijnë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e një pasurie financiare ose detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi i paraqitur në fitim apo humbje përfshijnë:

- interesin në pasuritë financiare dhe detyrimet financiare të matur në kosto të amortizuar të llogaritur në bazë të interesit efektiv, dhe
- interesin në letrat me vlerë të investimeve të matura me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes (FVPL) të llogaritur në bazë të interesit efektiv.

Kur një pasuri financiare bëhet e kreditit të zhvlerësuar (e rënë në vlerë) dhe për këtë arsye konsiderohet si 'Faza 3', Banka llogarit të ardhurat nga interesi duke zbatuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar neto të pasurisë financiare. Nëse mjetet financiare trajtohen dhe nuk janë më të kreditit të zhvlerësuar, Banka kthehet në llogaritjen e të ardhurave nga interesi në baza bruto.

Për pasuritë financiare të blera ose të origjinuara të kreditit të zhvlerësuar (POCI) Banka llogarit të ardhurat nga interesi duke llogaritur normën efektive të interesit të kreditit të rregulluar dhe duke aplikuar atë normë në koston e amortizuar të pasurisë. NEI e kreditit të rregulluar është norma e interesit që, në njohjen fillestare, zvogëlon rrjedhën monetare të ardhshme të vlerësuar (duke përfshirë humbjet kreditore) në koston e amortizuar të pasurive të POCI. Banka mban gjithashtu investime në pasuritë e emetuara në vende me norma interesi negative. Banka shpalosë interesin e paguar për këto pasuri si një shpenzim interesi, me shpalosje shtesë në Shënimin 21.

Të ardhurat nga interesi në të gjitha pasuritë tregtuese dhe pasuritë financiare të detyrueshme për t'u matur me FVPL, njihen duke përdorur normën e interesit kontraktual në të ardhurat neto të tregtueshme dhe fitimet / (humbjet) neto të pasurive financiare me vlerë të drejtë në fitim ose humbje.

3.15 Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për një pasuri ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

Të ardhurat tjera nga tarifat dhe komisionet - duke përfshirë tarifat e shërbimeve të llogarisë, komisionet e shitjeve, tarifat e plasmanëve - njihen kur shërbimet përkatëse të kryhen. Në qoftë se një zotim për kredi nuk pritet të ketë si rezultat tërheqjen e një kredie, atëherë tarifat përkatëse të zotimit kreditor njihen në bazë lineare përgjatë periudhës së zotimit.

Shpenzimet të tjera për komisionet dhe tarifat lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që pranohen shërbimet.

3.16 Qiratë operative

Pagesat e bëra për qira operative ngarkohen në shpenzime në bazë të metodës lineare gjatë jetëgjatësisë së qirasë. Kur një qira operative përfundon para kohës së përfundimit të qirasë, pagesat që kërkohet të bëhen për qiradhënesin si dënim njihen si shpenzim në periudhën në të cilën ndodh ndërprerja.

3.17 Të ardhurat neto nga instrumentet tjera financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit apo humbjes

Të ardhurat neto nga instrumentet tjera financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit apo humbjes ndërlidhen me instrumentet derivative jo të tregtueshëm mbajtur për qëllime të menaxhimit të riskut që nuk përbëjnë pjesë të raporteve kualifikuese mbrojtëse të pasurive dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në vlerë të drejtë përmes fitimit apo humbjes. Përfshinë të gjitha ndryshimet e realizuara dhe paralelizuar të vlerës së drejtë, interesin, dividendat dhe ndryshimet në këmbimin valutator.

3.18 Tatimi në të ardhura

Tatimi në të ardhura përfshinë tatimin aktual dhe të shtyrë. Ai njihet në fitim ose humbje me përjashtim të pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në ekuitet ose në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual

Tatimi aktual përfshinë tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet mbi fitimin e tatueshëm ose humbjen e vitit dhe korigjimet e tatimit të pagueshëm ose të arkëtueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Ai matet duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës bartëse të pasurive dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me norma të tatimit që priret të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të kthehen prapa, në bazë të ligjeve që janë miratuar ose substantivisht janë miratuar në datën e raportimit.

Një pasuri tatimore e shtyrë njihet vetëm në masën që është e verifikueshme që fitimet e ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion kundrejt të cilave mund të shfrytëzohen diferencat e përkohshme të zbritshme. Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Pasuritë tatimore të shtyra dhe detyrimet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë të raportimit dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundur që respektivisht përfitimi tatimor dhe detyrimi tatimor përkatës të realizohen.

Tatimet shtesë mbi të ardhurat që rrjedhin nga shpërndarja e dividendëve njihen në të njëjtën kohë kur njihet detyrimi për të paguar dividendin përkatës.

4 Menaxhimi i riskut financiar

4.1 Përmbledhje

Banka është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga shfrytëzimi i instrumenteve financiare:

- risku kreditor
- risku i likuiditetit
- risku i tregut
- risku operativ

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit nga risqet më lartë, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset për matjen dhe menaxhimin e riskut, dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

Korniza e menaxhimit të riskut

Kontrollet e brendshme dhe mjete tjera të kontrollit të riskut të vendosura nga menaxhimi i riskut i Raiffeisen International mundësojnë menaxhimin e kontrolluar të riskut të Bankës. Mjetet kryesore të menaxhimit të riskut janë miratuar nga Raiffeisen International dhe zbatohen për përdorim nga Banka.

Nga janari 2008, Banka ka vepruar në përputhje dhe ka raportuar në bazë të kërkesave të Basel II në nivelin e Grupit që mbulon riskun kreditor dhe të tregut. Zbatimi i kërkesave të Basel II duhet të sigurojë një menaxhim më të mirë të kapitalit.

Mjedisi i thjeshtë financiar dhe i tregut në Kosovë lejon përdorimin e metodës së analizës të thjeshtë. Faktorët e ardhshëm më kompleks dhe risqet në industrinë bankare do të përkrahen nga zhvillimi i metodave të reja për t'i menaxhuar më mirë ato.

Në bazë të politikave të Bankës, totali i pasurive të Bankës klasifikohet dhe analizohet si më poshtë:

- Analiza e pasurive bazuar në klasën e pasurisë/produktit (pasuritë klasifikohen në bazë të katalogut të produkteve të Grupit),
- Analiza e pasurive bazuar në cilësinë kreditore (pasuritë klasifikohen në bazë të direktivave të Grupit),
- Analiza e pasurive në përputhje me bazën e matjes,
- Analiza e pasurive bazuar në vjetërsi, që do të thotë analiza e kryer për pasuritë që janë në vonesë por jo të rëna në vlerë,
- Analiza individuale e pasurive të përcaktuara si të rëna në vlerë nga faktorë të rënies në vlerë,
- Analiza e pasurive bazuar në llojin e kolateralit dhe duke marrë parasysh shumën që vlerësohet se do të rikuperohet,
- Analiza e pasurive bazuar në përqendrimin e risqeve sipas industrisë/ sektorit/ segmentit /shumës së caktuar të ekspozimit.

4.2 Risku kreditor

Risku kreditor është risku i humbjes financiare për Bankën nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale, dhe shfaqet kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet e bankës për klientët dhe bankat

e tjera dhe investimet në letrat me vlerë. Për qëllime të raportimit të menaxhimit të riskut, Banka i merr në konsiderim të gjitha elementet e ekspozimit ndaj riskut kreditor (si risku i mos përmbushjes së të obliguarit individual, risku i vendit dhe sektorit).

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj riskut kreditor që është risku që pala tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë shumat e plota në kohën e duhur. Banka i strukturon nivelet e riskut kreditor që i merr përsipër duke vendosur limite në sasinë e riskut të pranuar në lidhje me një huamarrës dhe segment gjeografik apo industrial. Risqet e tilla monitorohen rregullisht dhe i nënshtrohen rishikimit mujor ose më të shpeshtë. Limitet në nivelin e riskut kreditor nga huamarrësi aprovohen nga Menaxhmenti.

Ekspozimi ndaj riskut kreditor menaxhohet përmes analizës së rregullt të aftësisë së huamarrësit dhe huamarrësve potencialë për të përmbushur detyrimet e pagesës së interesit dhe principalit dhe duke ndryshuar këto limite kreditimi, kur është e përshtatshme. Ekspozimi ndaj riskut kreditor menaxhohet, pjesërisht, me marrjen e kolateralit dhe garancive të korporatave dhe atyre personale.

Ekspozimi maksimal i Bankës ndaj riskut kreditor pasqyrohet kryesisht në vlerat kontabël të pasurive financiare në pasqyrën e pozicionit financiar. Ndikimi i kompensimit reciprok të mundshëm të pasurive dhe detyrimeve për të zvogëluar ekspozimin e mundshëm kreditor nuk është i rëndësishëm.

Risku kreditor për instrumentet financiare jashtë bilancore përcaktohet si mundësia e mbajtjes së humbjes si rezultat i asaj që një palë tjetër ndaj një instrumenti financiar nuk arrin të veprojë në përputhje me kushtet e kontratës. Banka përdor politikën e njëjta kreditore kur bën detyrimet e kushtëzuara ashtu siç bën për instrumentet financiare të bilancit nëpërmjet aprovimit të kredive të përcaktuara, limiteve të kontrollit të riskut dhe procedurave të monitorimit.

Banka mban lloje të ndryshme të kolateralit si siguri për riskun kreditor. Përveç kësaj, zbatohen metoda të tjera për përmirësimin kreditor. Llojet kryesore të kolateralit janë të cekura më poshtë:

- Prona (toka, ndërtesat)
- Apartamentet
- Automjetet
- Pajisjet
- Garancione personale

Vlera e kolateralit llogaritet në bazë të metodave të caktuara të cilat përfshijnë formula të standardizuara të llogaritjes së bazuar në vlerat e tregut, skontime të paracaktuara, si dhe vlerësimet e ekspertëve.

Vlerësimi dhe rivlerësimi i hipotekës është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e specialisteve të bankës, për të gjitha llojet e hipotekave. Vlerësimi i pasurive të patundshme përditësohet një herë në vit. Ky rivlerësim vjetor realizohet nga specialistët e brendshëm të kolateralit. Nëse përditësimi i rivlerësimit nuk bëhet çdo 18 muaj, atëherë vlera e hipotekës zbritet 10 për qind për secilin vit që nuk përmban rivlerësim kolateral. Monitorim më i shpeshtë është i nevojshëm, kur tregu i pasurive të patundshme është subjekt i ndryshimeve të rëndësishme në rrethana.

Kreditë e rëna në vlerë dhe letrat me vlerë

Kreditë e rëna në vlerë dhe letrat me vlerë janë kredi dhe letra me vlerë për të cilat Banka konstaton se është e mundshme që nuk do të jetë në gjendje të inkasojë tërë kapitalin dhe interesin e duhur sipas kushteve kontraktuale të marrëveshjes së kredisë/të letrave me vlerë.

Kreditë me kushte të ristrukturuara

Kreditë me kushte të ristrukturuara janë kredi të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit dhe ku banka ka bërë lëshime të cilat nuk do ti konsideronte përndryshe. Pasi kredia është ristrukturuar mbetet në të njëjtën kategori deri sa të arrihet një performancë e kënaqshme. Performanca e kënaqshme definohet si tri pagesa të njëpasnjëshme të kryeqjës dhe/ose interesit kontraktual.

Vlerësimi i humbjes së pritshme kreditore – ECL

Banka vendos një lejim për humbjet nga rënia në vlerë që përfaqëson vlerësimin e humbjeve që do të ndodhin në portfolion e saj kreditore.

Politika e shlyerjes

Pasuritë financiare shlyhen pjesërisht ose tërësisht vetëm kur Banka ka ndaluar ndjekjen e rikuperimit. Nëse shuma që duhet të shlyhet është më e madhe se lejimi për humbjen e akumuluar, diferenca fillimisht trajtohet si shtesë e shumës që zbatohet më pas ndaj vlerës kontabël bruto. Çdo rikthim i mëvonshëm kreditohet në shpenzimet e humbjes kreditore.

Përmbledhje e kredive të riprogramuara/modifikuara

Tabelat në vijim paraqesin një përmbledhje të pasurive të modifikuara të Bankës më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019.

31 Dhjetor 2020	Vlera bartëse bruto	Stage 2			Stage 3			Raporti i kredive të modifikuara
		Modifikime të përleshme për T&Cs për shkak të COVID 19	Modifikime të përleshme për T & Cs	Gjithsej kreditë joperformuese të riprogramuara	Modifikime të përleshme për T&Cs për shkak të COVID 19	Permanent modifications Modifikime të përleshme për T & Cs	Gjithsej kreditë joperformuese të riprogramuara	
Detyrimet nga bankat	14,337	-	-	-	-	-	-	0%
Kreditë dhe paradhëniet për klientët								
Klientët korporata	324,994	103,714	3,354	-	3,320	2,195	4,542	1.40%
Klientët individual	408,487	172,086	4,603	3,548	5,537	2,044	2,147	1.39%
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	733,481	275,800	7,957	3,548	8,857	4,239	6,689	1.39%

31 Dhjetor 2019	Vlera bartëse bruto	Faza 2		Faza 3			Raporti i kredive të modifikuara
		Modifikime të përleshme për T & Cs	Gjithsej kreditë joperformuese të riprogramuara	Modifikime të përleshme për T & Cs	Gjithsej kreditë joperformuese të riprogramuara	Gjithsej kreditë e modifikuara	
Detyrimet nga bankat	35,483	-	-	-	-	-	0%
Kreditë dhe paradhëniet për klientët							
Klientët korporata	308,272	7,959	-	3,587	-	-	-
Klientët individual	379,146	5,331	1,549	2,093	1,929	3,477	0.92%
Total loans and advances to customers	687,418	13,290	1,549	5,680	1,929	3,477	0.92%

31 Dhjetor 2020	Shuma bruto e kredive të modifikuara			Humbjet e pritshme të kredive të modifikuara		
	Faza 2	Faza 3	Gjithsej	Faza 2 Kolektive	Faza 3 Kolektive	Total
Detyrimet nga bankat	-	-	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientët						
Klientët korporata	3,214	3,068	6,282	205	-	205
Klientët individual	3,548	2,147	5,695	357	1,944	2,301
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	6,762	5,215	11,977	562	1,944	2,506
31 Dhjetor 2019	Shuma bruto e kredive të modifikuara			Humbjet e pritshme të kredive të modifikuara		
	Faza 2	Faza 3	Gjithsej	Faza 2 Kolektive	Faza 3 Kolektive	Gjithsej
Detyrimet nga bankat	-	-	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientët						
Klientët korporata	-	-	-	-	-	-
Klientët individual	1,549	1,929	3,478	210	1,406	1,616
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	1,549	1,929	3,478	210	1,406	1,616

Tabela e mëposhtme paraqet pezullimin e kësteve të shlyerjes së kredive nga marsi i vitit 2020 deri në qershor të vitit 2020:

Muaji	Mars	Prill	Maj	Qershor
Shuma e përgjithshme e portfolios bruto	703,630	705,371	703,768	706,550
Shuma e përgjithshme e kredive të modifikuara	394,344	427,804	431,933	399,317
Përqindja e kredive të modifikuara	56%	61%	61%	57%

Tabela e mëposhtme paraqet kreditë e ristrukturuara sipas udhëzimit të BQK-së të lëshuar në qershor të vitit 2020:

Muaji	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Shuma totale e Portofolios Bruto	708,911	706,778	717,597	719,949	730,401	733,481
Faza 1 Vendimi i muajit mars	263,462	263,575	251,275	237,462	253,228	249,637
Faza 2- Kreditë e ristrukturuara sipas udhëzimit të qershorit	95,440	97,243	100,471	98,244	95,340	82,170
Përqindja e kredive të modifikuara – Faza 1	37%	37%	35%	33%	35%	34%
Përqindja e kredive të ristrukturuara - Faza 2	13%	14%	14%	14%	13%	11%

Kreditë dhe paradhëniet për klientët

Ekspozimi maksimal ndaj riskut kreditor para përmirësimeve të kolateralit dhe përmirësimeve tjera kreditorë më 31 dhjetor 2020 të asetit financiar sipas sektorit të palës tjetër.

	Ekspozimi ndaj riskut kreditor	
	2020	2019
Banka Qendrore e Kosovës	81,228	60,931
Bankat e tjera	42,154	38,158
Investimet në filiale	2,234	2,234
Sovranët	134,121	107,184
Korporatat Ndërkombëtare	42,789	43,002
Korporatat lokale	324,994	308,271
Klientët lokalë individual (retail)	408,487	379,147
Totali i ekspozimit të asetit financiar ndaj riskut	1,036,007	938,927

Tabelat e mëposhtme shpalosin informacion në lidhje me cilësinë kreditorë të pasurive financiare dhe lejimin për rënie në vlerë/ humbjen e mbajtur nga Banka kundër këtyre pasurive.

	Loans and advances to customers	
	2020	2019
Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë		
Shuma bruto	733,481	687,418
Lejimi për rënie në vlerë	(23,966)	(17,920)
Vlera bartëse neto	709,515	669,498
Kredi me kushte të rinegociuara		
Vlera bartëse bruto	12,054	19,109
Lejimi për rënie në vlerë	(3,795)	(4,971)
Vlera bartëse neto	8,259	14,138

Më poshtë është një analizë e përmirësimeve të kolateralit dhe kredive gjatë viteve:

31 Dhjetor 2020	Kreditë dhe paradhëniet për klientët			Vlera e drejtë e kolateralit		
	Retail	Korporata	Gjithsej	Retail	Korporata	Gjithsej
Pasuri të patundshme komerciale	604	10,375	10,979	447	5,822	6,269
Pasuri të patundshme rezidenciale	47,385	-	47,385	40,693	-	40,693
Pasuri të luajtshme	359,719	314,619	674,338	175,873	294,732	470,605
Të pasiguruar	779	-	779	-	-	-
Gjithsej	408,487	324,994	733,481	217,013	300,554	517,567

31 Dhjetor 2019	Kreditë dhe paradhëniet për klientët			Vlera e drejtë e kolateralit		
	Retail	Korporata	Gjithsej	Retail	Korporata	Gjithsej
Pasuri të patundshme komerciale	767	10,558	11,325	617	5,880	6,497
Pasuri të patundshme rezidenciale	40,739	-	40,739	36,835	-	36,835
Pasuri të luajtshme	336,710	297,714	634,424	205,554	281,330	486,884
Të pasiguruar	930	-	930	-	-	-
Gjithsej	379,146	308,272	687,418	243,006	287,210	530,216

Më poshtë është një analizë e pasurive financiare të matura me koston e amortizuar. Përveç nëse tregohet në mënyrë specifike, për pasuritë financiare, shumat në tabelë përfaqësojnë vlerën bartëse bruto:

	31 Dhjetor 2020				
	Gjithsej vlera bartëse bruto	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Vlera e drejtë e kolateralit
Klientët joretail	324,994	249,807	65,714	9,473	300,554
Klientët retail	408,487	333,249	61,688	13,550	217,013
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	733,481	583,056	127,402	23,023	517,567
	31 Dhjetor 2019				
	Gjithsej vlera bartëse bruto	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Vlera e drejtë e kolateralit
Klientët joretail	308,272	285,466	15,694	7,131	286,699
Klientët retail	379,146	357,908	9,527	11,692	243,518
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	687,418	643,374	25,221	18,823	530,217

Banka monitoron përqendrimit e riskut kreditor sipas sektorëve. Një analizë e përqendrimeve të riskut kreditor më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 për huatë dhe paradhëniet për klientët me vonesa dhe të rëna në vlerë - Faza 3 dhe POCl janë paraqitur në mënyrë poshtë:

	31 dhjetor 2020				
	Të paafatizuara dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Gjithsej
Klientët joretail	3,856	250	875	4,492	9,473
Klientët retail	940	140	1,021	11,449	13,550
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet e zhvlerësuar për klientët	4,796	390	1,896	15,941	23,023
	31 dhjetor 2019				
	Të paafatizuara dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Gjithsej
Klientët joretail	2,472	-	2,416	2,243	7,131
Klientët retail	554	225	1,099	9,814	11,692
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet e zhvlerësuar për klientët	3,026	225	3,515	12,057	18,823

Më poshtë është paraqitur ndryshimi në klasifikimin dhe provizionimin e kredive për shkak të BQK-së, zbatimit të SNRF 9 me efekt prej 01 janar 2020:

31 dhjetor 2019						
	Standarde	Vrojtuese	Nënstandarde	Të dyshimta	Të humbura	Gjithsej
Kreditë dhe paradhëniet bruto për klientët	660,079	4,985	4,264	5,825	11,998	687,151
Zhvlerësimi i kredive	2,963	314	853	2,913	11,998	19,041
Kreditë dhe paradhëniet neto të klientëve	657,116	4,671	3,411	2,912	0	668,110
Rilëshuar më 31 dhjetor 2019						
	Faza 1	Faza 2	Faza 3 dhe POCI	Gjithsej		
Kreditë dhe paradhëniet bruto për klientët	643,507	25,221	18,690	687,418		
Zhvlerësimi i kredive	2,832	1,757	13,331	17,920		
Kreditë dhe paradhëniet neto për klientët	640,675	23,464	5,359	669,498		

Gjithsej ndryshimi në Portofolion Bruto të Kredisë për shkak të zbatimit të SNRF 9 është 267 mijë euro që është për shkak të korigjimit (unëinding) të interesit (nuk njihet si e ardhur bazuar në rregulloret e BQK-së), ndërsa ndryshimi në provizionin e kredive për fundin e vitit 2019 është 1,121 mijë euro. Ndryshimi në adoptimin e SNRF 9 ka pasur një ndikim rregullator në fitimet e mbajtura për fundin e vitit 2020 duke krijuar një llogari rezervë tjetër nga tranzicioni.

Zërat jashtë bilancit

Më poshtë janë paraqitur ndryshimet në klasifikimin dhe provizionimin e zërave jashtë bilancit për shkak të BQK-së, zbatimit të SNRF 9 me efekt prej 01 janar 2020

31 dhjetor 2019						
	Standarde	Vrojtuese	Nënstandarde	Të dyshimta	Të humbura	Gjithsej
Gjithsej ekspozimi jashtë bilancit	96,035	50	8	-	641	96,734
Provizioni për zërat jashtë bilancit	623	1	2	-	641	1,267
Zërat neto jashtë bilancit	95,412	49	6	-	-	95,467
Rilëshuar më 31 dhjetor 2019						
	Faza 1	Faza 2	Faza 3 dhe POCI	Gjithsej		
Gjithsej ekspozimi jashtë bilancit	88,242	7,277	1,215	96,734		
Provizioni për zërat jashtë bilancit	233	12	126	371		
Zërat neto jashtë bilancit	88,009	7,265	1,089	96,363		

Gjithsej ndryshimi në provizionimin e zërave jashtë bilancit për shkak të zbatimit të SNRF9 është 896 mijë euro, një ndryshim i tillë ka ndikuar në rezervat e tjera të përfshira në kapitalin e bankës.

Detyrimet nga bankat

Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër çdo ditë nga menaxhimi i rrezikut dhe Departamenti i Thesarit. Banka kufizon depozitat dhe transaksionet e tjera bankare në banka solide vendore ose ndërkombëtare. Para se të fillohet një marrëdhënie biznesi me një bankë të caktuar, menaxhmenti dhe Departamenti i Riskut kryejnë një analizë të gjendjes financiare të institucionit. Performanca financiare e palëve kontraktuese monitorohet vazhdimisht. Për më tepër, të gjitha bankat korresponduese si dhe emetuesit e bonove në të cilat Banka ka ekspozime investimi monitorohen vazhdimisht për vlerësimet e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit si: Moody's, Standard & Poor's (S&P) dhe Fitch përveç ekspozimeve me bonot e thesarit të Kosovës të cilat nuk janë vlerësuar. Për të përfaqësuar vlerësimet e agjencive të ndryshme ndërkombëtare të vlerësimit, tabelat më poshtë janë përgatitur në përputhje me shkallët e vlerësimit të Bankës Qendrore të Kosovës të paraqitura si më poshtë;

Përkufizimet e vlerësimeve	Moody' ose ekuivalent	
	Shkalla e vlerësimit afatgjatë	Shkalla e vlerësimit afatshkurtër
Cilësi e lartë e kredisë	Aaa Aa1 Aa2 Aa3	P-1
Kapacitet të forte të pagesës	A1 A2 A3	P-2
Kapacitet adekuat të pagesës	Baa1 Baa2 Baa3	P-3

Një funksion i pavarur nga departamenti i thesarit, zakonisht menaxhimi i rrezikut, duhet të monitorojë që ekspozimi ndaj të gjitha bankave nuk i kalon limitet rregullatore ose kufijtë e brendshëm të përcaktuar nga menaxhmenti i Bankës. Në pajtim me rregulloren e re për ekspozimet e mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, bankat nuk duhet të kenë ndonjë ekspozim të përgjithshëm të riskut kreditor ndaj palëve të ndërlidhura që tejkalojnë 15 për qind të kapitalit rregullator të nivelit të parë. Detyrimet nga bankat janë dhënë pa kolateral. Tabela e mëposhme paraqet llogaritë rrjedhëse të Bankës dhe depozitat me afat me bankat korresponduese sipas vlerësimit (klasifikimit) kreditor, të cilat janë klasifikuar si Faza 1.

31 Dhjetor	2020	2019
P-1	19,528	11,498
P-2	18,351	23,312
P-3	4,275	2,537
	42,154	37,347

Investimet në letra me vlerë

Investimet në letra me vlerë kryesisht janë në bono qeveritare me vendet e OECD, bonot e thesarit të Republikës së Kosovës dhe bono të korporatave. Investimet janë kryesisht për menaxhimin e likuiditetit të bankës dhe sigurojnë diversifikim të mjaftueshëm të riskut në drejtim të ekspozimit kreditor me një sovran duke marrë në konsideratë edhe mjedisin rregullator lokal dhe kufizimin e ekspozimeve të mëdha.

	2020	2019
P-1	115,217	78,609
P-2	36,759	37,167
P-3	-	-
E pavlerësuar	24,783	34,263
	176,759	150,039

Ekspozimi i raportuar si i pavlerësuar pasqyron ekspozimin bankar ndaj Republikës së Kosovës. Tabela më poshtë paraqet ekspozimin ndaj riskut bazuar në riskun e palës së kundërt të ekspozimit.

	2020	2019
Obligacionet dhe Bonot e Thesarit të Qeverisë së Kosovës	24,783	34,263
Bono të tjera të thesarit dhe obligacione qeveritare të OECD-së	123,781	72,774
Bono të korporatave	28,195	43,002
Gjithsej investimi në letra me vlerë	176,759	150,039

4.3 Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Banka do të hasë vështirësi në përbushjen e detyrimeve financiare. Banka ekspozohet ndaj kërkesave të përditshme mbi burimet e saj të parave të gatshme në dispozicion nga llogaritë rrjedhëse, depozitat që u afrohet afati i maturimit, kreditë e tërhequra dhe garancionet. Risku i likuiditetit menaxhohet nga Menaxhmenti i Bankës.

Banka mban pasuri afatmesme dhe afatgjata dhe për shkak të kushteve të tregut, financon pjesën më të madhe të portofolios të saj me borxh afatshkurtër. Në këtë proces, Banka trashëgon riskun e likuiditetit që lidhet me mospërputhjet e maturimit. Risqet nëse menaxhohen në mënyrë korrekte janë risqe të pranueshme. Banka lëshon pasuri afatgjata, siç janë kreditë PI dhe ato hipotekare, dhe këto portfolio financon kryesisht nga depozitat pa afat dhe depozitat me afat deri në 1 vit. Menaxhmenti merr në baza ditore informacionin e raportit të likuiditetit të Bankës, dhe gjithashtu në baza javore pranon raportin e likuiditetit të renditur sipas segmentit të biznesit. Pasi që banka lëshon pasuri afatmesme dhe afatgjata, dhe i financon ato me borxh afatshkurtër dhe afatmesëm, ajo është e ekspozuar edhe ndaj riskut të normës së interesit.

Rezerva e likuiditetit rregullativ llogaritet si 10 për qind e detyrimeve mesatare që kanë afat maturimi brenda një viti, rezervë e cila mbahet si depozita në bankën qendrore dhe 50 për qind në para të gatshme. Më 31 dhjetor 2020, teprica e rezervës së likuiditetit është 24,588 mijë € (2019: 8,903 mijë €).

Tabela më poshtë tregon vlerat bartëse neto të asetëve dhe detyrimeve më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 sipas maturitetit të tyre kontraktual të mbetur.

Sidoqoftë, banka pret që shumë klientë nuk do të kërkojnë ripagesën e depozitave në datën më të hershme që mund të kërkohej të paguhen dhe tabela nuk pasqyron flukset e parave të gatshme të pritura të treguara nga historia e vet e mbajtjes së depozitave. Për më tepër, banka po përdor aktin e deleguar të LCR-së së BE-së për menaxhimin e likuiditetit dhe kërkohej të mbajë likuiditet nga 10 për qind në 10.9 për qind për depozitat retail të pasiguruara dhe përqindjen për depozitat e siguruara. Për depozitat joretail, një dalje prej 33 për qind deri në 85 për qind është planifikuar bazuar nëse llogaria është operacionale ose jo. LCR-ja e BE-së duhet të jetë mbi 100 për qind. Me 31 dhjetor 2020, banka tejkaloi këtë limit në mbi 400 për qind.

	Të paafatizuara dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 1 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Gjithsej
Pasuritë					
Paraja dhe ekuivalentët e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	68,852	-	-	87,326	156,178
Detyrimet nga bankat	28,575	-	-	-	28,575
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	7,681	17,365	135,845	548,624	709,515
Investimet në letra me vlerë	1,493	4,971	111,194	59,101	176,759
Pasuritë e tjera	-	-	3,034	-	3,034
Gjithsej asetet financiare	106,601	22,336	250,073	695,051	1,074,061
Detyrimet					
Depozitat nga klientët	912,080	941	2,197	408	915,626
Deturimet nga bankat	5,879	-	21,003	-	26,882
Borxhi i varur	298	-	-	19,000	19,298
Detyrimet e tjera	-	-	8,611	-	8,611
Gjithsej detyrimet financiare	918,257	941	31,811	19,408	970,417
Pozicioni i hendekut neto më 31 dhjetor 2020	(811,656)	21,395	218,262	675,643	103,644

	Të paafatizuara dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 1 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Gjithsej
Pasuritë					
Paraja dhe ekuivalentët e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	40,856	-	-	82,821	123,677
Detyrimet nga bankat	35,483	-	-	-	35,483
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	6,054	20,213	121,130	522,101	669,498
Investimet në letra me vlerë	149	21,770	16,900	111,220	150,039
Pasuritë e tjera	-	-	949	-	949
Gjithsej asetet financiare	82,542	41,983	138,979	716,142	979,646
Detyrimet					
Depozitat nga klientët	843,326	979	14,010	402	858,717
Detyrimet nga bankat	7,602	-	-	-	7,602
Borxhi i varur	325	-	-	19,000	19,325
Detyrimet e tjera	-	-	7,888	-	7,888
Gjithsej detyrimet financiare	851,253	979	21,898	19,402	893,532
Pozicioni i hendekut neto më 31 dhjetor 2019	(768,711)	41,004	117,081	696,740	86,114

Analiza e maturimit të kredive për klientë bazohet në datat e mbetura të maturimit të marrëveshjeve të kredisë, që do të thotë duke marrë parasysh këstet në baza mujore.

Raportimi i likuiditetit në baza javore në nivel të segmentit të biznesit, monitorimi i raportit të pandryshueshmërisë ndaras për të gjitha segmentet e biznesit, limitet në librin bankar dhe raportet të cilat matin riskun e interesit dhe diferencat, janë aktualisht mjetet e zbatuara për të menaxhuar dhe kufizuar riskun themelor për zhvillimin e biznesit.

Rezervat e detyrueshme të likuiditetit janë të përfshira në kuadër të fazës “të paafatizuara (me kërkesë) dhe më pak se një muaj”, sepse shumica e detyrimeve me të cilat lidhet kjo gjendje janë gjithashtu të përfshira në këtë kategori.

Analiza e maturitetit për detyrimet financiare analizohet si në vijim:

- Në bazë të datës më të hershme kontraktuale të maturitetit– skenari i rastit më të keq,
- Në bazë të rrjedhave të paskontuara kontraktuale të parasë,
- Përcaktimin e brezave kohorë,
- Rrjedhat e pritura të parasë përdoren si informata plotësuese.

Përputhja dhe/ose mospërputhja e kontrolluar e afateve të maturimit dhe normave të interesit të pasurive dhe detyrimeve është e rëndësishë thelbësore për menaxhimin e Bankës. Është e pazakontë për bankat që të përputhen plotësisht pasi biznesi i kryer është shpesh me afat të pasigurt dhe i llojeve të ndryshme. Një pozicion i papërputhur potencialisht rrit profitabilitetin, por gjithashtu mund të rrisë riskun e humbjeve. Afati i maturimit të pasurive dhe detyrimeve dhe aftësia për të zëvendësuar detyrimet që bartin interes ndërsa ato maturojnë me një kosto të pranueshme janë faktorë të rëndësishëm në vlerësimin e likuiditetit të Bankës dhe ekspozimin ndaj ndryshimeve në interes dhe kursin e këmbimit.

Banka ka një mospërputhje të konsiderueshme të afatit të maturitetit të pasurive dhe detyrimeve që maturojnë brenda një viti. Kjo mospërputhje e likuiditetit lind për shkak të faktit se burimi kryesor i financimit të Bankës sipas datës 31 dhjetor 2020 dhe 2019 ishin llogaritë e klientëve që janë pa afat dhe maturojnë brenda më pak se një muaji. Menaxhmenti beson se, përkundër asaj se një pjesë të madhe e llogarive të klientëve janë “pa afat”, diversifikimi i këtyre depozitave sipas numrit dhe llojit të depozituesve do të tregonte se llogaritë e këtyre klientëve japin një burim afatgjatë dhe të qëndrueshëm të financimit për Bankën.

Banka ka përmirësuar pozicionin neto përmes burimeve të tjera të financimit, të cilat ofrojnë financim afatmesëm dhe ka për qëllim të vazhdojë përputhjen e maturitetit të pasurive me detyrimet në periudhat që do të vijjnë. Gjithashtu, Banka ka një marrëveshje të papërdorur instrumenti kreditor, e cila do të ofrojë përkrahje në rast se ka nevojë për likuiditet.

Shuma totale kontraktuese e mbetur e zotimeve për të dhënë kredi nuk paraqet domosdo kërkesa të ardhshme për para, pasi shumë prej këtyre zotimeve do të skadojnë ose përfundojnë pa u financuar.

4.4 Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e një investimi do të bjerë për shkak të lëvizjeve në faktorët e tregut. Katër faktorët standardë të riskut të tregut janë:

